

## **PROCESVERBALI**

Nga mbledhja X-të e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 28.09.2018, duke filluar nga ora 10:20, në sallën e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm 39 anëtarë.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, OSBE-ja, Zyra e EULEX-it, KFOR-it dhe përfaqësuesit e medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Artan Abrashi, kryesues.

Për këtë mbledhje janë paraparë këto pika për:

## **R E N D D I T E**

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 28 qershor 2018, 31 korrik 2018 dhe 16 gusht 2018;**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës së propozuar;**
- 3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;**
- 4. Diskutim rreth mundësisë për ndërtimin e bustit të Skënderbeut dhe shtatores së Adem Jasharit;**
- 5. Diskutim rreth logos së Komunës së Prizrenit dhe mundësia e rikthimit të vitit 1878;**
- 6. Shqyrtim – diskutim për propozimvendimin për lejimin e ridestinimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore;**
- 7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për shpronësimin e pronave të paluajtshme, për ndërtimin e rrugës në lagjen “Gurishtë” në Prizren;**
- 8. Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2019 dhe**
- 9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-buxhetit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2019 dhe parashikimi për vitin 2020 dhe për vitin 2021.**

**Pika e parë:**

**Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të datave: 28 qershor 2018, 31 korrik 2018 dhe 16 gusht 2018;**

**Kryesuesi**, e hapi debatin lidhur më procesverbalet, duke pyetur se a ka dikush për të shtuar diçka, e nëse jo e hedh në votim.

Atëherë, konstatojë se unanimisht janë miratuar procesverbalet e mbledhjeve të kaluara.

### **Pika e dytë:**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës të propozuar**

Kryesuesi, a ka dikush të shtoi diçka për rënd dite të cilin e kemi paraparë në mbledhjen e fundit të KPF-së.

**Ilir Baldedaj (AAK):** Theksoi se ka qenë edhe falja e borxheve nga KPF-ja, mirëpo nuk e pash këtu si pikë e rendit të ditës. Ndoshta e keni ngatërruar.

**Kryesuesi:** Theksoi se ka qenë pikë diskutimi për mbledhjen e KPF-së. Dhe është lënë që kjo çështje të diskutohet me kryetarin, në lidhje me formimin e komisionit. Këtu janë edhe anëtarët e tjerë të KPF-së, nëse harrova diçka le të më plotësojnë.

**Baldedaj:** Më sa e di unë Xhaviti ka kërkuar me hy në rend të ditës. Këtu është Xhaviti le ta thotë, që nuk ka kërkuar me hy në rend dite.

**Xhavit Uka:** Unë kam mendua që veç e keni shti në rend të ditës dhe për atë prita veç me reagua.

**Kryesuesi:** Në momentin kur ekzekutivi, kryetari i komunës ta themeloj këtë komision nga hapat e drejtorit, të bëhet gati propozimvendimi për nisjen e kësaj procedura. Padyshim që po, mirëpo ne nuk patëm asgjë gati në mbledhje më sa e pash. Dhe uroj që sa më shpejt ta kemi një gjë të tillë. Si ta kemi pa dyshim që do ta procedojmë. Kështu e di unë, kështu e lamë.

**Memnuna Ajdini (Vakat):** Ja sam se javila povodom dnevnog reda. I želim dati jednu primedbu koja je osnovana. Ti e se šeste ta ke. Dakle diskusija oko logoa. Smatrazam zaista, bez onoga da ima i kod vas pogrešno razmišljenje. Dakle to je pitanje koje ve poodavno završeno. I smatram da ne bi trebalo ovo da u e u dnevni red. Obzirom da dovodite u situaciju da se mi predstavnici, dakle manjina moramo javiti, reagovati za nešto što je odavno završeno. I dodatno mislim narušavate sliku našeg grada. Dovode i tako e vlast u poziciji da se komprimituje. Ja mislim da je predlog došao od odbornice PDK i smatram da je to njeno pravo. Me utim znate da upravo za vreme vlasti PDK je to pitanje završeno. Završeno je sa Ustavnom Sudu. Gde još uvek ta odluka pravosnažna. I gde smatram, nema više potrebe za raspravu. Podvla im absolutno niko od nas

nema protiv logoa Prizrenske Lige. To smo više puta dokazivali. Zaista dovodite u situaciju nas odbornike iz manjinskih zajednica da tražimo nešto što nama Ustavom zagarantovano. Što je po zakonu, po statutu našeg rada. I što svakako oslikava sve zajednice, i tim amblemom. Smatramo da je taj amblem i te kako jedno lice Prizrena koje trebamo zadržati. Zahvaljujem, i mislim da ete imati sve ovo u razumevanju.

**Shukri Quni (PDK):** Unë nuk pata mendjen me fol, po më nxiti. Po më sa pash ishte rreth logos të komunës së Prizrenit, që ti shtohet viti 1878. Unë e kam bo një kërkesë të tillë edhe më herët. Nuk është tani. Kjo edhe në kohën kur ke qenë edhe vetë në KPF, që e kam kërkuar, se kam të drejtë me kërkuar edhe si kuvendarë, për me hy kjo në rend dite. Kështu që unë ju falënderoj juve si KPF që e keni fut këtë pikë në rend dite. Po ashtu edhe kolegët që janë këtu edhe ju kryesues. Sepse logoja e Lidhjes së Prizrenit, pa vit është vetëm një objekt që i mungon. Kjo zonja këtu foli. Po ajo është edhe si pikë e rendit të ditës. Kështu që kjo logo që i mungon viti 1878, nuk e di për çka me ju pengua dikujt, sidomos komunitetit boshnjak. Kur komuniteti boshnjak e ka përkrah Lidhjen Shqiptare të Prizrenit fuqishëm. Edhe Lidhje Shqiptare e Prizrenit nuk ka qenë kundër askujt po ka qenë vetëm kundër fuqive të mëdha të cilët kanë bo copëtimin e tokave shqiptare. Kështu që pas disa reagimeve që i kanë bërë atëherë disa persona, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka heq. Ne, i nderuar kryesues dhe ju të nderuar kuvendarë, si Kuvend që është votua nga ky Kuvend nga njerëz tanë, pa marrë parasysh cilit komunitet i takon. Edhe ata që e kanë dizajnuar atë logo, ne duhet mi përshëndet edhe ata të cilët e votua me qenë viti 1878. E kështu që, unë nuk besoj që ju pengon viti 1878. Nëse ka nevojë, unë thash kjo është edhe pika që do të diskutohet për këtë. Po nuk e prita që do të reagohet bash menjëherë. Nuk e kuptova bash mirë, po e pash që diçka është rreth logos.

**Kryesuesi:** Shukri, kërkoj falje, unë e kisha lanë që të diskutojmë kur të vijë te pika e rendit të ditës. Që ta kemi kohën e mjaftueshme për të gjitha këto. Se jemi te propozimet për rend dite, pastaj thellohem. Nëse pajtoheni.

**Haziz Hodaj (LDK):** Në materialin e parë që kemi marrë, ne si anëtarë të Kuvendit e kemi marrë edhe një pikë rreth raportit të Drejtorisë së Arsimit. Mirëpo po e shoh që është heq. Nuk e di cila është arsyeja. Po në bisedë me anëtarin tonë të KPF-së, u tha që është kërkuar një mbledhje e jashtëzakonshme për Drejtorinë e Arsimit. Unë nuk e di që mbledhja e jashtëzakonshme ka të bëjë me raportin e drejtorit të Arsimit, me gjendjen e fillim vitit shkollor 2018-2019. Nëse ka diçka të përbashkët dhe nëse përfshihet edhe raporti i drejtorit për fillim vitin kalendarik të arsimit, atëherë në rregull. Po nëse është mbledhja e thirrur me një pikë tjetër të rendit të ditës. Atëherë unë nuk e di pastaj që mund të bisedohet për raport rreth kësaj.

**Kryesuesi:** Pika për raportin për fillimin e vitit shkollor ka qenë në kuadër të planit të punës të Kuvendit të cilin e kemi miratua bashkë. Por se nga anëtarët e KPF-së është kërkuar që kjo pikë mu heq. Ka kalua shumicën dhe është heq.

**Alush Shala (PDK):** Për këtë pikë ne kemi diskutua në KPF. Dhe shkak kryesor ka qenë ngarkesa e këtij rendi të ditës, sepse do të diskutohet më shumë për buxhetin. Ndërsa janë shtua shumë pika të cilat nuk do të marrin kohë, gati thuaja të gjitha duhet me kalua, me pëlqimin e shefave të grupeve parlamentare të Kuvendit. Andaj edhe nëse mbahet mbledhja e jashtëzakonshme, po edhe nëse s'mbahet, raporti i punës, kjo është në rregull që e ka aprovua Kuvendi. Ne nuk ia kemi mohua, po vetëm për shkak të ngarkesës së madhe.

**Kryesuesi:** Nëse nuk ka dikush tjetër, atëherë po e hedh në votim këtë propozim të cilin e lexova, kush është për?

Për? – 31.

Kundër? – S'ka.

Abstenim? – 7.

Konstatohet se me shumicë votash miratohet rendi i ditës i propozuar.

**Pika e tretë:**

**Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme.**

**Haziz Hodaj:** Unë meqë është heq pika për raportin e Drejtorisë së Arsimit, nuk kam pyetje, po do të bëjë një vërejtje. Kështu që po shfrytëzoj rastin me ia marrë edhe dy minutat e Xhavitit, dhe mi shfrytëzua nga tre katër minuta rreth problemit në arsim që po ndodh në komunën e Prizrenit. Sinqerisht nuk po e di çka po ndodh, por pas anulimit të konkursit, që ka ndodh herën e kaluar, kemi pritë që do të ndodh një refleksion prej Drejtorisë së Arsimit. Po fatkeqësisht nuk është lëvizë nga ajo pikë, asnjë pikë e asnjë presje. Dhe është vazhdua me avazin e vjetër, me një nënçmim që i bëhet arsimit fatkeqësisht segmentit më të ndjeshëm, më neurologjik të komunës. Dhe realisht po luhet me ndjenjat e nxënësve, arsimtarëve, drejtorëve, po në përgjithësi edhe të qytetarëve të Prizrenit. Unë e di që drejtori i Arsimit faktikisht është shndërrua në një figurë tragji-komike. Unë di që ai e ka të pamundur të veprojnë sepse e ka një barrë mbi supë që nuk mund ta përballojë. Dhe paralajmërimi i udhëheqësit të tij, se edhe nëse anulohet dhjetë herë konkursi, do të ndodh e njëjta gjë dhe do të zgjidhen të njëjtit persona. Kjo është një paralajmërim, një ogur i keq për kryetarin e komunës në radhë të parë, për ekzekutivin, për udhëheqësit, për qytetarët dhe për nxënësit. Unë sinqerisht nuk e di se çka po ndodh. Unë e di se

drejtori nuk shkon në burg, sepse nuk e ka shkel ligjin, realisht janë zhvillua procedurat, janë respektuar procedurat. A është respektua kualiteti, në asnjë mënyrë. Mirëpo, po i them këtu se do të jetë i burgosur i ndërgjegjes së vetë, i besimit të qytetarëve që i është dhënë. Do të jetë i burgosur për tërë jetën i ndjenjës së qytetarëve të Prizrenit, të cilët janë të pakënaqur skajshmërisht, me këtë trajtim që i është bërë njerëzve që kanë kaluar nëpër testet për kandidatë të drejtorëve. Ju tash do ta merrni këtë, edhe do të dalin tellall të partive të ndryshme. Sepse unë kërkoj emra të caktuar, absolutisht asnjë emër të vetëm nuk e kam preferencë. Po është e vërtetë që kam insistua që në Gjonaj të jetë njëherë e përgjithmonë një menaxher i mirë, një drejtor i mirë i kësaj shkolle. Që nuk kam asnjë lidhje as partiake, as familjare, asnjë. Dhe unë e di që do të dalin këtu, se kanë dal vazhdimisht në reagimet e mija. Kanë dal reagime që unë kam njerëzit e mi. Jo, jo shkolla ka vuajt për një menaxher të mirë. Është e vërtetë që unë kam thënë që edhe në kohën për sa ka qeverisë LDK-ja, që edhe ne kur kemi qenë në pushtet i kemi bo drejtorë njerëzit e LDK-së. Po i kemi bo njerëzit udhëheqës, apo drejtorë i kemi bo njerëzit që kanë bart mbi kurriz tërë procesin e arsimit në kohët më të vështira dhe kanë qenë menaxher të dëshmuar. Është e vërtetë që PDK-ja i ka bo të vetët edhe e ka politizua skajshmërisht Drejtorinë e Arsimit. Duke i pritë njerëzit me diplomua për ti bërë drejtorë. Pafundësisht duke i mbajte ushtrues detyre, derisa kanë diplomua, apo deri sa kanë sigurua në një formë apo në një tjetër një diplomë. Mirëpo, i kanë bo anëtarët e vetë të PDK-së. Çka po ndodh tani. Tani thotë hajde në Nisma, se unë të bëjë drejtor shkolle. Ku shkon kjo, ku na qon kjo. Dhe për të krijuar struktura të Nismës, tash hajde se të bëjë drejtor. Ej kjo është skandaloze. Dhe unë e di që është thirr nga opozita një mbledhje e jashtëzakonshme e drejtorisë së Arsimit. Unë po ju paralajmëroj sot, se ne nuk do të jemi pjesë e asaj mbledhjeje. Ne nuk do të jemi pjesë e asnjë vendimi që merret nga Drejtoria e Arsimit. Madje nuk do të jemi në mbledhje as kur flitet për arsimin. Sepse nuk do të jemi më pjesë e kësaj çka po ndodh me Drejtorinë e Arsimit. Kjo është vërejtje së pari që i jepet kryetarit të komunës. Sepse çka do që të bëhet, përgjegjësia bie mbi kryetarin e komunës. Dhe nëse kryetari lejon, që një formë apo në një formë tjetër me luajte me ndjenjat e nxënësve në radhë të parë. Po edhe të arsimit në përgjithësi, le të lejoj, po përgjegjësinë e merr ai vet.

**Simir Krasniqi (PDK):** Pasi e filloj baca Haziz për arsimin, edhe pse desha ta lë në seancë të jashtëzakonshme, unë disa pyetje do t'ia drejtoj kryetarit, ku ai do të ishte mirë të jetë prezent këtu. Kryetar, a jeni i informuar se procesi mësimor në shkollën e mesme të mjekësisë nuk është duke u mbajtur në lëndët profesionale mjekësore. Arsyja e mos mbajtjes së mësimin, është largimi i kundërligjshëm i shtatë mësimdhënësve mjek specialist, me përvojë shumëvjeçare, në këtë shkollë dhe në mësimdhënie. Pyetja e dytë po ashtu shkon për kryetarin e komunës. Personi që luan rolin e ushtruesit të detyrës së drejtorit në shkollën e mesme të mjekësisë, a ka vendim. Nëse s'ka, si sillet

personi në fjalë, në cilësinë e drejtorit. Nëse ka vendim, kush e ka nënshkruar atë vendim. Kur dihet personi në fjalë nuk i plotëson kriteret për të qenë në atë pozitë. Ku personi që nëntë vite nuk është në listën e pagave në sistemin e arsimit. A është ky punësim i kundërligjshëm. Po ashtu edhe një pyetje për kryetarin e komunës. Si e keni lejuar hapjen e konkursit në Drejtorinë Komunale të Arsimit më datë 08.08.2018, me një përmbajtje skandaloze, ku DKA-ja bënë gabime trashanike. Ku përmbajtja e konkursit, ka dallime në të tri gjuhët. Për shembull në shkollën e mjekësisë në gjuhën shqipe kërkohet një mjek i përgjithshëm. Kurse në gjuhën boshnjake për pozitën e njëjtë, kërkohet një mjek stomatolog. Kjo parregullsi e këtij konkursi, dhe shumë parregullsi tjera e kanë obliguar inspektoratin e punës që të urdhëroj anulimin e këtij konkursi. Çfarë menaxhim i Drejtorisë Komunalë të Arsimit është ky. Pyetja tjera për gjendjen në arsim po i lë në seancën e jashtëzakonshme që do të mbahet shumë shpejt. Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike Levent Kasemi. Kompanitë e kontraktuara nga komuna e Prizrenit, për larjen e rrugëve, a janë duke iu përmbajtur orarit të caktuar në kontratën e paraparë. Këto kompani nuk iu përmbahen kontratës për larjen e rrugëve që janë ditët e caktuara për çdo rrugë, për orarin e larjeve të rrugëve. Kemi shumicën e rrugëve që asnjëherë nuk janë larë gjatë gjithë sezonës së verës. Ku komuna ndanë një shumë të konsiderueshme të mjeteve të taksapaguesve të komunës së Prizrenit. Për këtë a duhet dikush të jap përgjegjësi. Për vitin 2019 komuna ka ndarë për mirëmbajtjen verore të rrugëve, fshirje dhe larje të rrugëve 900.000 € Dhe kompanitë e kontraktuara mos ti përmbahen kontratës, kjo ndodh vetëm në komunën e Prizrenit.

**Bardhi Avdaj (PDK):** Në seancën e fundit të rregullt, u diskutua edhe çështja e zgjedhjeve të drejtorëve të shkollave. Në atë seancë mua nuk mu dha fjala për të replikuar këtë person. Që jam i sigurt se kur e sheh vetën në pasqyrë, ka frikë nga vetvetja, dhe asnjëherë nuk i shfaqët fytyra e vërtetë. Sepse është një person me shumë fytyra, ose krejt i pa fytyrë. Për respekt të qytetarëve të Prizrenit, unë sot dua ti them disa fjalë për personin, që është në udhëheqje të Drejtorisë Komunale të Arsimit. Fillimisht dua t'ia rikujtoj, se në këtë pozitë nuk je me vota të qytetarëve, por je i zgjedhur. Dhe më dhimbshëm, ti je veç një piun ose një vegël që të tjerët luajnë si të dëshirojnë me juve. Z. Susuri për hir të qytetarëve të Prizrenit, të lutem shumë mos u sill si ekspert. Sepse të paktën unë sot do ti tregoj atyre që nuk e dinë, se fakulteti i juaj ka zgjatur 24 deri 26 vite. Dhe atë e ke përfunduar pa shkuar fare në dyert e fakultetit. Pa e mbajtur asnjë ligjëratë. Sepse ke ushtruar detyrën e sekretarit të shkollës së mesme në Shkollën e Gjinnazit. I nderuar a mundesh me na tregua neve, si ke mundur ta bindesh kryetarin tuaj që të zgjidhesh për këtë pozitë. Sepse më sa e di unë, ti ke ndryshuar të paktën pesë, gjashtë parti politike. Që i bije që për arsye personale jeni në gjendje të bësh gjithçka edhe ta klasifikon vetën si një lavire politike. Pranoje para neve edhe qytetarëve se arsyeja pse ke ndryshua gjithë këto parti

është, sepse ti me zemrën tënde e ke partinë komuniste. Dhe trego, a e ke dorëzuar librezën komuniste, ose e mbanë akoma për nostalgji. Sepse ndoshta ende po shpreson se akoma do të kthehet pushteti i paraluftës. Arsimi në Prizren po udhëhiqet prej një analfabeti të shekullit XXI, prej një personi të paditur dhe të pashkolluar. Një piuni i cili për shumë pak kohë udhëhiqte në këtë sektorë, gjithçka çka bënë, ka qenë realizimi i urdhrave nga ata që kanë zgjedhur për të punësuar militantët. Edhe po të propozoj tash qohu dil jashtë, freskohu pak se të ka fillua me tu ngritë temperatura. Dhe thirre kryetarin tënd me telefon të tregon si mu përgjigj. Sepse nuk ke kapacitet me dëshmuar të kundërtën, se kjo është e vërteta. Ose kërko ndihmë prej Abrashit ta telefonon atë sigurimin që punon si deputet në Parlamentin e Kosovës. Po nuk besoj se do të lajmërohet. Se ishte duke pushur të ndërtesa pesëmbëdhjetë katëshe.

**Alush Shala:** Unë s’kam qare pa fillua pyetjet e mija sikur çdo radhë. Kam kërkuar nga Drejtorja e Shërbimeve Publike që të hapet edhe një shirit nga Bazhdarhana që nuk është më shumë se 200 metra. Dhe më ka premtuar që do ta procesoj dhe do ta shikoj, por nuk kam marrë përgjigje. Është një pengesë mjaftë e madhe dhe po të hapet edhe një shirit do të zvogëlohet numri i makinave që pengojnë nganjëherë edhe nga gjysmë ore. Realisht ekziston shenja që është ndalim-parkimi. Po aty gjithmonë ka makina. Bëhet fjalë drejtor në krahun e majtë ku është një parking i palejueshëm. Faktikisht janë të parkuar gjithmonë, së paku pa lejen e juaj, ekziston shenja. Nuk e di a po e dini rastin apo jo. Gjithashtu problem shumë madhor është uji i pijshëm për tri lagjet: “11 Mars” “2 Korrik” dhe “Dardani”. E kam marrë një përgjigje, e cila me një vend shkruan në muajin gusht përfundon. Nëse është e shkruar gabim. Atëherë e lus drejtorin të na jap sqarime. Po kisha dashtë këtu të na jap, jo me shkrim. Sepse me shkrim po vazhdon një muaj. Në rrugën nga TA-ja deri te autostrada është bërë njëfarë pastrimi. Po nuk e di a e keni vërejtë aty që dikush i ka vu telat. Ndoshta është pronë e veta, ndoshta ka edhe të drejtë. Por nëse ne i themi se ne jemi shteti edhe jemi komunë, komuna duhet të merret me atë person. Nuk po flas me dhunë, por duhet t’ia kompensoni apo t’ia hiqni së paku përkohësisht që të mos mbetet aty si shenjë e zezë, për ata që kalojnë aty pari. Gjithashtu problem dhe rrezik për gjithë qytetarët janë edhe qentë endacak. E kam pa një projekt, mirëpo bëhet fjalë për 2019, ndërsa 2018 absolutisht s’kam parë kasgjë. Nga drejtori i arsimit dua përgjigje se kur do të fillon ndërtimi i shkollës së Muzikës. A kanë përfundua procedurat. Çerdhja në “11 Mars”, a ka fillua, kur do të fillon dhe në cilin vend do të bëhet? Dua ta di a është gjet vendi për ndërtimin e shkollës. Dhe nëse bëhet shkolla jashtë lagjes “11 Mars”, për afërsisht diku ka TA-ja, realisht bëjmë edhe një krim tjetër. Sepse nga TA-ja deri te Lek Dukagjini për afërsisht një drejtim i ka diku më shumë se 3 km që vinë nxënësit aty. Dhe ne nëse nuk i ofrojmë nxënësve tetëvjeçaren, ose i qojmë diku të “2 Korrik”, realisht nuk kemi bërë asgjë, vetëm që ua kemi zgjatë rrugën. I nderuar Drejtor i Shërbimeve Publike, ka qenë kërkesë e ime e

kamotshme për hapjen e trotuareve në rrugën nga Bazhdarhanja apo më mirë më thënë nga shkolla “Lek Dukagjini” e deri te transiti i ri. Përpos që janë të uzurpuara ka edhe pengesa të mëdha që thuaja asnjëherë udhëtarët nuk mundën me kalua nëpër trotuar. Edhe nuk ka, edhe ata që janë, janë shumë të vogla, por edhe janë të zëna. Për drejtorin e Inspektoratin, po ia rikujtoj prapë që automjetet për bartjen e kufomave, jo vetëm që vazhdojnë ato të mbesin në hyrja dajë të qytetit të Prizrenit, dhe që është një shëmti për të gjithë ata që shohin. Po realisht tani edhe i kanë shtua ka dy ka tre i kanë bo. Mirë është të pastrohen, nëse ka mundësi. Nëse jo atëherë kërkojmë së paku nga instancat më të larta.

**Sherife Balaj (PDK):** Në seancën e kaluar kam kërkuar që të raportohet për dhënien e materialit ndërtimor nga tri drejtoritë. Drejtoria për Mirëqenie Sociale, për Emergjencë dhe Zyra e Komuniteteve. Nga të cilat ka pasur afër gjysmë milion buxhet komunal. Të dinë qytetarët dhe ne këtu në Kuvend për realizimin e këtyre shumave. Për shembull DPMS ka pasur 250.000 € Drejtoria e Emergjencave dhe Sigurisë 100.000 €, Zyra e Komuniteteve 90.000 € Pastaj marrëveshja e bashkëfinancimit me VORAE, me vlerë 20.000 € për renovim dhe ndërtim të shtëpive nga komunitet RAE. Të gjitha këto politika normal të cilat kanë qenë të destinuara prej vitit 2017 për realizim në vitin 2018. E them këtë sepse kam tash dy përgjigje prej drejtorit të DPMS dhe zyrës së komuniteteve, tani veç sa i mora. Edhe është mirë të bihen raporte edhe të diskutohen këtu në Kuvend dhe ta dinë të gjithë kolegët dhe pastaj edhe qytetarët, se çfarë po ndodh me këto realizime, sepse është një shumë e madhe. Pastaj kam një pyetje tjetër. Ne si grup i komunitetit për komunitete, ishim para disa jave në vizitë në një rrugë Ali Pash Tepelena, ku ishin shumica e komuniteteve RAE, me përfaqësuesit e tjerë të komunitetit. Aty e pamë që me vite të tëra paska qenë e bllokuar ajo rrugë. Kërkoj të di se a është bërë zhbllokimi i asaj rruge, sepse ne kemi bërë edhe kërkesë.

**Pranverim Berisha (Nisma Socialdemokrate):** Pyetje për drejtorin e Administratës, z. Osman Hajdarin, njëkohësisht edhe një shqetësim i qytetarëve të cilët me të drejtë reagojnë. I nderuar drejtor, nëpër disa zyra të vendit të gjendjes civile shpesh po ndodh që nuk po ka internet apo sinjal. Si pasoj banorët e lokaliteteve të tyre nuk po mundën ti kryejnë shërbimet e tyre. Dhe natyrisht ata, po humbin edhe kohën, edhe në aspektin financiar sepse mund të marrë leje edhe nga puna. Kurse punën për rregullimin e dokumenteve nuk e kanë kryer. Ka zyre të vendit që shkruan në derë sot nuk punojmë, sepse nuk ka rrjet. Natyrisht që në mungesë të rregullimit të dokumenteve mund që ti humbin edhe terminët neper ambasada. Unë e kuptoj që kjo është kompetencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Por këto që po ndodhin në terren a jeni ju në dijeni dhe nëse po çfarë keni ndërmarrë që në të ardhmen të mos ndodh, mos shërbimi i qytetarëve nëpër zyre të vendit. Një pyetje tjetër është për Drejtorinë



e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik. Drejtoresh ju a e dini që në fshatin Poslisht ekziston një gurrë. Nëse po, a e keni vizituar ndonjëherë dhe a keni menduar për të investuar në atë vend të bukur? Pyetja e tretë dhe njëkohësisht interesim dhe shqetësim pasi që një nga seancat kam reaguar në lidhje me gjendjen në stacionin e autobusëve në Prizren. Në menaxhimin e kësaj ndërmarrje ku vazhdon një papërgjegjësi totale dhe një gjendje kaotike. Informatat që i kemi aty, një njeri me cilësi të vatë ashtuquajtur dhe vetë përzgjedhurit drejtor i po kësaj ndërmarrje. Sillet si mbret dhe zotëron gjithçka, si parkingjet, kënd do e largon nga puna dhe kënd të donë e punëson. Lëshon bileta pa kuponë fiskal. Lokalet dhe qiratë e lokaleve nuk e dimë askush se kush i merr dhe çka bënë. E shumë veprime tjera, që konsiderohen që janë të kundërligjshme. Andaj, pyes drejtorin e Shërbimeve Publike dhe zyrën e Kryetarit çka keni ndërmarrë në këtë drejtim për parandalimin e këtyre veprimeve ku e dëmton komunën, apo akoma nuk keni bërë asgjë.

**Ilir Baldedaj:** Parashtroi pyetje për drejtorin e Kulturës. Mbrëmë është bërë ndërimi i trajnerit të klubit “Liria”, mirëpo trajneri që ka ardhur nuk ka as licencë për ta udhëhequr “Lirinë”. Unë kërkoj nga ky Kuvend, siç ka marr vendim atëherë që “Lirinë” ta mbështesim me mjete financiare. Ta themelojmë një komision dhe të merret me këtë çështje. Se nga gjashtë lojë, unë kam paralajmëruar nga fillimi. Sepse aty është bërë një mish mash. Dhe shqetësimet e mija kanë hasur në vesh të shurdhër. Dhe gjithmonë, është thënë se është në rregull, ka bord legjitim, i ka të gjitha këto. I nderuar drejtor lyerja e objekteve të “Lirisë” ka shkua pa tender. Ato janë mjete të qytetarëve të komunës së Prizrenit, ku taksapagues jemi secili nga ne. Dhe besoj se është shkelje ligjore. Kështu që kisha kërkuar një raport detal për gjendjen e “Lirisë”. Andaj kërkoj nga asambleja që të thirret një seancë e jashtëzakonshme për këtë çështje, sepse vërtetë “Liria” në këto rrethana do të bjen edhe nga liga. Kjo është si rrjedhojë e juaj, si pasoj e keq menaxhimit të kësaj drejtorie. Po të pyes drejtor prapë për Zambakun. A e gënjeve opozitën dhe pozitën të cilët nuk latë të vinë as në seancën e jashtëzakonshme, së bashku me kryetarin e komunës, ku një ditë para seance kryetari i komunës e poston që Zambaku i Prizrenit do të mbahet. Dhe pyetja është, ku janë çështjet, ku ka mbërri procedura. Sipas informacioneve që e ke pas një takim me shoqëritë kulturore artistike, sivjet nuk do të ketë Zambak. Është mirë të dilni ti kërkonit falje edhe opozitës edhe pushtetit që si latë me ardhur në seancë. Atë ditë të kam thënë, s’ të kanë dal nëntë muaj ditë procedura për forma të reja. Që ka qenë keq Zambaku po pajtohem me ty. Hajde formën e re bone, nuk je kanë në gjendje me bo. Pyetje për drejtoreshën e Turizmit. Pse nuk është mbajtur panairi i veshjeve tradicionale në Prizren. Pyetje për drejtorin e Inspektoratit. Zyrtari ligjor me aktemërim sillet sikur me qenë drejtor i Inspektoratit. Ai vendin e punës e ka zyrtar ligjor. Ndërsa tjetri është inspektor i ambientit në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, dhe sillet sikur me qenë zëvendës drejtor i Inspektoratit.

**Agnesa Sinanaj (AAK):** Unë prapë dua të rikthehem në temën të cilën ka disa muaj që e kam diskutuar, fjala është për shkollën e fshatit Shkozë. Ju si drejtor i Arsimit, ju tashmë e dini ajo shkollë me çka ballafaqohet. Ajo shkollë nuk ka kushte për mësimdhënie. Po ju flas në emër të fshatarëve të cilët i kanë fëmijët në atë shkollë. Përveç gjendjes hiq të mirë higjienike, asaj shkolle i mungon edhe ngrohja gjatë stinës së dimrit. Nxënësve veç se ju mbetet të ngrohen nga fryma e njëri-tjetrit. Gjithashtu i mungon edhe një ndihmës punonjës që duhet ta ketë secila shkollë. Kjo shkon si kritikë edhe për qeverisjen e kaluar, ku sa vite kanë qenë në udhëheqje, nuk kanë bërë asgjë në lidhje me këtë. Pasi që shkolla është ndërtuar nga vetë fshati. Do më thënë komuna nuk ka kontribuar në ndërtimin e sajë. Përveç kohës së fushatës ose e lyejnë pak, ose i ndërrojnë dritaret. Por që ajo shkollë ende ka shqetësime që duhet tashmë të ishin të zgjidhura. Problemi tjetër qëndron te drejtori i saj. Fshatarët e kanë të pamundur të komunikojnë me të, për kërkesat e fëmijëve të tyre. Është tepër jo komunikues dhe kjo ka bërë që të kërkojnë edhe shkarkimin e tij. Unë jam takuar me të personalisht, por nuk kam arritur ndonjë kompromis. Gjithashtu është edhe mungesë edhe e mësimdhënësve. Më keni premtuar kur e kam ngritur si shqetësim që do të formoni një komision dhe do të vini ta vizitoni. Përveç që nuk keni ardhur në shkollë. S'keni mund të jeni prezent as në mbledhjen e fshatit ku jeni ftuar pikërisht për këtë çështje. I njëjti shqetësim është edhe për shkollën e Dobrushtit edhe të Vermcës. Ku ato të fundit mungojnë katër mësimdhënës. Që një muaj ka filluar mësimi shkollor, klasa e tretë dhe e pestë janë pa mësues. Ju mungon një mësues i lëndës së teknologjisë dhe i gjuhës gjermane. Kërkesa e fundit ishte për ndërtimin e një kanali përgjatë rrugës mbi këtë shkollë të Vermicës, e cila është shumë e rrezikshme për nxënësit. Ju kisha lut të futët në planin e buxhetit. Unë po shpresoj që shumë shpejt do të merreni me këto probleme dhe të bëni një zgjidhje.

**Dafina Billaca (PDK):** Unë sot dua të ngrisë çështjen rreth çerdheve publike. Nuk di sa ju kujtohet partitë në pozitë dhe sidomos VV-ja, kryetari aktual, u pat premtuar qytetarëve të Prizrenit, se gjatë mandatit të ti do të ndërtoj apo do të bëjë edhe disa çerdhe të reja publike. Unë në listën e projekteve të investimeve kapitale nuk vërejtja ndonjë projekt të tillë. Të gjithë e dimë se sot nënës e cila punon ndoshta edhe për ekzistencë familjare, i pamundësohet të ketë një vend të punës pikërisht për shkak të mungesës së çerdhes publike. Duke i ditur rrogat dhe të ardhurat e një familje. Këstet mujore në çerdhet private shkojnë prej 70-90 € në muaj për një fëmijë. E çka të flasim për ato familje apo ato nëna që ndoshta kanë dy fëmijë të moshës për të qëndruar në çerdhe. Shprehë këtë shqetësim së pari si nënë, pastaj si qytetare dhe kuvendare e Kuvendit komunal. Kërkoj nga kryetari ti rishikoj premtimet e tij të dhëna gjatë fushatës dhe në listën e projekteve për investime të paktën të jetë edhe një çerdhe apo dy publike. Dhe ajo duhet të jetë në lagjen Ortakoll ose Arbanë. Me

qëllim që lagjet ose rrethina e asaj pjese të ketë çerdhet më afër. Ne të gjithë e dimë që e vetmja çerdhe publike është e planifikuar në lagjen Bajram Curr. Madje është një projekt si rezultat i kërkesave të grave kuvendarëve të legjislaturës së kaluar. Andaj do të kisha qenë mjaftë falënderuese që kjo kërkesë e imja të ketë mbështetjen e të gjitha grave kuvendare të këtij Kuvendi. Por edhe shumë falënderuese nëse kjo do të merrej si prioritet edhe nga kuvendarët e gjinisë mashkullore. Dhe të mos kaloj ky propozim buxhet për vitin 2019 dhe parashikimi për vitin 2020 dhe 2021 pa u futur edhe projekti edhe për një çerdhe tjetër publike, e cila do të ishte në interes të qytetarëve të Prizrenit.

**Shukri Quni:** Kërkoj nga drejtori i Bujqësisë Egzon Elshani, që në mbledhjen e ardhshme të bie një raport, se kush janë dhe a i kanë plotësuar kriteret këta persona që janë përfitues për kafshë (lopë), që i kanë marrë këto subvencione. Ndërsa e përshëndes Kuvendin e komunës që e ka kthye pushimoren e fëmijëve në fshatin Nashec. Është një punë shumë e mirë që është bërë, sepse kjo ka mbet në mëshirën e kohës, qysh edhe në kohën të qeverisjes edhe të partisë demokratike. Që ka bo shumë herë kërkesa të tilla por s'ka mund me e realizua. Mirëpo dua të di si e ka marrë komuna pushimoren ne Nashec? A është në shfrytëzim, a është me qira, apo është marr në shfrytëzim të përhershëm? Sepse ne jemi mundua me marr si komunë, kemi bisedua edhe me zëvendësministrin, atëherë ka Gjergj Dedaj dhe ministri Arban Abrashi i Mirëqenies Sociale, edhe nuk kemi arrit. Kështu që unë i përgëzoj ata të cilët kanë arrit me krye këtë punë, se është bërë një punë jashtëzakonisht e mirë për qytetarët. Edhe një pyetje është për Drejtorin e Inspektorateve, apo Shërbimeve Publike. Kërkoj të di që prerja e asfaltit që po bëhet a kthehet siç ka qenë në gjendjen e mëparshme. Këtë pyetje po e përsërisë që shumë herë dhe nëse doni të dini se ku është prerë asfalti, unë ju tregoi. Ai që e prenë asfaltin duhet ta kthej në gjendjen e mëparshme, apo duhet ta dënoni. Kërkoj që pyetjet që parashtrohen, të kthehen përgjigje.

**Memnuna Ajdini:** Ja se izvinjavam svojim bošnjacima što na po etku nisam cestitao dan bošnjaka. Evo koristim priliku da cestitam svim bošnjacima naš dan, kako na Kosovu, tako u diaspori i svuda gde nas ima. To sam tako e o ekivala bar od predsedavaju eg ako ništa drugo. Ja sam izašla sa pitanjima koje želim ovde ista i. Prvo pitanja se odnosi na direktora Obrazovanja g. Susuri. Pitanje je vezana sakonkrs u selu Re anu, škola dakle „Meto Bajraktari“. Obzirom da je taj konkurs anuliran ili nije dovršen. Ja želim da dobijem odgovor, zbog ega je to tako. Obzirom da je bio potpuno regularan. Da su ispunjeni svih kriterikjumi po konkursu. Ali tako e i to ula da je bilo politi kih pritisaka, od strane predsednice NDS-a Emilije Re epi. Što je nedopustivo da vrši takav pritisak i da anulira nešto što je sasvim regularno. Tako e je vršen pritisak i na ostale direktore, i na ostalo prosvetno osoblje u

Župi. Što se ti e drugog pitanja ono se odnosi na direktora za Javne Usluge. Jedan zahtev koje godinama dakle da kažem ponavljam na žalost, nije odra en, nema sluha ili vlas ili ko ve . Ali poželno i treba da jednom odradi, a to su stajališta u regiji Župe i Podgore. Gde naši ljudi koji putuju. Nažalost moraju po svim vremenskim prilikama ili neprilikama da stoje na stajalištima. Da li se radi o starim osobama, da li se radi o trudnicama, maloj deci. Zaista je nedopustivo da u XXI veku još tako ekaju prevoz. I ja se nadam da zaista u najskorije vreme to bude rešeno. I još jedna molba i ako se ti e Ministarstva za Infrastrukturu. Ja bi zamolila Direktorijat naš za Javne Usluge. Da ipak bar one udarne rupe koje su na relaciji Ralin-Krk bunar znate gde se radi ta deonica vodovoda. Ja verejuem i o ekujem da e te u najskorije vreme, tako e ponovo sanirate te rupe. I evo javno u ista i da sto to odradili skora. Ali na žalost obzirom da je frekfentan put, ponovo su pojavile rupe. Te su naši prolaznici svih u zaobra aju koji prolaze, jako nezadovljni sadašnji stanjem.

**Sadije Osaj Jakupi (LDK):** Pyetja ime i drejtohet kryetari dhe kryesuesit. Cila është arsyeja e mos formimit të komisionit për arsim, në suaza të Kuvendit komunal të Prizrenit, i cili komision do të na kishte lehtësuar shumë punë neve si kuvendarë në elaborimin e nevojave, sfidave, gjetjeve të zgjidhjeve më të mira edhe për investime kapitale dhe arritjeve të objektivave të MASHT-it që janë obligative për DKA-në. E di që brenda këtij Kuvendi ka njerëz që i përket fushës së arsimit, që më të vërtetë do të jepnin kontributin edhe pa pagesë. Ose të jepet një mundësi e stimulimit material për këta anëtarë.

### **Cenet Sajadi (KDTP): 52:35**

**Fatmir Kastrati (AAK):** Me 28.06. si zakonisht që e shtroj që dhjetë vjet pyetjen në lidhje me ujin e pijes në lagjen “2 Korriku” e “11 Marsi”, përgjigjen e kam marr me shkrim. Besoni që aq shumë jam gëzuar sa që e kam postuar edhe në rrjete sociale për ti gëzuar qytetarët. Përgjigja është kjo. Lidhur me furnizimin me ujë, për lagjet në fjalë, mund t’ju themi se ne si drejtori jemi duke bërë implementimin e projektit, në të cilin projekt është i paraparë edhe furnizimi me ujë për lagjet në fjalë. Punimet janë duke vazhduar dhe nëse vazhdohet me këtë dinamikë, mendojmë gjatë muajit korrik punimet të përfundojnë. Si pjesë e punimeve, është ndërtimi i një rezervuari dhe gypsjellësit. Mundem t’ju sqaroj se punimet janë para përfundimit dhe thuhet se vetëm sistemi i pompave duhet të instalohet ose disa punime rreth asaj. Çështja shumë më rëndësi është se për këtë vit nuk ka mjete të mjaftueshme për realizimin e këtij projekti. Andaj pavarësisht nga ky operator i cili është duke i realizuar punimet dhe është duke përfunduar kontratën. Mirëpo, po hymë në muajin tetor dhe një gjë e tillë nuk është bërë ende. Edhe i bashkëngjitëm edhe asaj që tha z. Alush Shala më herët. Edhe nuk e di, që drejtorët shkuan, kryetari i komunës qenka këtu, kryesuesi jo. Nuk e di pse mbahen këto mbledhje të

asamblesë komunale. Do më thënë neve vetëm na mashtrojnë me kësi përgjigje. Unë u gëzova thash që e morra me shkrim. Mirëpo, megjithatë kjo vetëm në letër ka mbetur, sepse qytetarët janë edhe më të zhgënjyer. Edhe normalisht se më drejtohen vazhdimisht me pyetje se çka na mashtrove me atë letër. Dhe vërtetë po del se i kam mashtrua edhe unë. Prandaj kërkoj nga drejtori i Shërbimeve Publike që të na jep një përgjigje më të saktë. A ka mundësi këtu me na dhënë përgjigje bre. Se me letra po na japin, edhe që e kreva unë obligimin tim. E dha ky përgjigje edhe le të bëhet çka të bëhet më tutje. Nuk e di ku na qon kjo punë. A dojmë me krye punë, a nuk dojmë me krye punë. Dhe pse janë drejtorët. Në qoftë se s'mundet mu krye, thuaj edhe dhjet vjet nuk ka mu krye dhe e dimë se s'ka mu krye.

**Behar Begaj (LDK):** Unë kisha pas dëshirë që të ishte këtu edhe drejtori i Shërbimeve Publike. Por përsëri po e them atë që kisha për ta thënë. Unë e kam pa këtu se janë nda disa mjete për shtimin e kapacitetit të ujit. Dhe desha ta pyes pikërisht drejtorin se a janë të mjaftueshme këto mjete që janë nda për shtimin e këtij kapaciteti të ujit. Apo do të vazhdojmë gjithnjë ne, të vijmë këtu dhe të flasim për ujin dhe vetëm për ujin. Përpos shtimit të kapacitetit të ujit, aty është paraparë që të bëhet edhe ndërrimi i pompave të ujit. Ku më siguri se ato pompa janë të kushtueshme. Me këtë buxhet, nuk mund ta marr me mend që mund ti mbuloj të gjitha këto intervenime që do të bëhen në Zhur. Tjetra është për Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Drejtor unë e kam pa këtu se ju keni ndarë një buxhet për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe renovimin e terreneve sportive dhe kulturore. Një buxhet shumë të vogël rreth 50.000 € Si do të funksionalizoni ju shtëpinë e kulturës në Zhur me këtë buxhet, kur e dini se dhjetë vite kanë kalua, kemi hy në fazën e vitit të njëmbëdhjetë dhe ne ende diskutojmë për shtëpinë e kulturës. Ne i kemi premtuar elektoratit edhe ju kur keni ardhur në Zhur, me kryetarin e juaj, keni premtuar se kjo do të zgjidhet sa më shpejt që është e mundur. Një vit kaloi dhe deri më tani asnjë lëvizje s'është bërë aty. Qytetarët po presin për çdo ditë se çka do të bëhet me shtëpinë e kulturës. E dyta drejtor pikërisht për ju, është se klubi futbollist "Vllaznia" e Zhurit, daton prej vitit 1968, dhe ju vitin e kaluar e keni ndarë një shumë subvencione prej 3.000 € këtë e dinë krejt, sepse është bërë publike. Drejtor në rast se ti mendon se me këtë shumë mbahet ky klub, atëherë ju kisha ftua juve dhe ju kisha emëruar president i klubit. Urdhëroni menaxhoni klubin, në rast se ju mendoni se mund të menaxhohet një klub me kaç mjete. Unë e pash se ju keni ndarë për projekte politike zhvillimor të kulturës, rinisë dhe sportit një shumë mund të them ndoshta e mjaftueshme. Por nuk kërkojmë më të na subvenciononi, por të na ndani mjete, të mbështetni klubin, ashtu siç e meriton një klub një mbështetje nga Kuvendi komunal. Unë nuk them që të jemi të barabartë me klubin futbollistik "Liria". Por të paktën të përafrohemi në një përqindje shumë më të vogël dhe ti mbuloni kërkesat tona. Edhe pse kemi edhe donator, por shpenzimet janë shumë të mëdha. Kisha kërkuar nga drejtori i

Shërbimeve Publike, që të bëhet edhe funksionimi i rrjetit elektrik, prej lagjes Bajrami Curri e deri në Zhur. Kur dihet se është një hapësirë 12 kilometra dhe nevojat janë shumë të mëdha. Qytetarët detyrohet të paguajnë në mënyrë private, për një kyçje të rrjetit elektrik. Kjo do ti lehtëson të gjitha bizneset dhe të gjithë qytetarët të cilët kanë kalua me vendbanime në ato zona. Tjetra është për drejtorin e Shërbimeve Publike. Kemi bisedua dhe e kemi bërë kërkesën për kanalizimin në Zhurit të ri. Me këto mjete që janë nda, nuk është cek as kanalizimi i Zhurit të ri. Por me ato mjete nuk mund të mbulohet kjo pjesë. Unë kisha kërkuar që të shqyrtohet edhe njëherë, të diskutohet edhe njëherë, ta shikoj edhe njëherë buxhetin dhe ta merr më serioz këtë çështje.

**Kujtesa Kabashi Shatri (LDK):** Unë e kam një pyetje për drejtorin e Shëndetësisë. Edhe pse në fshatin Kushnin ka qendër shëndetësore, ambulancë, në këtë ambulancë nuk ka mjek që të ofroj shërbime për pacient. Për një kontroll të thjesht shëndetësore duhet të bëhen dhjet kilometra deri në Romajë. Edhe përkundër që mjeku në Kushnin punon dy herë në javë, ka më shumë se dy muaj që nuk ka mjek në ambulancë, në fshat në bazë të orarit. Pyetja ime është kur do të filloj punën mjeku në Kushnin, dhe sa herë në javë.

**Kastriot Krasniqi (PDK):** Unë e kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, po më duket paska shkua me pi kafe. Pasi të vjen drejtori kam qejf me bo një pyetje. Se që tri herë po e bëjë pa u kon ky. Përgjigje s'kthen kurrkush.

**Vjollca Kabashi (AAK):** Pyetjen e parë do t'ia parashtroi drejtorit të Arsimit. A jeni në dijeni që maturantët nuk kanë profesor të matematikës që sa kohë, që sa ka fillua procesi mësimor dhe ata bredhin rrugëve. Ku tash është momenti i tyre ku nuk duhet ta humbin asnjë orë kot. Pyetjen tjetër e parashtroj për drejtorin e Shërbimeve Publike. Mirëpo ai prapë nuk është prezent. Unë pyetjet po i paraqes. Në pyetjen e parashtruar në lidhje m rrugën e “Duhit”, sa po e mora përgjigjen. Thotë se do të dalim në rishikim. Kompania për mirëmbajtjen e rrugëve, pas vizitës në teren, inxhinierët me dal në rishikim. Për këtë rrugë që kam bërë kërkesë. Mirëpo, prapë e shtroj kërkesën. Rruga e “Duhit” me gjatësi 480 metra, e gjerë me 5 metra, e ndërtuar me mjete të qytetarëve para lufte, është dëmtuar për shkak të punimeve nëntokësore, të cilat në atë kohë kanë qenë të papunuara. Pas luftës në këtë rrugë është punuar sistemi i ujësjellësit, kanalizimi dhe rruga është dëmtuar shumë. Po për këtë rrugë është bërë kërkesë në komunë edhe nga banorët e lagjes. Pyetja tjetër është të rregullohet transporti në fshatin Korishë, ku transporti është tri herë në ditë. Dhe banorët në qoftë se në atë kohë, nuk mund të nxënë autobusin, duhet të ecin në këmbë një kilometër e gjysmë, prej rrugës kryesore. Ju kisha lutur që të rregullohet linja për banorët, në bashkëpunim me firmën që e ka kontratën me linjën lokale. Dhe paga të jetë për nxënësit prej 30 cent, sepse tash është 50

cent. Ku 50 cent nxënësit nga Theranda vinë në Prizren. E fshati Korishë udhëton 50 cent prej fshatit Korish në Prizren.

**Kastriot Krasniqi:** Drejtor a e përfundove kafen a? Drejtor e kam një pyetje, e kam ngritë edhe më herët këtë çështje. Një mur mbrojtës në rrugën “Afrim Krasniqi”, janë diku 15 shtëpi aty. E kanë të pamundshme me kalua. Hera e dytë është që po e bëjë pyetje. A keni ndërmarrë diçka në raport me lidhje me atë mur apo jo.

### **Cengis Cesko (KDTP): 01.03.13**

**Azem Durmiši (NDS):** Obom prilikm estitam svim bošnjacima dan bošnjaka ma gde bili. Kako u Republici Kosovo tako i van nje. I da ga taj praznik još dugo, dugo slave. A vama kolege i direktorima i predsedavaju i uputim poziv da budete po asni gosti našoj akademiji. Koja e se održati danas u 18.00 asova u ovoj Sali. I da prisustvujete zajedno da proslavimo naš praznik. Što se ti e pitanja. Želim da uputim jedno upozorenje i jedan zahtev direktoru za Urbanizam i Prostornog Planiranje. Ovaj zahtev što hitnije udovolji u toku današnjeg dana. Da pošalje nadležne organe u selu Manistirica zbog uzurpacije društvene imovine, od strane privatnog lica. Je ja nisam naišao na nadležne organe na razumevanje. Drugo pitanje koje želim gradona elniku, u vezi prostorijske kod bivše proizvođača Liria u Re ane. Odgovor koji mogu da dobijem jeste od gradona elnika, da li je ta prostorija izuzeta od agencije za privatizaciju. I sada e opština Prizren koristiti za svoje potrebe. Ili još nije rešeno pitanje. I još jedno pitanje imam ve od 16 juna, u selu Manastirici su etiri elektri na stuba na zemlji, i elektri ni provodnici nisko se nalaze kroz travu i zemlje jednog privatnika. I to kroz baštu. I sa onim organima tako e nisam naišao na razumevanje. Ve evo etvrti mesec kako ekamo da nedaj Bože da neko nastrada pa tek da rešavamo problem.

**Petrit Hoxhaj (LDK):** Pasi që është ndërtua qendra kulturore e boshnjakëve, ndërsa tash është paraparë edhe qendra kulturore turke. Kam një pyetje, kur do të ndërtohen edhe qendrat kulturore edhe të komuniteteve tjera, do të thotë RAE. Pasi që edhe ata janë banorë të këtij qyteti.

**Kryesuesi:** Unë më sa e di ata e kanë një qendër kulturore të “Jeta e Re”. Po nuk e di çfarë statusi ka.

**Illir Baldedaj:** Një pyetje drejtorit të Bujqësisë. Kur do ta publikon listën e përfitimit të multikultivatorëve nga fermerët. Sepse është rregull e transparencës, që çdo vendim kur të merret edhe të publikohet edhe në ueb sajt të komunës.

**Skender Susuru, drejtor i Drejtorisë për Arsim:** Fillimisht në shenjë respekti për Kuvendit. Edhe pse kuvendarë të caktuar nuk qëndrojnë ti dëgjojnë përgjigjet. Unë për këtë seancë e kam përgatit një informatë të hollësishme për fillimin e vitit shkollor. Mirëpo informata është larguar nga rendi i ditës me vendim të KPF-së. Unë zakonisht informatat i dërgoj me kohë. Mirëpo, për shkak të numrit të nxënësve, që nuk kam pas numrin e saktë, nuk kam dashtë me dorëzua një raport i cili është gjysmak. Sepse fillim viti përcillet me probleme sidomos me regjistrimin e nxënësve në klasën e parë dhe me regjistrimin e nxënësve në shkolla të mesme, nga që ka lëvizje. Dhe në këtë raport kam qenë shumë korrekt, do t'ua përcjelli në adresat e juaj. I kam paraqit edhe sfidat me të cilat jam ballafaqua në fillim të vitit shkollor. Edhe një nga sfidat më evidente, është edhe mungesa e stafit në disa shkolla. Kjo për pasojë profesoreshë dhe kuvendare e nderuar, për shkak të bazës ligjore, e cila ia lidh duart drejtorit të DKA-së për me veprua. Unë dua të sillem brenda numri 2250 punëtor. Dhe nuk guxoj me marrë asnjë punëtor të vetëm pa institucionin e konkursit. As edhe për 30 pune. Unë kam reagua vetëm në dy vende, që kam dërgua mësimdhënës nga listat e punëtorëve që i kam. Një ka ndodh në shkollën “Xhevat Berisha” në ent parafillor dhe një ka ndodh në shkollën “Motrat Çiriazit”. Kur një mësimdhënëse i është e rënduar tejet gjendja shëndetësore. Dhe unë e kam pas një mësuese në listë që ka qenë dhe e kam qua. Përndryshe jam i vetëdijshëm që në disa vende ka telashe. Telashet më të mëdha kanë ndodh në Zhur, ku kam pas mungesë të dy mësimdhënësve klasor. Ka ndodh në Velezhë, në Caparc dhe Gorozhup. Ka edhe në shkolla të mesme. Por vërtetë unë nuk kam mund me zgjidhë, sepse jashtë institucionit të konkursit nuk mundem me reagua. Por këtu do të jemi shumë korrekt që vet drejtorët e institucioneve, duhet të gjinden në situata të tilla dhe mos të humbin orë mësimore. Tash a kanë mundur mu gjend mirë a jo, unë nuk po dua me hy. Unë faktikisht kam qenë peng i bazës ligjore. Sa i përket pyetjeve të kuvendarëve, i falënderoj të gjithë të cilët kanë parashtruar pyetje. Do të filloj me pyetjen e parë. Po më vjen keq që Haziz Hodaj s'qenka këtu. Lëshon akuza ndaj drejtorit të DKA-së dhe DKA-së, sa i përket institucionit të konkursit. Edhe atëherë kam thënë, edhe tash po e përsërisë, Skender Susuri si drejtor i DKA-së, nuk merr pjesë në pikëzim të asnjë kandidati. Nuk kam asnjë interferencë. Kuvendarët të caktuar jo kësaj radhe po herën e kaluar kanë ardhur në zyre tek unë, kanë bisedua. Dhe unë i kam thënë edhe atëherë unë nuk marrë pjesë pikëzim. Edhe tash po ju them çdo pikëzim që e kanë bo, është pikëzim që e ka komisioni përkatës, që e ka emërua kryetari i komunës. Dhe të jeni të bindur sa herë që unë do të jem drejtori, unë nuk përzihem në këto çështje. Po i kam garantuar edhe atëherë drejtorët aktual, që ata të cilët nuk rizgjidhen, do ti trajtoj më shumë se me dinjitet. Nuk do ti lë me bredh rrugëve, qysh kam bredh vetë. Sepse e di çka do më thënë me dal prej sistemit edhe mos me punua. Por të jeni të bindur dhe po ua jap fjalën Skender Susuri nuk interferon në asnjë zgjedhje. Zgjedhja më mirë e mundur është një zgjedhje solide. Sa i përket çështjes që e



ka ngrit shefi i grupit të kuvendarëve të PDK-së z. Krasniqi. Po është e vërtetë qëndron ajo që unë kam marr një vendim, për të cilin unë kam menduar se është vendim i drejt. Unë edhe sot kësaj dite mendoj se është vendim i drejt. Mirëpo unë kam një vendim të inspektoratit të punës, i cili më ka obligua që mund të bëjë anulimin e konkursit për pesë mjek të cilët kanë punua me punë sekondare. Unë faktikisht i kam paralajmërua mjekët. Mirëpo i kam paralajmërua nëpërmes institucionit të drejtorit të shkollës. Dhe kam kërkuar një informatë nga drejtori i shkollës, përkatësisht ushtruesja e detyrës që ka qenë. Cila ka qenë forma që ata kanë bo informimin e këtyre mjekëve. Dhe do të konsultohem me jurist të cilët e njohin këtë çështje. Nëse vërtetë unë kam shkel ligjin, normalisht unë zbatoj vendimin e inspektorëve. Gjithmonë ju kam thënë, tash po e përsërisë prapë. Në asnjë rrethanë unë nuk e kontestoj asnjë vendim të inspektorit të punës. Veproju sipas vendimeve të inspektorit të punës. Atyre mjekëve nuk i është ndërprerë kontrata e punës për përgatitje profesionale. Po për shkak se unë kam mendua që punë sekondare në arsim nuk mund me pas. Ne do vazhdojmë me punua në këtë drejtim. Të gjithë ata profesor të cilët janë me punë sekondare në arsim, ne do të tentojmë me marrëveshje, pastaj edhe me bazë ligjore që ta mbanë një punë primare, jo dy punë. Ka profesor që jep mësim në shkolla të mesme, njëkohësisht jep mësim edhe në fakultet. Ne me profesorë të tillë nuk dëshirojmë të kemi punë, sepse kemi shumë vajza dhe djem të ri të cilët presin për punë. Ky ka qenë motivi. Por nëse drejtori edhe njëherë po them e ka shkel ligjin, unë zbatoj vendimin e inspektorit të punës. Sepse nuk jam i interesuar me dëmtua buxhetin. Dhe në atë moment kur e dëmtoj buxhetin e Kosovës, jam deklarua se nuk jam drejtor i DKA-së. Sa i përket pyetjeve të kuvendarit Alush Shala, i kam tri pyetje. Pyetja e parë ka pas të bëjë me shkollën e muzikës. Ka një operator ekonomik që e ka fitua një tender. Por ka një ankesë nga një operator tjetër. Dhe është në fazën e analizave, apo vlerësimeve në OSHP. Ne shpresojmë që ai operator që e ka fitua të filloj me punua. Çerdhja “11 Marsi” është duke u vazhduar puna, për aq sa ka mjete. Por me sa unë jam i informuar operatori ekonomik është duke punuar mirë. Sa i përket vendit për ndërtimin e shkollës, unë e njoh mirë territorin e lagjes “11 Marsi”. Paradite e kam marrë informacionin se është sigurua një lokacion. Dhe për një afat të shkurt nuk e di kur do të vinë përfaqësuesit e MASHT-it dhe të BE-së dhe përfundimisht do të japin dritën e gjelbër mundet mu nis ajo shkollë. Sa i përket kuvendares Agnesa Sinani. Po plotësisht qëndron ajo çka ka thënë. Edhe në raport që ju do ta merrni. Qëndron se ne në tri objekte shkollore, vitin shkollor e kemi fillua me telashe të mëdha. Njëra prej tyre është sholla në Shkozë. Tjetra është shkolla në Gjonaj lokalit i vjetër. Ditën e parë edhe në informatë keni me pa, mësimi nuk ka fillua në Shkozë. Ka pas një shqetësim të qytetarëve. Pastaj unë jam takua me ta, i kam dhënë disa premtime. Disa prej premtimeve të mija janë realizua, siç është inventarizimi i shkollës me banka e karrige dhe shtrimi i dyshemesë që pritet me ndodh. Ndërsa për vitin 2019 është një pozicion buxhetor rreth 80.000 €, për një renovim të tërësishëm

të objektit shkollor. Sa i përket punëtorit ndihmës, aty ka pas një institucion të konkursit. Mirëpo në mungesë kandidatit për kualifikim, për fat të keq në shkollë të mesme që po kërkohet, ai konkurs është anuluar. Konkursi është rihap. Unë uroj që sa më shpejt të bëhet një zgjidhje. Normal duke respektuar edhe mendimin e komunitetit. E thash edhe njëherë që kam pas sfida për mësimdhënës, kjo vlen edhe për shkollën në Vermicë, përkatësisht paralelen në shkollën Shkozë. Sa i përket Dobrushtit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ka ndarë një fond dhe ajo e bënë një renovim të tërësishëm në vitin 2019 të shkollës në Dobrusht. Sa i përket pyetjes së kuvendares Memnuna Ajdini. Unë e thash edhe në gjuhën shqipe, po e përsërisë edhe njëherë vlen edhe për këtë rast. Unë nuk mund të flas për asnjë rast të emërimit apo propozimit të drejtorëve nga ana e komisionit. Unë personalisht si drejtor i DKA-së nuk kam pas asnjë shqetësim nga asnjë nga deputetet, pa emër të përveçëm. Tani a është vendim i drejtë apo jo nuk e di, mbetet mu pa. Profesoreshë tregova si është gjendja edhe në shkollat e mesme ka, po e zëmë te matematika. Ka edhe vende tjera. Mirëpo, unë vërtetë unë jam përballë me një situatë profesor Kastrati tepër të ndjeshme. Sepse brenda sistemit ka mësimdhënës të cilët janë të kualifikuar me një fushë profesionale, ndërsa kanë mbajtur mësim me një fushë tjetër. Ka qenë dashtë me punua shumë për me normalizua sistemin. Unë nuk mundem me largua nga sistemi një punëtor arsimor i cili ka punua tre apo më shumë vite. Unë sot deklaroj shumë me përgjegjësi, që ne pas një pune të madhe që kemi bërë, asnjë punëtor arsimor nuk e kemi largua nga listat e pagave. Dhe asnjë punëtor arsimor prej një fushe të caktuar nuk mban mësim në fushën tjetër. Nuk ka anomali që kemi pas vitin e kaluar. Një arsimtar apo profesor i gjuhës angleze me mbajtur mësim gjuhë gjermane. Një fizicient me dhënë gjuhë gjermane e kështu me radhë. Po flas për vitin që po fillon. Sherife këtu po ta jap fjalën në foltore, nëse ka me pas rast që me dhënë mësim. Jo, jo po nuk ka sepse jemi mundua maksimalisht me bo. Kemi minimalisht pesë punëtor, mësimdhënës të ri të gjuhës gjermane që futen në sistem. Nuk ka me pas asnjë. Nuk ka me pas një kimist me dhënë një lëndë tjetër. Sa i përket kuvendarit Avdaj, unë nuk dua me dhënë përgjigje jo për diçka. Unë nuk marrë gjëra personale. Por unë nuk kam faj dikush ku nuk bëhet drejtor. Sepse nuk varët ajo nga unë. Unë për shumë ish drejtorë duke përfshirë edhe një që po aludon ai, kam pas respekt dhe kam respekt. Mirëpo respekti dhe baza ligjorë dhe faktorët të tjerë janë tjetër çka. Sa i përket kualifikimeve të mija shkollore, unë kam një CV. Kush donë me hap atë CV-in me pa a kam diplomua njëzetë vjet a njëzetë e pesë vjet nuk i di. Ajo është punë e ime. Unë e kam një CV të begatshme. Nuk i kam thënë vetit ekspert, as nuk dua kush me më thënë ekspert. As nuk i them dikujt ekspert. Por unë e jap kontributi tim për atë që kam mundur në cilësinë e drejtorit të KDA-së. Në momentin kur unë e zhgënjej institucionin e kryetarit të komunës. Në momentin kur unë e zhgënjej Kuvendin, unë nuk kam arsye me qëndrua drejtor. E kam thënë edhe atëherë, po e them edhe tash. Edhe unë gjithmonë kur flas në foltore, flas shumë me respekt për partitë politike. Sepse

kam thënë i respektoj si institucione, si PDK-në, si LDK-në. Është shumë e keqe, shumë e ulët, shumë jo etike, kuvendarë të caktuar me sulmua drejtorin e DKA-së, le ta sulmoje, por jo subjektin politik. se ta sulmosh një subjekt politik, nëse dështon një dështon një drejtor, nuk është korrekte. Ta sulmosh një subjekt politik, nëse një kuvendar i tij sillet në mënyrë jo etike, është jo korrekte.

**Simir Krasniqi:** Unë desha të sqarohem me vendimin e drejtorit të Arsimit për largimin e këtyre mjekëve. Drejtori duhet ta di se shkolla e mesme e Mjekësisë, është shkollë profesionale. Ne e dimë se në të gjitha shkollat profesionale në regjion si në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, atje punojnë të gjithë mjek specialist me pagë sekondare. U tha që ata janë lajmëruar më herët, ata nuk janë lajmëruar për largimin e tyre. Ky ka qenë një largim politik i këtyre mjekëve. Në qoftë se shikohet ligji punës. Në ligjin e punës thotë shumë mirë drejtor që, në qoftë se dikujt donë t'ia ndërpret kontratën e punës. Ai në qoftë se ka përvojë të punës dy deri në dhjetë vjet, duhet 30 ditë më herët të lajmërohet në formën e shkruar. Në qoftë se ka mbi 10 vite përvojë pune, ai duhet të lajmërohet 45 ditë. Ku ne kemi mësimdhënës aty që ka punua 28 vite në shkollën e mjekësisë, është mjek specialist. Dhe me ata mësimdhënës shkolla e Mjekësisë mund të themi që ka qenë shkolla elite në nivel të Kosovës. Dhe a thua mban përgjegjësi që një muaj ditë për ata nxënës të cilët nuk mbajnë mësim për lëndët mjekësore profesionale.

**Bardhi Avdaj:** I nderuri komunist dhe veteran i studimeve baçellër. Qëllimi im ishte tu tregoj qytetarëve të Prizrenit se kush është fytyra e juaj e vërtetë. Tash mbetet tek ata dhe te kryetari të merr masa ndaj jush. Unë ju drejtohem juve si asamblist dhe qytetarëve të Prizrenit me këto argumente. Ky drejtor i juaj i famshëm, gati po përfundon muaji shtator dhe ka më se 50 mësimdhënës që nuk janë zgjedhur për shkak të papërgjegjësisë të këtij drejtori. Që janë me qindra orë mësimi që humbin nxënësit në shkollat tona. Kryesues dhe kryetar i nderuar, ky analfabet duhet të shkoj në shtëpi, sepse nuk është ka udhëheq. Është ky një lavire politike që i ndërron kah pesë, gjashtë parti.

**Kryesuesi:** i nderuar, i ftoj anëtarët e Kuvendit që ti përmbahen fjalorit politik. Mund të ketë situata ku ne pajtohemi ose s'pajtohemi. Po gjuha e tillë është absolutisht e papranueshme në këtë Kuvend. Ju kisha lut që ti përmbahemi rendit, rregullit dhe të vazhdoj seanca në mënyrë të rregullt. Nuk mund të lejojmë fjalorë të tilla. Edhe pse vinë nga një herë situata të acarimeve. Është punë normale e një organi. Prandaj nuk po besoj që ka arsye për një diçka të tillë.

**Alush Shala:** Unë nuk desha dhe s'kam replikë për drejtorin e Arsimit. Por një kërkesë po më vjen e shkruar që nja pesë, gjashtë herë drejtor. Kërkesa e qytetarit, mësues në shkollën "Fatmir Berisha", thotë: A është pranuar dikush në

shkollën “Fatmir Berisha” pa konkurs fare. Dhe nëse donë për korrektësi, bëhet fjalë për në gjuhën angleze.

**Skender Susuri:** Unë thash edhe njëherë respektoj çdo kuvendarë dhe Kuvendin. Përndryshe, nuk ka problem nëse dikush mendon se është dikushi ka edhe tjera mekanizma. Po unë e respektoj institucionin. Edhe njëherë po e përsërisë, sa i përket sqarimit me shefin e grupit të kuvendarëve të jesh i bindur që nuk kam marrë vendim politik. Thash edhe njëherë, nëse ndodh që vendimi i drejtorit ka qenë arbitrare, unë respektoj vendimin e inspektorit. Nuk e atakoj asnjë vendim të inspektorit. Sepse nëse atakoj një vendim të inspektorit, dëmtoj buxhetin komunal. Nuk jam i interesuar me dëmtua buxhetin komunal. Në moment kur e dëmtoj buxhetin komunal, unë jap dorëheqje prej drejtorit. Dhe do të konsultohem. Unë i kam dy dilema aty. Sepse është e vërtetë që duhet mu informua më herët. Por është edhe një vërtetë edhe më e madhe, se në kontratën kolektive shënon do më thënë të përfundon kontrata me skadim. Dhe në arsyetim që e ka dhënë inspektorati, ka thënë që fillimisht unë mi shtjer burimet e brendshme. Ne, në vend të atyre mjekëve, nuk jemi duke dashtë me i marrë ata që s’janë mjek, po ata mjek që aktualisht nuk kanë punë. Nëse nuk kam të drejtë, atëherë unë e zbatoj vendimin e inspektorit. Motive politike absolut nuk kam, sepse ka tjerë që punojnë me punë primare aty edhe kanë vazhdua me qenë. Do ta dëshmoj koha a ka qenë motiv politik apo jo. Ndërsa la Lush po të përgjigjem me përgjegjësi të plot. Ajo arsimitare e gjuhës angleze nuk është që ka shkua pa konkurs. Ata që punojnë brenda sistemit e dinë. Ajo është një arsimitare e cila i ka 19 vite përvojë pune në Velezhë dhe aktualisht ka mungesë të orëve. Dhe aty ku ka mungesë të orëve, ju lejohet drejtorit me bo një bartje nga ajo shkollë në atë shkollë. Do të thotë është arsimitare me vendim e pranuar para 19 viteve dhe punon në Velezhë. Nuk ka fillua, por nga dita e hënë fillon në shkollën “Fatmir Berisha” me plotësua numrin e orëve. Unë thash vetëm dy pozicione i kam luajt. Nuk desha me i përmend cila është gjendja shëndetësore e një mësueses në “Motrat Çiriazhi”. Dhe kam reagua në “Xhevat Berisha”. Nuk kam pas brenda sistemit me reagua edhe në Hatmaxhë, ku është duke humb edhe klasa parafillore.

**Simir Krasniqi:** Drejtor, ju e thatë që nuk ka qenë motiv politik. Ata profesor tash kanë punua kah 28 vite në atë shkollë. Kanë ndryshua politika e politika. Pse nuk janë largua deri më tash ata profesor, ku dihet mirë që edhe ligji i punës, pagë sekondare ta lejon pas orarit të punës. Ata kanë punuar pas orarit të punës. Edhe nuk e di çfarë dëmtim të buxhetit ka, kur ju po doni me shndërrua shkollën e mjekësisë, në shkollë trajnuese për mësimdhënës. Asnjë mjek që është specialist nuk punon në shkollë të mjekësisë me pagë primare. Këtë e them me bindje. Vetëm është një, po nuk mundemi atë, është mishërua me arsimin. Nuk shkon në profesion të mjekut. Por me këtë veprim që ju doni me bo, më vjen keq për nxënësit, për ata prind që shkolla e mjekësisë si shkollë

elite në nivel të Kosovës do të fundosët. Do të bjer ndoshta një ndër shkollat më të dobëta në nivel të Kosovës. Ku do të vinë mjekët do të punësohen, si do punësohet në sektorin e mjekësisë do ta lenë punën. Do të ishte nder ti kemi specialist sikurse që i kemi pas në atë shkollë. Me punën e tyre kjo shkollë ka mbërrë ato rezultate që i ka pas. Ka qenë me Lojollën është, krahasuar drejtor.

**Osman Hajdari, drejtor i Drejtorisë për Administratë:** Një çështje konkrete e ka ngritë asamblisti Berisha, rreth rrjetit të zyrave të vendit. Është shumë e vërtetë që ka problem. Problemi më i madh është në Hoçën e Qytetit. Ka gjashtë muaj që nuk ka sistem. Problemi është të Ministria a Punëve të Brendshme. Ka një kontratë me Kujtesën, kompaninë e rrjetit që e shpërndanë. Edhe tash së fundi Telekom i Kosovës ka fituar atë kontratë. Këta janë në fund të kontratës. Aty është një softuer i prishur që më shumë se shtatë, tetë muaj. Edhe ka mbet thjeshtë në neglizhencën e Ministrisë. Jemi duke diskutua bashkë me menaxhmentin. Ndoshta për një kohë edhe me mbyll këtë shërbimin. Aty ka rrjetë vetëm një orë, prej orës 8:00 në mëngjes deri në orën 9:00. Dhe mbas orës 9:00 është vështirësi edhe për zyrtarin tim aty që është në punë. Është vështirësi edhe për qytetarët. Atje e kemi një kioskë që është e vendosur nga qeverisja e kaluar, e cila është totalisht jo funksional. Për me funksionalizuar po na vyen procedura, sepse po duhet një kosto financiare me investua. Kemi adresua më shumë se 25-26 shkresa sa i përket Drejtorisë. Mirëpo nuk ka qenë në kompetencë tona. Ato janë kontrata të nivelit qendror, janë përgjegjës Ministria e Punëve të Brendshme. Do më thënë jam i informuar saktë për çdo lëvizje. Edhe një përgjigje për Shukri Qunin për pushimoren e Nashecit. I kemi bërë një kërkesë Qeverisë së Kosovës. Ajo qenka pronë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. E kemi marrë në shfrytëzim për 15 vite. Duke arsyetuar që kemi me shfrytëzua për disa kategori sociale, duke përfshi veteran të luftës, arsimtarë, si dhe grupe që janë, disa organizata si sindrom dawn, fëmijët me autizëm. Do të mundohemi thjesht me shfrytëzua për nevojat tona komunale. Keni has në mirëkuptim edhe të Ministrisë edhe të Qeverisë. Na ka dhënë në shfrytëzim për 15 vite. Po të inkurajoj menjëherë ka jashtëzakonisht shumë të interesuar për me hy në partneritet publiko-privat, për me funksionalizua shumë mirë atë zonë. Edhe po mendoj edhe ti si përfaqësues i asaj zone dhe kushdo që ka me qenë, kanë me qenë të informuar kohë pas kohe. Kjo është për informacion të saktë. Kjo është pronë e shtetit, do më thënë nuk është e AKP-së. Përndryshe ne e kemi një iniciativë në kuadër të ligjit për marrjen e pronave të AKP-së. Kemi nis një listë prej disa objekteve që janë në menaxhim të AKP-së për mi kthye në prona komunale. Po kjo është në procedurë që e kemi përkrahjen edhe të Qeverisë të Kosovës. Do më thënë janë faza. Mirëpo për Nashec, prej Ministrisë, Qeveria e ka miratuar dhe na ka dhënë në shfrytëzim për 15 vite pa qira.

**Shukri Quni:** Unë në fillim e përkraha marrjen e pushimores në Nashec, ku jashtëzakonisht i jemi gëzua të gjithë banorët atje. Se ka mbet ajo djerrinë, janë rojet që e ruajnë aty. Po kjo marrje tash pak më shtini në dyshim që është mirë mu diskutua kjo pak më gjerësisht, sot jo. Se sot më të vërtetë ka tema tjera. Po megjithatë unë ju përgëzoj, se për një gjë të tillë kemi qenë ne... po tash më ra në mend që ju e paskët ministrin e paskët fitua se unë bile së paku nja katër pesë herë kam qenë te zëvendësministri Gjergj Dedaj, po edhe te Arban Abrashi, ministër i Mirëqenies Sociale. E kështu që ju përgëzoj, insha Allah e merr komuna e jo privati.

**Kryesuesi:** Ju drejtor të cilët nuk i kthyet përgjigje këtu, lusim që në seancën e ardhshme ti drejtoni tek anëtarët e Kuvendit. Pa humbur kohë po vazhdojmë me pikën e radhës.

**Pika e katërt:**

**Diskutim, rreth mundësisë për ndërtimin e bustit të Skënderbeut dhe shtatores së Adem Jasharit.**

Siç e ceka edhe në hapje të mbledhjes ka qenë pikë edhe në KPF, dhe si e tillë i është rekomanduar këtij Kuvendi, që ta diskutoj mundësinë e bërjes të këtyre shtatorëve. Atëherë po e hap si diskutim.

**Ilir Baldedaj:** Kryesues, respektoje rregulloren shko me shefat e grupeve parlamentare, pastaj kalo tek kuvendarët individual. Se është rregullorja, atëherë neve po na akuzon që po e shkelim rregulloren. A vetë po e shkel çdo ditë.

**Kryesuesi:** I nderuar kjo formë bile më konvenon më shumë. Po nëse e ke lexuar me kujdes, po shkruan diskutim. Kur vjen puna tek marrja e vendimeve kërkohet nga shefat e grupeve parlamentare. Po njëherë ta diskutojmë dhe ta kryejmë debatin. Nëse ka vendime mu marrë atëherë shkojmë sipas radhës qysh po thua ti.

**Sherife Balaj:** Përhirë të respektit dhe të emrave të shquar u qova edhe në foltore me fol. Më erdh shumë mirë, dhe ju përgëzoj për iniciativën qoftë edhe diskutim ja vlen për këtë gjest shumë të mirë. E mbështesim iniciativën për ngritjen e bustit të heroit kombëtar Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe komandantit legjendar Adem Jashari. Unë me miratimin dhe mbështetjen tuaj kërkoh që në kryeqytetin kulturor historik të shqiptarëve në Prizren, të ngrihet një monument tjetër, qoftë pllakë përkujtimore, apo çfarëdo qoftë për ta nderuar figurën e Pjetër Bogdanit. Familja e bogdanëve ishte nga Hasi i Prizreni. Siç thotë edhe albanologu i njohur Rober Elies. Dhe jo vetëm Elies, por edhe shumë të tjerë. Që Pjetër Bogdani ishte lindur në vitin 1625 në fshatin Gur të Hasit. Pjetër Bogdani i cili njihet si gurëthemel i gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe hero i

kohës në të cilën jetoj. Në Republikën e Shqipërisë u jetësua figura e tij në pullën postare dhe në monedhën njëmijë lekëshe. Në Republikën e Maqedonisë po ashtu u lartësua figura e tij me ngritjen e pllakës përkujtimore në qytetin e Shkupit. Ndërsa në vendlindjen e tij ne, asgjë s'kemi bërë për të.

**Simir Krasniqi:** Është nder dhe krenari për qytetin historik të Prizrenit që të ketë jo bustin po monumentin e Skënderbeut. Sot Skënderbeu lobon në metropolet botërore për Kosovën dhe shqiptarët. Në qytetin historik të shqiptarëve Prizrenin, ndoshta më tepër se të tjerët do të kemi nevojë të promovojmë vlerat tona kombëtare më të mira që i kemi. Pak historik për Gjergj Kastriot Skënderbeun. Hero kombëtar i popullit shqiptar, burrshtetas, komandant legjendar dhe strateg ushtarak në luftë kundër pushtuesit. Princi i famshëm nga fisi i kastriotëve. Për të organizuar dhe forcuar mbrojtjen më 02 mars 1444 u mbledh Kuvendi i Lezhës. Por u themelua besëlidhja e sundimtarëve shqiptar. Skënderbeu u zgjodh kryetar i Lidhjes dhe komandant i sajë i përgjithshëm. Lidhja e Lezhës pati rëndësi të madhe, pasi që për herë të parë u arritë një bashkim politik i të gjithë sundimtarëve feudal dhe u krijua arka dhe ushtria e përbashkët shqiptare. Nënë udhëheqjen e Skënderbeut populli shqiptar për 25 rresht u bëri ballë ekspeditave dhe rrethime të egra të ushtrive. Skënderbeu pra vdiq më 17 janar të vitit 1468. Dhe në katedralen e Lezhës sot Muzeu i Gjergj Kastriotit Skënderbeu, kjo figurë historike ka vend të rëndësishëm në librat e historisë shqiptare dhe botërore, por edhe në art, në letërsi, artet vizuale, muzikë, kinematografi e të tjera. Sot Skënderbeu lobon në këto metropole botërore. Monumenti i Skënderbeut në Tiranë 11 metra i gjatë, monumenti i Skënderbeut në Krujë, monumenti i Skënderbeut në Prishtinë, shtatorja në Dibër, busti i Gjergj Kastriotit në qytetin e Tuzit, Preshevës, Burrelit, monumenti i Skënderbeut në Shkup, busti Skënderbeut në Kukës, monumenti në sheshin albania të Romës, monumenti në Bruksel Belgjikë, përmendorja në Miçigan të SHBA-ve, busti në qytetin Thermo Ankona, busti në San Kosmo albaneze, bustet e heroit tanë kombëtar ndodhën edhe në Vjen, në Budapest, Zvicër, në Detroit e të tjera. Grupi parlamentar i PDK-së e mbështesim, por jo si bust por si monument. Sikurse në Tiranë, Prishtinë, Shkup dhe disa metropole tjera botërore.

**Alush Shala:** Propozimi im për ngritjen e shtatores të komandantit legjendar Adem Jasharit, nuk është vetëm dëshirë por është edhe e domosdoshme. Të gjithë e dimë se ky legjendar, është unikat nga të gjithë komandantet e të gjitha kohërave, jo vetëm në Kosovë, por në Ballkan, edhe në Evropë. Së paku deri më tani nuk kam dëgjuar se një komandant të tillë ta ketë pas rajoni. Komandanti jonë legjendarë Adem Jashari, ai sakrifikoi edhe familjen, pra 22 anëtarë të familjes së ngushtë, me vëllezër, babë dhe nënë. Po edhe të lagjes së vetë plus 37 që i bije me qenë 59 persona, i vogël e i madh, luftuan deri në flijim. Unë mendoj që të ata 59 vetë që ranë aty dhe sakrifikuan,

meritojnë një lapidarë, por tani ne duke e ngritur përmendoren e komandantit, jo vetëm që e nderojmë komandantin dhe ata që ranë me komandantin. Por këtu nderohet Ushtria Çlirimtare e Kosovës, nderohen të gjithë dëshmorët, dhe pse jo nderohet edhe Prizreni dhe ky Kuvend. Prandaj ju lutëm dhe ju ftoj të gjithë kolegët dhe të gjitha subjektet politike të votojnë unanimit. Kurse kryetari Haskuka i kërkoj që qysh nesër ta angazhoj drejtorin e Administratës të komunës që të përgatis dhe të krijoj një komision, që të merret me këtë vepër madhështore. Gjithsesi në këtë komision duhet të jenë edhe nga shoqatat të dala nga lufta e UÇK-së. Kjo shtatore duhet të jetë në formatin e shtatores që është në Skenderaj. Dhe mendimi imë është që të jetë i njëjti skulptor. Por kjo le të mbetet në dorën e komisionit i cili do ta zgjedh kryetari apo Kuvendi komunal. Kjo ishte arsyeja për shtatoren e komandantit legjendar Adem Jashari.

**Haziz Hodaj:** Unë i përgëzoj nismëtarët për një iniciativë të tillë. Por sigurisht që ka procedura për ta iniciua, tash është Drejtoria e Administratës, apo Drejtoria e Urbanizmit. Dhe në momentin që vjen në Kuvend, nuk e di që ndonjë grup parlamentar do ta kundërshtoj. Po ti maltretojmë tash anëtarët e Kuvendit për histori, për figurat eblematike të kombit dhe të mbajmë fjalime, singerisht nuk po e shoh të arsyeshme. Kështu që bllanko e keni votën e LDK-së, në momentin që vinë procedurat e rregullta për ta implementua. Sigurisht që kemi me pas probleme, sepse i kemi sheshet e zëna. Ne, në të kaluarën e kemi pas bërë një propozim shumë konkret për ti grumbullua të gjitha këto figura dhe për krijuar një kompleks në qytetin e Prizrenit ashtu siç e meriton. Mirëpo nuk ka shkua, nuk ka ndodh. Përndryshe duhet të hulumtohen vendet edhe procedurat. Votën tonë e keni.

### **Cenet Sajhadi: 01.44.44**

**Ilir Baldedaj:** Unë flas në emër të grupit parlamentar të AAK-së, ne e mbështesim këtë iniciativë. Dhe kurdo që të vije në rend të ditës ne do ta votojmë. Pa dashtë me hy në historiat. Besoj që kanë fol ata më shumë se sa na që mund të flasim këtu.

**Karanfil Haxhillari (LVV):** Po më vjen mirë që më në fund në qeverisjen e VV-së po diskutohet për ngritjen e busteve apo monumenteve të figurave më të larta kombëtare. Edhe si grup parlamentar i LVV-je, e mbështesim dhe ju ftojmë të gjithë kuvendarëve që ta mbështesim këtë iniciativë. Edhe ekzekutivin që të filloj me procedurat për ngritjen e këtyre monumenteve.

**Memnuna Ajdini:** Tko e koalicioni Vakrat pozdravlja ovu ideju. I svakako da epodržati ovaj predlog.



**Lirije Bytyqi (Nisma Socialdemokrate):** Pasi që ishte iniciativa e partisë Nisma Socialdemokrate, për bustin e Skënderbeut. Unë e propozova në KPF, më vjen mirë që u miratua ky propozim. Dua të them se ne si Nisma Socialdemokrate, duke e ditur se viti 2018, nga Qeveria e Kosovës dhe nga Republika e Shqipërisë është shpallur si vit i Skënderbeut. Në shumë qytete të Kosovës, në Evropë dhe Amerikë, ku jetojnë shumica e shqiptarëve janë vu buste të Skënderbeut. Prizreni si qytet historik dhe kryeqytet i Shqiptarisë e meriton me pas bustin e Skënderbeut. Prandaj, propozoj që busti të vendosët, kemi dy lokacione, ose te Ura e Arastës, ose tek hyrja e farkëtareve përballë Urës së Gurit.

**Kryesuesi:** Më sa e pash është vullnet i të gjithëve. Dhe mendoj që Kuvendi duhet të merr Vendim, për ndërtimin e këtyre busteve. Tash është e qartë kjo, se kjo ka implikime financiare. Le të ia lëmë këtë ekzekutivit. Pra përmes këtij vendimi, ne obligojmë kryetarin e komunës dhe drejtorinë përkatëse, që në një kohë sa më të arsyeshme sa më të shpejt ti gjej lokacionet e përshtatshme. Ti themelohet këto komisione të cilët merren me këtë punë. Dhe brenda një periudhe sa më të arsyeshme ta ekzekutoj ose implementoj vendimin e Kuvendit. Dhe më qenë se po flasim tash për shtatoren e Adem Jasharit dhe bustin e Skënderbeut, siç u tha këtu edhe nga parafolësit, dy figura më të larta kombëtare të shqiptarëve. Mendoj që duhet të përfshihet edhe një nen në kuadër të këtij vendimi, nëse pajtohen edhe anëtarët e Kuvendit që pas ndërtimit të shtatores së Adem Jasharit dhe Gjergj Kastriot Skënderbeut përfundon kjo saga e ndërtimit të shtatorëve që nga paslufta në Prizren. Mendoj që këtë gjë duhet ta kemi parasysh ne si Kuvend. Përndryshe shumë, këto shtatore sigurisht që e meriton që ka sakrifikua. Por pas ndërtimit të shtatores së Adem Jasharit. Nuk e di sa mundemi me ndërtua tjetër, kush mundet pas tij me ardhur. Edhe pse kjo çështje është diskutuar në mandatin e kaluar. Dhe me njohuritë e mija që kam, çështja e ndërtimit të shtatorëve ka përfundua me ndërtimin e monumentit të lirisë Remzi Ademaj që ndodhët pran postës. Por kërkesat nuk kanë pushua. Dhe mendoj që si Kuvend do ta merrnim vendimin e drejtë në qoftë në kuadër të këtij vendimi për ndërtimin e shtatores Adem Jashari dhe Gjergj Kastriot Skënderbeut, ta parashohim edhe një kufizim të tillë.

**Alush Shala:** I nderuar kryesues, unë nuk i prita këto fjalë nga ju. Sepse ju po doni më thënë diçka që, dhe po kërkon diçka të pazbatueshme. E aq më shumë po e kërkon edhe miratimin e kuvendarëve. Tu kisha lut shumë që ju vetëm ta bëni punën e juaj, ta udhëhiqni asamblenë. Dhe mendimet dhe sugjerimet tona ti dëgjoni deri në fund. Kësaj radhe ishin këto dy propozime. Dhe për këto dy propozime, kisha kërkuar mendimin e drejtorit të Administratës i cili besoj që është në kompetencën e tij për mundësinë e sigurimit dhe ndarjen e buxhetit. Sepse ju e dini mirë që ne sot do ta votojmë ndoshta apo s' do ta votojmë edhe buxhetin. Edhe ne duhet t'ia japim këtë

hapësirë drejtorit. Dhe kërkojmë nga drejtori që këto dy projekte të futën qysh sot. Se edhe zonja Sherife Balaj pat një propozim. Unë po ju njoftoj juve z. Kryesues, që në shoqatën e veteranëve të luftës, kemi shumë kërkesa, jo një po shumë. Prandaj nëse ne sot me vendim ia ndalojmë të drejtën e kërkesës. Më duket se është më shumë se diktator. Po e bëjmë këtë sot, për të tjerat shohim.

**Kryesuesi:** Ky ishte vetëm një propozim i imi. Po besoj që këtu ka anëtarë të Kuvendit të cilët janë veteran dhe e dinë që kjo temë është diskutua shumë e shumë. E dini shumë mirë edhe problematikën. Unë nuk e vendosi këtë në kokë temën. Ne e nisëm një procedurë, jemi duke e marrë një vendim. Tash po diskutojmë rreth hartimit të tekstit, kështu po e marrë unë. Megjithatë nëse kuvendi nuk përfshinë si ndalesë. Se në fund të fundit ne s'mund të ndalojmë. Por me pas parasysh pak këtë gjë, përndryshe në secilën rrugë duhet me qitë. Edhe unë mendoj që duhet të ketë fund kjo gjë. Sido që të jetë, është një temë, pas Adem Jasharit, edhe njëherë po them se çka mundemi me ndërtua tjetër. Por sido që të jetë, kjo nëse nuk ka unitet ne nuk e përfshimë. Por ky ishte një propozim i imi.

**Osman Hajdari:** Kjo çështja e busteve dhe shtatorëve natyrisht është çështje e ndjeshme. Jemi duke fol për dy iniciativa, për heronj kombëtar. Tash unë po ju tregoj procedura edhe të planifikimit buxhetor. Natyrisht që ka procedura për këto. Po ju tregoj që është edhe një memorial që është në planifikim buxhetor i këtij viti, është i planifikuar në vitin e ardhshëm. Është memorial i komandant Drinit, i cili është në fazën gati që tre muaj ditë negociohet çështja e lokacionit, çështja e bazës ligjore për me i ndjek procedurat tenderuese, lidhur me realizimin e projektit. Do më thënë duhet me pas konkurs ndërkombëtar. Unë edhe në emër edhe të kryetarit të komunës edhe në emër të ekzekutivit. Nuk besoj që ka këtu as anëtar të Kuvendit, as të partive politike që munden me kundërshtua në lidhje me ngritjet e shtatorëve të Skënderbeut apo të Adem Jasharit apo të komandant Drinit. Janë krejt figura të respektuara. Po folmi për plane konkrete, në kuadër të Drejtorisë së Administratës është memoriali i komandant Drinit i cili pritet mu realizua vitin e ardhshëm. Jemi duke bërë përgatitje të jashtëzakonshme që para përvjetorit të tij vitin e ardhshëm që e ka me u realizua memoriali. Në konsultim me familjen me mekanizmat që janë për trashëgimi kulturore, e të gjitha. Pra gati çdo javë ka takime për këtë çështje. Edhe për këto nuk jemi të interesuar thjesht me vendos pa ju nënshtrua një konkursi real të projektimit. Ka pas vitet e kaluar lapidare thuaja në gjitha drejtoritë, një lapidar aty, një shtatore. Edhe në formulim, tash nëse e marrim te Adem Jashari, shtatorja nënkupton bajagi kosto buxhetore. Do më thënë është krejt projekt tjetër. Te busti i Skënderbeut është një kosto tjetër buxhetore. Tash nëse vendoset, natyrisht ekzekutivi vendos mbi bazën e vendimeve të asamblesë. Na jemi për me implementua. Natyrisht e jona është për me këqyrë bazën ligjore. Ne, në kuadër të projektbuxhetit e kemi një buxhet,

e kemi kodifikua. Bile kur të diskutohet për buxhetin e shihni. Merret me hartimin e projekteve dhe të çështjeve tjera konkurse ndërkombëtare të ndryshme. Do më thënë e kemi lënë një kod të përgjithshëm, ku edhe këtu mundën mu fut këto. I jetë prapë asamblesë me vendos. Të dyja, nëse është viti i Skënderbeut viti 2018 dhe nëse Kuvendi i komunës, na, ju vendosim që brenda këtij viti me ekzekutua. Atëherë duhet me këqyrë format ligjore edhe financiare në çfarë procedure. Një konsultë që e kam pas me disa që merren këto buste. Ne e kemi këtu edhe shefin e grupit parlamentar të Nismës që është një skulptor. Përafërsisht vlera e këtij busti është diku vlera 10.000 € Që mundemi me ndjek një procedurë krejt tjetër. Në momentin që hymë të shtatorja, ngritja e lapidarit ka kosto tjera buxhetore. Që duhet me shkua procedura 45 ditë. Që në këtë vit hiq nuk mundet me u bo. Mundemi me bo vitin e ardhshëm. Unë po ja ngriti edhe një çështje tjetër, tash që jemi në negociata, bashkë me kryetarin e komunës. Kanë nisë procedurën e ngritjes së memorialit në Krushën e Vogël. Sivjet do të bëhet shpronësimi, dje kemi bërë një marrëveshje. Edhe atje është një masakër e bërë. Sivjet do të bëhet shpronësimi, sivjet do të bëhet procedura e konkursit ndërkombëtar edhe pse në buxhet nuk e kemi planifikua, për shkak se nuk e dimë sa zgjatë konkursi. Mirëpo do të bëhet. Me një farë forme jem një ihtar, nëse vendosim me bo, le të bëhet mirë, pavarësisht kostos financiare. Do më thënë te këto figurat kombëtare nuk këqyrët kostoja financiare. Implikojmë tash ne si Kuvend edhe si Qeveri komunale, edhe fonde edhe donacione nga Qeveria e Kosovës. Ta zëmë te memoriali i Krushës, është i gatshëm KFOR-i. Është memoriali në Korishë i papërfunduar, të cilin edhe aty është i gatshëm KFOR-i me ndihmua me participim. Dhe janë disa tema edhe të ndjeshme edhe kombëtare, po edhe duhet mi bo mirë. Do më thënë thjesht shkel e shko nuk mundemi me bo. Unë mendoj, nëse vendos prapë Kuvendi. Për të dyja duhet me pas një konkurs ndërkombëtar. Nëse vendoset, duhet ti dallojmë, busti është tjetër muhabet, shtatorja është muhabet tjetër, memoriali është muhabet tjetër. Memoriali i komandant Drinit është duke u diskutua me pesë, gjashtë ide. Varësisht konkursi ndërkombëtar çka na jep. E kemi edhe përkrahjen e familjes dhe krejt mekanizmat që janë në atë komision, jemi duke negociua. Natyrisht do të jetë edhe në asamble, në momentin kur e kemi një projekt në dorë. Do më thënë janë disa ide. Vepra arti, skulpturë, shtatore, park etj. Tash këtu duhet me pas shumë më rëndësi definimet qysh i bëjmë. Se tash merren vendim kryesues, edhe anëtarë të asamblesë, nëse vendoset me vendim shtatore, do të jetë brenda shtatores. Do më thënë në konkurs të projektimit shtatore duhet me bo. E kemi shumë problem me vendet lokacionet. Jashtëzakonisht është problematike. Zona historike është jashtëzakonisht e ngarkuar. Janë shumë implikime ligjore. Nëse bustin e Skënderbeut nëse dojmë këtë vit me bo. Atëherë përqendrohemi te ky bust edhe shohim procedurat ligjore qysh mundemi me bo. Për shtatore mundemi me diskutua vitin e ardhshëm mu planifikua. Kështu që natyrisht përkrahjen e qeverisë e ka.

**Alush Shala:** I nderuar drejtor i Administratës, plotësisht e përkrahi bustin e Skënderbeut të bëhet në 2018, pasi është shpall edhe viti i Skënderbeut. Do më thënë nuk kemi asnjë pikë as presje me shtua. Te kjo është shumë e lehtë, sepse edhe ju vetë e thatë që nuk është një kosto shumë e madhe. Ndërsa për shtatoren e Adem Jasharit, ne e kemi një kopje që është në Skenderaj, se ashtu duhet të jetë. Sepse edhe vetë sheshi i Adem Jasharit meriton një të tillë. Ne e kemi pas, unë personalisht e kam pas një shtatore të Adem Jasharit e kam qua në Dragash. Të cilën kem mund me vu edhe këtu. Po karshi sheshit, ajo ka qenë shumë e vogël, e cila humbte. Prandaj kisha kërkuar nga ju, që ju të merrni me këtë procedurë dhe të pyetni. Sepse është gjallë ai njeri që e ka ndërtua. Sa ka kushtua dhe pastaj nuk kemi këtu çka kush e bënë më të bukur më të mirë. Me çmim mund të lëvizni, problemi i juaj është. Ndërsa figura duhet të jetë e njëjta me atë të Skenderajt nëse doni vërtetë me bo një vepër ashtu siç i ka hije. Po kjo duhet me hy në vijën buxhetore në vitin 2019. Nuk po kërkoj për Adem Jasharin sivjet, se është e pamundur.

**Osman Hajdari:** Konkurs duhet me pas patjetër, pavarësisht ku është ndërtua, se ajo i bije si në aspekt privat. Ne po folëm në aspekt të institucionit. Institucioni duhet me pas procedurë, duhet me pas terma të referencës, duhet me pas lokacion të saktë, për me qua me një procedurë. Hapi i parë është lokacioni. Nëse se kemi lokacionin nuk mundemi me zhvillua asnjë procedurë. Unë po mendoj që na merr shumë kohë. Na e kemi tash një pozicion buxhetor, ku kemi hartimin e konkurseve të ndryshme, projekteve të ndryshme. Sivjet çdo investim, që ka mu në vitin 2019, është paraparë me pas projekt konkret. Edhe për çështjen e lapidarëve edhe të butëve ka me pas konkurs të caktuar, ndërkombëtarë, çfarë do që të jetë. Mendoj që nuk bënë mu ngut. Gjithqysh e realizojmë, po mirë. Edhe në kuadër të aspektit ligjor edhe të procedurave të prokurimit, që deshe s’deshe na jemi të detyruar me ju nënshtrua. Kjo është e tëra. Nëse vendosët kryesues edhe anëtarë të asamblesë, për çështjen e Skënderbeut. Atëherë ne mundemi me organizua një komision të veçantë edhe prej asamblesë. Me zyrtarët e Drejtorisë të Administratës, të prokurimit. Mi bo format e realizimit çka mundemi me mbërrë brenda këtij viti. Edhe pse mundësitë janë bajagi të vështira se jemi në shtator, do më thënë në fillim tetor. Zotimi i mjeteve është deri në fund të tetorit. Do më thënë janë disa procedura administrative që neve si qeverisje procedurat administrative na qesin para një akti kogja të vështirë. Po do të bëjmë përpjekje.

**Haziz Hodaj:** Qeveria e Kosovës ka shpall këtë vitin e Skënderbeut. Ka paraparë që gjashtë monumente të ngrihen në qendrat kryesore. Nuk e di tash. Ju duhet të jeni në korrespondencë në lidhje me Qeverinë e Kosovës dhe duhet me e shfrytëzua këtë donacion që është ndarë nga Qeveria e Kosovës. Përndryshe këto fjalë që jemi duke i bërë ne tash. Po shyqyr që nuk mundën me u qua ata se na kishin rreh shuplaka të dy edhe Skënderbeu edhe Adem Jashari

neve. Unë ju thash shikoni procedurat. Bina neve konkrete edhe për vendet edhe për përmasat e monumenteve. Edhe ne e votojmë. Unë nuk e di çka kemi me bo muhabete të atilla.

**Pranverim Berisha (Nisma Socialdemokrate):** Ne kur e kemi pas bo propozimin në KPF, si Nisma kemi caktua edhe lokacione, se ku mund të vendoset busti i Gjergj Kastriotit. Dhe meqë që është viti 2018, viti i Gjergj Kastriotit dhe pesëqindpesëdhjetë vjetori i vdekjes së tij. Është një procedurë që e përmendi edhe drejtori i Administratës. Për bust ndiqet një procedurë krejt tjetër, ndërsa për shtatore, edhe pse jemi pro natyrisht për mu ngritë një shtatore. Natyrisht që është procedurë krejt tjetër. Prandaj ta kemi parasysh që viti 2018 si viti i Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Të mund pse jo edhe me 28 nëntor të jetë i gatshëm për mu vendos.

**Sinan Alijaj (Nisma Socialdemokrate):** Unë desha vetëm pak sa i përket anës profesionale të ju sugjeroj edhe këshilloj. Nuk është mirë mu ngut nëse nuk jeni ekspert të lëmisë sa u përket këtyre gjërave të rrafshit kombëtar e historik e të vlerave. Është mirë me qenë njerëz profesionist që dinë çka donë prej kësaj pune. Nuk është kjo fontanë dëshirash, jo këtu, jo këtu, jo këtu. A i pëlqen a si pëlqej dikujt, këto janë gjëra që duhet me vendim edhe duhet me vendos. Pavarësisht prej vullnetit tim, ose dëshirës time se ku po dua ose çka po dua. Ose dikush është kundër apo është pro. Kjo janë gjëra jashtëzakonisht serioze, prandaj nuk duhet me luajt me këto. Nuk duhet absolutisht me i dhënë hapësirë askujt me qit në debat. Jo po më pëlqen, jo për karakter e këtë arsye. Këto janë gjëra që kanë të bëjnë me kombin tonë, identitetin tonë, karakterin tonë dhe formimin tonë si popullatë. Desha edhe dy tri gjëra. Sa i përket pjesë së monumentit të Lidhjes së Prizrenit, Ymer Prizreni, Abdyl Frashri edhe Sylejman Vokshi. Mënyra e realizimit, po flas prej rrafshit tim profesional. Unë kisha pas mendua, nëse nuk është bo për ata njerëz të mëdhenj të kombit tonë dhe të historisë tonë. Atëherë për Adem Jasharin duhet me qenë pak më të kujdesshëm. Ademi nuk vendoset çdo kund. Nuk bënë Ademin me qua neve qysh po na merr mendja, apo ta gjuajmë me një skutë ose po e qesim gjysmë në rrugë në asfalt. Ne duhet me qenë tepër të rezervuar që mu kujdese për mundin, për sakrificën e tij. Dhe krejt ajo çka na pason në kohën që po jetojmë ne këtu. Kemi Kalanë naltë, kemi nenkalanë, kemi edhe këtë pjesën e shkëmbit të kalas. Ademi Meriton aty me qenë përball Lidhjes së Prizrenit. Nëse Lidhja e Prizrenit qëndron si objekt kënde, Ademi mundet me qenë në pjesën e shkëmbit. Kushdo le ta bënë, nuk jam ai person që kam me pas dëshirë me bo, dëshira ime është për me realizua. Ai njeri i madh, më bënë të madh edhe mua. Mirëpo një diçka dua me thënë. Ai meriton vend denjësisht për mu prezantua. Nuk kemi nevojë për me gjet kënde, njëjtë edhe për Skënderbeun vlen. Para se me bo, kushdo që e bënë atë vepër, duhet me qenë të kujdesshëm. Këto janë dy figura emblematike që kombin edhe neve na identifikon me atë. Nëse merremi ne sot

me atë çka dojmë me bo, jo me rrugë, jo me kanalizim, jo me wc. Mua më duket krejt qesharake. Jemi njëzetë vjet pas luftës. Ende flasim ne jo heqi njëshat jo heqi dyshat. Intervenimet e prindërve, mësuesit nuk e dinë kush është nënë, e kush është profesor, e kush është doktor. Këto janë krejt anomali, do më thënë të kalojmë gjërat pragmatike racionale të jetës që ne duhet me bo për të ardhmen e vendit tonë. Do më thënë kjo është ajo që po sugjeroj kuvendarëve këtu, që me mund edhe juve të ju letoj punën e juaj, mos të ju përzihemi në ato pjesë të menaxhimit të juaj, të jeni sa më lirë. Mirëpo realisht edhe të na dëgjoni për me mund gjërat me shkua në vend të vetin aty ku duhet. Të mësohemi vëlla si perëndimi. Nuk kemi inati me askënd, edhe s' duhet me pas inati. Unë ato vota që i kam marrë prej popullatës, nuk kam ardhur me shitë vetveten. Nuk kam ardhur as emrin me tregua, as vetveten, as fytyrën time, as kravatën time. Po edhe thjesht me ardhur këtu nuk është interesant. Do kur të flasim me ide edhe mendësi. Kush ka mendësi le të jep, drejtorët te kryetari, drejtorët kompetent, edhe në rregull jemi.

**Kryesuesi:** Unë po pajtohem me parafolësit. Ne si Kuvend jemi organ politik. Jo të gjithë jemi ekspert të kësaj lëmie. Sigurisht që kemi propozimet tona që mendojmë se janë më të mirat. Po të ia lëmë do njerëzve që merren me këtë punë. Ajo çka na takon neve është me marrë vendim, le të bëhen këto. Pra t'ia nisim procedurën. Tash po hymë ne në idenë e lokacionit prej tash. Po hymë ne në formën se si ka mu dok. Ose po hymë ne në çështjet e buxhetit, a duhet të përcaktohet ajo. Vetëm çka jemi duke e rënduar këtë temë hala pa ja nisë. Kuvendi të merr vendim mu bo, kjo është puna e jonë. Le atë punë të drejtorit, leja drejtorit, mos ti marrim na përsipër. Nuk pse po brengosemi shumë se si do të realizohet kjo nga kryetari i komunës, apo drejtoria. Ata janë për këtë punë. Ne jemi për të diskutua me debatua edhe në fund me marrë vendim. Unë kisha thënë kështu. Mos ta komplikojmë, mos ta rëndojmë muhabetin hala pa ja nis. Edhe po kalojmë në procedurë të votimit në qoftë se pajtoheni të gjithë. Edhe në fund kur të vije puna të financimi që u tha. Z. Hodaj, Qeveria gjithmonë është e gatshme, ose Kuvendi me vijat buxhetore me participua. Do më thënë edhe këtu nëse s'ka mjete, gjithmonë mundet me shkua në formën e bashkëfinancimit. Është edhe memoriali në Gorozhup që po bëhet, është rezultati i mjeteve që vinë nga niveli qendror. Pra gjithmonë ka forma të tilla. Prandaj unë po them mos ta ngarkojmë ne këtu muhabetin se këto mund të zgjidhen gjatë rrugës. Ajo çka na takon neve është me marrë vendim. Pastaj formohen komisionet, mblodhën ekspertet, bëhen diskutimet publike, me banorët. Shikohet a është brenda zonës historike. A ka mundësi, a s'ka mundësi. Gjëra të tilla të cilat ua lëmë të tjerëve. Ne po shkojmë me vendim në qoftë se jeni të pajtimit.

**Illir Baldedaj:** Çështjen që e potencoj Hazizi, desha me participu që qeveria nuk ka të paraparë ndërtimin e busteve as të Skënderbeut. Janë të parapara ato tri të Lidhjes së Prizrenit, në kuadër të vitit jubilar të Skënderbeut

që e kanë shpallë. Nuk është e paraparë, që tash u konsultova me Jahën që është përgjegjës për këtë çështje, tha nuk ka. Po nëse ka ndonjë kërkesë drejtori i administratës dhe kryetari i komunës, ne duhet të bashkëpunojmë dhe nëse s'ka mjete komuna për këtë vit që u tha për çështjen e Skënderbeut. Ne jemi dakord me vazhdua me Jahja Llukën me mbajte një takim.

**Osman Hajdari:** Edhe unë pajtohem me shumicën e parafolësve. Nuk është mirë mu ngut. E para ne e kemi vitin e ardhshëm edhe një rishikim. Edhe nëse s'parashihet në këtë projektbuxhet, çështja e shtatores të Adem Jasharit, apo një shtatore tjetër. Ka rishikim të buxhetit, ka procedura tjera, do që mundemi me i nxjerr. Mirë tha kryesuesi, le të jetë një vendim i përgjithshëm. Se në më së shumti kemi pas telashe rreth lejeve. Ta zëmë nëse vendoset në Zonën Historike, janë disa mekanizma që duhet me kërkua leje. Që ndoshta mundet me zgjatë një vit çështje e lejes për me lejua këtë procedurë. Këtë çështje administrative të procedurave na lini neve. Ju si Kuvend vendosni, ose merrni vendim për mi ngrit. Pa specifikua shumë lokacione, pa specifikua vite. Në momentin që merret vendim ne formojmë komisione edhe shohim tani përmes komisione me qenë tërë kohën të informuar. Mendoj që komisionet duhet me qenë gjithë partiake, krejt anëtarët e partive dhe vendosim krejt bashkërisht qysh bashkëpunua.

**Simir Krasniqi:** Unë plotësisht pajtohem edhe me Sinanin. Unë e dhashë një propozim, është nder dhe krenari që qyteti historik i Prizrenit ti ketë dy figura kombëtarë. Siç është Adem Jashari dhe heroi kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Edhe pse mos të jetë në qytetin historik monumenti i Skënderbeut, por jo busti. Nuk është e thënë që të kryhet këtë viti, edhe vitin e ardhshëm. Në qoftë se ne marrim vendim. Marrim vendim për monumentin historik të Skënderbeut. Është krenari e qytetit historik të Prizrenit që ti ketë dy emblema dy heronjtë kombëtar në Prizren. Ne e mbështesim thash. Edhe njëherë po e them, nuk do të ishte mirë që të ngutemi për bustin e Skënderbeut. Ne të marrim vendim për monumentin e Skënderbeut pra. Se është nderë për qytetin historik të Prizrenit ti ketë dy emblema, dy heronjtë kombëtar pra siç është Adem Jashari dhe Gjergj Kastrioti Skënderbeu. E mbështesim plotësisht.

**Adem Shabanaj (LVV):** Edhe grupi i LVV-së e mbështet.

**Xhavit Ukaj:** Edhe LDK e mbështet.

**Ilir Baldedaj:** Po edhe AAK e mbështet.

**Sinan Alijaj:** Po, edhe Nisma e mbështet.

**Sencar Karamuço:** Ne si parti, Haziz Hodaj e ka dhënë një propozim. Ne duhet me ditë çka kemi me ndërtua edhe ku kemi me ndërtua. Mirë është me ditë njëherë formën qysh ka me qenë. Edhe kolegja Cenet tha ne s'jemi kundër Adem Jasharit. Do të thotë ne mendojmë le të bëhen njëherë propozimet edhe le të vjen në Kuvend le të votohet.

**Azem Durmişi:** I stranka NDS je da se precizira, preciznije da se ide. Pa tek onda da damo svoje mišljenje.

**Memnuna Ajdini:** Koalicija Vakrat podržava ovaj projekat.

**Kryesuesi:** Atëherë 34 anëtar jemi në sallë, dhe këtë propozim, këtë kërkesë për ndërtimin e këtyre shtatorëve dhe busteve e hedhim në votim, kush është për?

Për? – 30.

Kundër? – S'ka.

Abstenim? – 4.

Atëherë me 30 vota për, asnjë kundër dhe 4 abstenim, miratohet propozimi për ndërtimin e bustit të Skënderbeut dhe shtatores së Adem Jasharit.

**Pika e pestë:**

**Diskutim, rreth logos së Komunës së Prizrenit dhe mundësia e rikthimit të vitit 1878.**

**Kryesuesi:** Ky propozim të nderuar anëtarë të Kuvendit ka ardhur në mënyrë të ligjshme sipas procedurave në KPF. Është kërkuar dhe është mbështet pothuaj se nga pjesa më e madhe e KPF-së dhe i është rekomandua Kuvendit për diskutim. Ka qenë kërkesë e kamotshme e anëtarëve të Kuvendit. Dhe rrjedhimisht tash po e hap diskutimin.

**Ilir Baldedaj:** Unë kisha kërkuar gjatë këtij debati të nxirret edhe një komision për ndryshime statutare të Statutit të Komunës. Sepse pikërisht logoja ka të bëjë me ndryshimet statutare, për të cilin duhet të jetë një komision. Sepse cilin do variant që ne e qojmë aktuale që e kemi, ajo është në kundërshtim e vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Dhe natyrisht që pastaj përmes komisionit bashkëpunojmë edhe me komunitetet të cilët e respektojnë me të gjitha format e mundshme. Dhe besoj që edhe këta nuk do të jenë kundër vitit 1878, sepse ne po ua mbështesim edhe ditën e boshnjakëve, edhe ditën e komunitetit turk po ia festojmë. Dhe besoj që nuk bie ndesh me interesat e asnjërit komunitet viti 1878. Sepse ai është vit i cili i përmbledh rrethanat politike të Lidhjes Shqiptare të



Prizrenit. Dhe nuk ka të bëjë me ndjenjat e juaj që ua lëndon ndjenjat. Po ai vit nëse dikujt ia ka lëndua ndjenjat, ja ka lëndua komunitetit shumicë, e që është komuniteti shqiptar. Andaj ju kisha lut si kolegë edhe Sencar edhe Memnuna të cilët po shihet që e kanë lëshua sallën. Po mos luani me ndjenjat tona, sepse nuk ndihemi mirë ne, nëse ju në ditën e boshnjakëve dhe në ditën e torqeve nuk ju vijnë në festë. Besoj që nuk do të kishte kuptim festa e juaj pa ne, që nuk do të kishte as e jona pa ju. Andaj kryesues gjatë këtij debati dhe gjithë kësaj zhurme të krijuar që një kohë të gjatë. Që unë e di ka qenë atëherë një nënkryetar për komunitete, që e ka iniciua atë ankesë. Dhe po nëse bëhet një komision për ndryshim statutar. Kjo mund të jetë e mundshme të rikthehet. Por natyrisht që janë ekspert të cilët e kanë mendua formën. Sepse me të njëjtën formë ne mund të debatojmë tërë ditën, të marrim vendime të kota, por ajo nuk do të rikthehet.

**Sinan Alijaj:** Sa i përket logos desha ti bëjë edhe disa shpjegime më detale. Nëse kjo logo këtu që është, unë them mos me prek atë. Nëse po doni ju me respektua pjesën e Kushtetutës të Republikës të Kosovës edhe karakterit kushtetues të shtetit tonë, atëherë mos e prekni këtë, veç shkruani 1878. Nëse nuk na e mban për me prezantua vetveten, atëherë respektoni minoritetet që po qesin shumë përralla këtu. Na pëlqen e s'na pëlqen, po ai s'do me ndej po punë e madhe. Po aq më mirë që s'rrinë. Se as sytë s'ia shoh, as më zmadhon, as nuk më zvogëlon. Përkundrazi, aty ku i duket më mirë, ku e sheh vetën jo të diskriminuar atje le të shkon le të jeton. Ne duhet mu mësua, nuk ka shtete në botë shtetet më të zhvilluara demokratike, po nuk e respektove rendin e shumicës. Duke u nisur prej gjuhës më së pari. Sot fëmijët tanë e krejt qytetarët po dua më thënë, për me shkua në Gjermani po duhet me mësua tre muaj kurs për me mësua gjuhen gjermane, për me u integrua në shtetin gjerman, në Zvicër apo në Francë apo kudo që shkon. Këtu jeton me fëmijë me grua, me babë e babagjysh dhe preton me thënë një faleminderit apo ditën e mirë për me mësua atë gjuhë. Nuk e di ku është kjo injorancë e tyre, a e kanë prej vogëlsisë, prej frikës. Ne si shumicë, edhe si popull si etni që kemi qenë, kurrë askujt si kemi bërë dëme, as kurrë kujt dhunë si kemi bërë. Kemi bo për interesat tona, kemi mbrojt vendin tonë. Kemi krijuar shtet të ri, në emër të vlerave shoqërore edhe civilizuese si i takon një populli në këtë shekull. Për atë po them unë e di kur është bo kjo logo. PDK-ja ka qenë atëherë. E di që është diskutua edhe në Parlamentin e Kosovës. Po nuk e se sa kanë mund me qenë aq injorant të asaj kohe po flas. Nuk e di për çfarë interesa të drejt kanë qenë në atë kohë. Edhe atëherë janë kon kundër edhe kam punua në komisione të caktuara në rrafshin profesional po them. Mirëpo për interesa të caktuara politike e kanë atë, edhe e kanë bo këtë shëmti që e kanë sot. Që sot është problem me ndreq. Disa vendime kur ti marrin ata njerëz që donë me drejtua vendin, ata duhet me i

marrë ato për mos mu heq. Ato nuk hiqen më në histori. Ky shtet u krijua në vitin 1999 dhe ky shtet nuk zhbëhet sa të ka gjak shqiptari edhe sa të merr frymë shqiptarisht dikush. Le ta harroj atë. Sado i vogël që është ky vend. Për dikë ndoshta duke i madh edhe frikohen prej kësaj. Ne s'jemi kah i bëjmë askujt konkurrencë. Edhe njëherë z. Kryesues po them, nëse mendoni me respektua Kushtetutën, që dojmë me heq prej dilemës atë. Që mos me shkua shumë me bo përralla këtu. Nëse doni me respektua Kushtetutën, atëherë edhe sa i përket institucionit mjafton kjo që është. 1878 nënkupton diçka tjetër. Atëherë lypim edhe Lidhjen Shqiptare të Prizrenit me shtua aty. Po e qite vitin, lypet edhe Lidhja Shqiptare. Se me shkua 1878 – Lidhja e Prizrenit, nuk e dimë a janë lidh kuajt, a lopët, a dhitë, dreqit aty kush u lidhë. Aty është Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Ku është bo një platformë kombëtare për bashkimin e trojeve shqiptare. Edhe në emër të asaj është bërë edhe lufta e armatosur edhe është ngritë vetëdija kombëtare. Prandaj ti keni parasysh këto gjëra, mos ti bastardojmë, mos ti degradojmë. Nëse nuk dimë është mirë mos me fol, në fund të fundit. Ai që ja merr mendja që është kah di çka është kah bënë të bëhemi ne për krah, i bëmi bashkë edhe vendosën këto gjëra.

**Karanfil Haxhillari:** Vetëm dëshiroj që paraprakisht disa informacione se pse kemi ardhur dhe çka ka ndodh derisa kemi ardhur në këtë pikë. Vendimi i datës 18 mars 2010 i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, i bazuar në një ankesë të parashtruar nga ai Kuvend, nga ai zëvendëskryesues, ka bërë që viti 1878 ti hiqet nga emblema e komunës. Më të vërtetë ju përgëzoj për këtë iniciativë që e keni marrë për me rikthye vitin 1878. Definitivisht në qoftë se hiqet viti 1878 na kjo emblemë, thjesht na mbetet një monument i vjetër pa asnjë domethënie. Neve si LVV-je në atë kohë nuk kemi qenë as asamblist as pjesëmarrës të atyre vendimeve. Por më sa e mbaj në mend e kemi kundërshtua edhe me protesta dhe jemi arrestua në atë kohë në kundërshtim të kësaj të cilën sot po dona me rikthye. Thjesht kemi ardhur në një gjendje, ku më së miri përshkruhet një gur e hedh një i çmendur, nuk mund ta nxjerrin njëqind të mençur. Atëherë më sa e di unë është formuar enkas nga ekzekutivi i asaj kohe, një komision për largimin e kësaj logoje. Pastaj më sa mbaj në mend unë edhe dokumentacionet e komunës së Prizrenit, bile, bile janë dhënë pa kurrfarë logo. Është marrë vendim nga kryetari Muja në atë kohë. Veç desha Ilir një përmirësim, kur thotë ligji 03L040 për Vetëqeverisje Lokale, ku thotë: Simbolet e komunave mund të miratohet apo ndryshohen me dy të tretën e votimit të Kuvendit të komunës, pas konsultimit publik gjithëpërfshirës, thotë 2/3. Nuk ka nevojë një komision. Neve e kemi pas një logo. Ndryshime statutare jo, në këtë rast vetëm logon ke me ndërrua, a po kupton. Dhe unë mendoj që vetëm me votën e kuvendarëve 2/3 shpresoj edhe insha Allah mundemi të arrimë, mundemi me rikthye. Vetëm

një rast kur e kemi kundërshtua ne, po të kishim të mëhershmit më të mençur. Dy krahasime mi bo, në qoftë se e këqyrim edhe logon e komunës së Graçanicës. Është po ashtu jo Kushtetuese, sikurse që pat nxjerrë atëherë atë vendim Gjykata Kushtetuese. Edhe sot e asaj dite përdorët logoja e Graçanicës me vitin 1303. Në ueb sajt në qoftë se hyni, ky Qeveria e Kosovës i ka dizajnuar ato ueb sajte nuk është. Në qoftë se i këqyrim edhe dokumentet e viteve të fundit nga komuna e Graçanicës, ende figuron ai vit që është në kundërshtim me Kushtetutën. Tash pse përdorim standarde të dyfishta për një komunitet. Kurse ta q 'bëjmë një komunitet shumicë. Po më vjen shumë mirë, përsëri po e cekim. Më të vërtetë LVV-je në këtë rast e mbështet dhe kërkojmë ndihmën e të gjithë artereve. Sepse është një vendim nga Gjykata Kushtetuese. Që kogja punë duhet për me e q 'bo. Prandaj edhe si LVV-je e mbështesim, ama jemi shumë vonë. Shumë vonë, shpresoj që të arrihet në atë synim dhe të kthehemi në gjenezë, në atë vitin, ku ai vit më të vërtetë na përkujton shumë gjëra. Thjesht viti 1878 është viti i themelimit të kombit shqiptar.

**Shukri Quni:** Unë po habitëm tash, çka kjo ndikoj kaç dhe u trembën disa edhe u larguan që nuk ka nevojë. Sepse Lidhja Shqiptare e Prizrenit, nuk ka qenë kundër asnjë komuniteti kur është formua 1878. Bile përkundrazi Perandoria Osmane atëherë e ka mbështet në fillim. Tash me hy historikisht, kjo veç po tejkalohet pak. Se s'kam pas dëshirë me hy në këto tema që hymë tash kolegë. A kthehet a s'kthehet ne duhet të bëjmë kërkesë. Edhe ajo shtëpi që është aty, mundet me qenë edhe ndonjë shtëpi tjetër. Ajo që e identifikon këtë logo është viti 1878. Edhe kërkesa është që viti 1878 me ju kthye logos së Prizrenit. Vetë komuniteti boshnjak kanë qenë ata të cilët e kanë përkrah. Edhe këta kanë qenë pjesëmarrës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Kështu që Lidhja Shqiptare e Prizrenit ka qenë ajo që ka mbrojtje trojet shqiptare për mos me u copëtua. Nuk ka qenë kundër asnjë komuniteti. Bile, bile ka qenë unike që mu bashkua sa më tepër, të gjithë ata që kanë jetua në trojet shqiptare. Në rast se hymë tash historikisht, po s'ka nevojë me hy. As me vajtua do që nuk bëhet. Mua po më kujtohen vitet 97-98, kur filloj lufta, shumëkush thoshte s'bëhet liria. Kur punon edhe i bënë hyzmet asaj bëhet. Unë pata dëshirë me qenë edhe Artani tash këtu. Edhe kolegët që kanë dalë jashtë, se s'kanë pas nevojë me dal jashtë. Se Lidhja e Prizrenit duhet me qenë unik me na bashkua të gjithëve. Edhe unik ka qenë që i ka bashkua viti 1878. Unë nuk e di viti 1878, kënd e pengon edhe për çka. Këta duhet vetë mu qua edhe me përkrah një gjë të tillë, kur po jetojmë të gjithë këtu. Kjo s'është një diçka që po e fyen ndonjë komunitet tjetër. E kështu që kolegë kuvendarë edhe në temën e mëparshme që kem nuk u inkuadrova, se kogja po marrin kahe tjera diskutimet. Edhe këtu tash nëse i japim kahe kësaj pike që unë e falënderoj edhe kryesuesin edhe KPF-në

që e ka fut në rend dite. Mos harroni se na jemi kuvendarë këtu. Nuk e di ai kolegu se qysh e përdori the se i çmenduri e hedh tha një gur, njëqind dhe s'mund e nxjerrin. Kush qenka unë s'po e di. Po neve të çmendur na kanë quajtur të gjithë kur i kanë inicua gjërat. Nuk e kam inicua këtë në emër të partisë, as që jam më i forti, as që jam më i dituri. Po e kam inicua sepse kjo duhet me u kthye edhe duhet ne me përkrahë të gjithë. Nuk ka nevojë ne me shkua në atë ekstrem. Po kërkesë ka qenë me ju kthye logoja viti 1878 Prizrenit dhe asgjë tjetër. Ky Kuvend e voton, jemi për me dorëzua në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ne s'jemi që marrim vendim këtu. Ju vendim keni marrë LVV-je, e keni qit atje pa pyet askënd te dera. Edhe bravo ju qoftë edhe e përkrahi një gjë të tillë. Sepse qashtu edhe duhet të jetë. Po ne tash nuk po kërkojmë në atë mënyrë. Po, po kërkojmë të votohet, të diskutohet. Po diskutimi me qenë unik e jo përçarës. S'ka nevojë këtu me hy tash, kush ka qenë e kush e ka bo, ajo ka kalua tash. Na po kërkojmë tash me pas një logo që me i bashkua të gjithë. Po nuk e di çka po u preken kaq tepër këtu njerëzit në raste se del viti 1878. Atëherë se paskan edhe në pran program të historisë Lidhjen e Prizrenit. Kështu nuk e kisha zgjatë tepër me hy historikisht, se e njihni krejt historinë. Po kërkoj që ne ta mbështesim të gjithë, ta votojmë. Ta dërgojmë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal edhe ajo le të merr vendim. Le të ndërrohen edhe nenet edhe Kushtetuta le të ndërrohet, pse çka ka. Nuk bëhet kush e di sa, me i hy edhe Kushtetutës, se ne s'kemi qare disa gjëra pa i lëvizë. Edhe jam i bindur që asnjë qytetarë i Prizrenit nuk ndihet keq, në rast se emblemës së Prizrenit i kthehet viti 1878. Unë kaq kam, kryesuesi nuk ke këtu. Unë kryesues ato që u diskutuan s'patë nevojë me hy aq... S ajo kolegja me fillim e filloj atë. Po kolegët këtu që janë... Unë se qysh kam shpëtua prej luftës nuk po e di. Veç kur kam ardhur në këtë asamble e kam ditë që kanë me ardhur lloj, lloj kuvendari. Këtë çdo njëri duhet me ditë. Edhe invalid të luftës kush vjen, vjen pa këmbë këtu hyn. Nesër kanë me ardhur edhe komuniteti serb. Nuk kemi nevojë ne mu fërkua kaq rreptë në mes veti. Ko është votë e lirë. E ngrenë dorën ose je kundër. S'ka nevojë me lëshua mbledhjen për çka. Këtu askujt nuk iu tha asnjë fjalë e rëndë. Është një pikë që është propozua, që kam të drejtë me propozua, jo vetëm unë po edhe ju çdo kuvendarë që është këtu, edhe diskutohet. Kryesuesi është për atë e qetë në votim. Votohet, apo s'votohet ajo varët krejt prej nesh. Edhe njëherë po ju them. Nuk e kam propozuar kolegë më herët kolegë me ia rrit vetës namin. Po edhe ju keni me kërkua nesër në rast se nuk kthehet, keni me kërkuar parape edhe ju kush është pas, kushdo qoftë. Atëherë duhet me u heq pra edhe ajo shtëpia e Lidhjes së Prizrenit. Në rast se është pa vlerë për disa. Hiqni krejt edhe kurrgjë kurrkujt. Po jo me ardhur ata prapë e heqin, ata edhe e kanë kallë krejt besa. Në rast se hymë tash në qete. Ne po hymë edhe po i qelim gjëra të reja. Ata e kanë kallë krejt, na kanë djeg edhe

neve, na kanë vra e tona i kanë bo. Po veç shqiptarët një gjë të tillë se kanë bo. E kanë ruajt edhe jemi frymëzua prej saj. Edhe ajo datë i bënë mirë shumë logos së Prizrenit. Përndryshe vetëm me një shtëpi, kjo tregon që nuk e ka atë rrezatimin që e ka pas.

**Haziz Hodaj:** Ne duhet të jemi të vetëdijshëm që edhe për ndryshimin e logos ka një procedurë. Sigurisht që do duhej së pari mirë tha Iliri të behën ndryshime statutare. Sepse bëhet fjalë të ndërhyrjes në Statut. Dhe në momentin e ndërhyrjes në Statut. Sigurisht që do duhej të ndryshohej, qoftë edhe në presje nëse ndryshon. Kjo logoja këtu me vitin 1878 është bërë kur LDK-ja ka qen në pushtet në komunën e Prizrenit. Madje ish kryetari i komunës Eqrem Kryeziu është autor i kësaj logoje. Dhe është zhvilluar një debat qoftë më zë të lartë edhe me zë të ulët, qoftë argumentues edhe jo argumentues. Është bërë një debat shumë i fuqishëm edhe në kohën kur është iniciua ndryshimi. Po bëhet fjalë për një organ më të lartë të drejtësisë në Kosovës, të cilit nuk mundet me ju gjuajt as presidenti, as kryeministri askush tjetër. Dhe më pëlqej Sinan Alijaj. Nëse i hymë për me ndryshua, sigurisht që do ta keni voton pro. Po për me i hy edhe me bo lojë edhe në foltore me dal me shit folklor. Sepse folklori na ka mundua tërë kohën, unë nuk do të pajtohesh në asnjë mënyrë. Kështu që është mirë fillimisht të bëhet një komision për ndryshimin e Statutit, fillimisht. E ky komision të punoj edhe me organet kompetente, edhe me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal edhe Gjykatën Kushtetuese. Dhe nëse i hymë të ndryshohet, natyrisht me pas edhe pajtimin edhe të komuniteteve pakicë. Sepse e kemi thënë disa herë nuk e lëndon ndjenjën e askujt viti 1878. Kështu që është mirë që të bëhet një komision statutar. Dhe ky komision të punoj pastaj edhe për të vu kontaktet edhe me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Edhe me Gjykatën Kushtetuese pse jo. Dhe në fund ta kemi një konsensus për miratimin e saj. Sepse flitet për një emblemë e cila do të përfaqësoj interesat e të gjithë qytetarëve të komunës së Prizrenit.

**Pranverim Berisha:** Në fakt kjo ngjarje për ruajtjen e trojeve shqiptare logoja e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit atë kuptim e ka. Dhe ne nëse është e nevojshme edhe Gjykata Kushtetuese pasi është garantuese e të drejtave tona njerëzore dhe kombëtare, duhet të bënë edhe ndryshimet kushtetuese. Po logoja duhet mu rikthye. Aq emocionale, aq domethënëse është, sidomos për prizrenasit, që logoja duhet me kthye në institucionin që mungon.

**Alush Shala:** E përshëndes në veçanti Shukri Qunin, i cili ka qenë nismëtarë edhe këmbëngulës për këtë pikë të rendit të ditës të një seance çfarë jemi sot. Sinqerisht edhe Sinan Alijaj i përmendi shumë pika dhe detyrimisht jemi që ta përkrahim dhe të jemi plotësisht me të. Po ashtu edhe Karanfil

Haxhillari nxori edhe argumente me fakte. Që në Kosovë ka edhe gjëra të tilla që nuk e pengojnë krejt Kosovën, e viti 1878 ka pengua vetëm një individ. Vetëm një individ ka pengua dhe për hatër të një individi është bërë një ndryshim aq i madh. Edhe Hazizi e kuptova shumë drejtë sipas meje, që ky kërkon vendimet tona të jenë të realizueshme dhe të zbatohet edhe në praktikë. Por unë kërkoj që sot të votohet ky vullnet i kuvendarëve që bartën përgjegjësinë e votuesve të vetë. Duke filluar nga krijimi nëse ka nevojë që duhet ligjërisht një komision për ndryshimin e Statutit të komunës së Prizrenit. Ju kryesues, keni mundësi sepse keni jurist të mirëfilltë dhe të fortë besoj brenda komunës. Dhe se si duhet me veprua me ligj të bazohemi edhe në udhëzimet e tyre dhe Kuvendi sot ta votoj këtë kërkesë për ndryshim. Edhe le të punojnë komisionet përkatëse me njerëz specialist të kësaj fushe. Dhe kjo çështje të zgjidhet njëherë e përgjithmonë. S'po them, sepse një kolege pakë më parë tha kjo punë tha ka marrë fund. Ne e kemi pas këtu edhe Serbinë, siç e përmendi edhe Shukri Quni. Ka pas ligje shumë diskriminuese, por nuk janë, ka pas ligje edhe para dhjetë viteve shumë diskriminuese për shqiptarët për shumicën, po ne i kemi tejkalua. I ftoj edhe kolegët të nacionaliteteve të ndryshme që janë në Kuvendin e komunës së Prizrenit, ta përkrahin këtë iniciativë. Dhe jam i bindur që do ta fitojnë edhe respektin te komuniteti i cili i ka votua këtu. Pra nuk e di a duhet të debatohet. Mirë është me mbyll debatin. Po me një votim pro ndërrimit të kësaj logo dhe rikthimin e vitit 1878.

**Sencar Karamuço:** Fillimisht do të theksoj në përkrahje që çdo diskutim të mbahet nën ombrellën e Kuvendit komunal. Edhe për atë arsye sot jemi këtu. Për këtë temë ne si parti seri më sot asnjëherë nuk kemi qenë pjesë e vendimeve të cilët janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Deri sot s'kemi qenë edhe më tutje s'kemi me qenë. Ne do të vazhdojmë të jemi të ndjeshëm në respektimin e ligjit. Mbi të gjitha dua ti rikujtoj edhe njëherë atyre që dëshirojnë ti japin krah tjetër zhvillimeve. Komuniteti turk i Kosovës asnjëherë nuk ka pas qëndrim kundër kurrkujt edhe nuk ka ma pas asnjëherë. Duke e par të nevojshme të ritheksoj se nuk do ti bashkëngjitemi asnjë propagande politike të asnjë partie. Mendojmë se për këtë formulim të sotëm çka u propozua, është në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

**Kryesuesi:** Po flas në cilësinë e anëtarit të Kuvendit. Nuk po dua me hy në këtë çështjen e betejës klasike. Jo pushteti i kaluar keni bo kështu, jo ky pushtet tash duhet kështu. Në fund të fundit pak ka rëndësi. Një gjë mundem me thënë me bindjen më të plotë. Anulimi i logos së komunës së Prizrenit viti 1878 është një ndër padrejtësitë më të mëdha që i është bërë komunës së Prizrenit dhe qytetarëve të komunës së Prizrenit. Suspendimi i vullnetit të shumicës, në një sistem që thuhet që është demokratik, e sundon shumica, unë e kem të paqartë.

Por kur nuk di as kujt mi lënë faj se në anën tjetër duke e ditë se si funksionon një Republikë, si është rendi i institucionit edhe si është hierarkia. Pas interpretimit të një institucioni si që është Gjykata Kushtetuese. Pak ka gjëra që mund të bëhen, kjo është fakt. Po ashtu këtu nuk po mundem mi fajësua as deputet të kaluar shumë, që besa skaj herë edhe po i fajësoj shumë. Është për shkak se në momentin kur është miratua Kushtetuta me propozimet e pakos së Ahtisarit. Me idenë e shtetit multietnik, nuk është shumë se ka menduar për pasojat e atyre dispozitave se tybe as që i kanë lexua. Kanë qenë të dehur tepër me idenë se po vjen pavarësia e Kosovës dhe nuk ka pas shumë analiza. Bllanko u patën fut dispozitat kushtetuese, nëse e mbani në mend. As që e kanë analizua fort, veç se u përmend fjala pavarësi. Po tash kjo Kushtetutë është qysh është dhe e ka një interpretim. Ku simbolet e shumicës po konsiderohen jo kushtetuese dhe pjesa tjetër që nuk është shqiptare nuk po identifikohet me to. Pak a shumë kjo është ideja e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Unë pyes Gjykatën Kushtetuese ose ndonjë ekspert juridik. A ka mundësi me më tregua mua, kjo logoja e komunës së Graçanicës. Logoja brenda sa po mundem me kuptua është Kisha edhe poshtë është viti 1303. Çka është ky vit! Ose logoja e komunës të Leposaviçit. Ose logoja pothuajse e të gjitha komunave serbe. Që po ta shikon përmbajtjen, ngjyrat, historinë aty, dalin se janë më serbe se sa komunat serbe në serbi. Tash edhe unë po pyes, hetimet e Gjykatës Kushtetuese, a nuk vlej për krejt territorin e Kosovës. A ka mundësi së paku neve si qytetarë të Prizrenit me na dhënë një shpjegim për këtë punë. Pse në Prizren s'po bejka me pas. Po i anulojmë krejt. Dakord është standard në nivel të Kosovës. Çka është 1303? Që besa edhe përbërja demografike e Graçanicës ka ndryshua shumë. Tashmë më nuk dihet raportet sa janë shqiptar serb atje. Çka me bo tash! Sido që të jetë, këtu si Kuvend ne duhet të dalim me propozim konkret. Ju e di që veç me një votim nuk bëhet kjo punë. Por se duhet me ditë të gjithë, sidomos ata të nivelit qendror. Se pavarësisht se a kthehet apo jo logoja. Pavarësisht se a do të bëhet në këtë legjislaturë, apo legjislaturë të ardhshme. Unë veç një gjë po ju them me bindjen më të plotë, se kurrë asnjëherë nuk kanë me pushuar orvatjet tona për me korrigjua këtë padrejtësi. Këtë e di të sigurt, për tjera nuk e di se çka do të bëhet. Tash pas diskutimeve, na duhet një propozim konkret se çka do të bëjmë më tutje. Nga PDK-ja a keni ndonjë propozim.

**Simir Krasniqi:** U diskutua boll për rikthimin e logos. Nuk do të ishte aq lehtë siç thatë ju për me rikthye atë. Po pasi duhet të ndryshohet edhe Statuti i Komunës, ndoshta është mirë që ne ta caktojmë një komision i cili do të merret me ndryshimin e Statutit të Komunës dhe procedurat ligjore në Kushtetutën e Kosovës. Mendoj se qëllimi i gjithë asamblistëve këtu është që ta kthejmë vitin

1878 dhe logon e komunës së Prizrenit. Mendimet e tjerëve mund të jenë të ndryshme. Por është mirë që të caktohet një komision dhe të merret me ndryshimin e Statutit të komunës dhe kthimin e logos të komunës së Prizrenit.

**Karanfil Haxhillari:** Shumë në rregull me komisionin për ndërrimin e Statutit. Mirëpo, paraprakisht unë mendoj që para kësaj duhet ti sigurojmë votat a i kemi 2/3, sepse ne mundemi me caktua një komision për me ndryshua Statutin e Komunës. Mirëpo pastaj kur të vijmë për me votua, nuk i kemi 2/3 e votave. Kjo është do më thënë edhe një sfidë tjetër si Kuvend komunal. Pos sfidave pastaj që kemi mi pas edhe në Ministrinë e Pushtetit të Administrimit Lokal dhe me Gjykatën Kushtetuese.

**Illir Baldedaj:** Unë që në fillim propozova të formohet një komision, sepse duhet plotësim- ndryshim të Statutit, cilën do formë mundesh me e modifikua. Po nëse ai komision nuk e bjen një propozim, nëse e ka një presje apo një pikë, jo sikur ky paraprakë, nuk kalon as në MAPL, dhe është në kundërshtim me Gjykatën Kushtetuese. Unë prandaj kërkova një komision dhe ai komision mandej e merr barrën Karanfil. Sepse ti nuk mund ti sigurosh votat pa e pas një propozim të ri. Sot nëse ti kërkon ti kesh votat, nuk e dimë për çka po kërkon vota. Kur e ke nga komisioni për ndryshimin statutar, pastaj mund të kërkosh mbështetjen e votave. Kryesues për çdo vendim unë jam pro formimit të një komisioni qoftë të gjitha partitë politike, nga shoqëria civile. Nga kushdo qoftë që mund të kontribuoj në këtë çështje.

**Kryesuesi:** Nëse nuk ka ndonjë propozim tjetër. Duhet ta kemi parasysh se vendimet e Kuvendit komunal, nuk mundën me i anulua vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Por se ky propozimi nga z. Baldedaj, pastaj që u tha nga z. Haziz Hodaj për formimin e një komisioni statutat, që në realitet ka për obligim shqyrtimin e mundësisë për ndryshime statutare. Neve duhet ta kemi këtë komision, është dashtë në fillim me bo këtë. Hiç pa ardhur kjo çështje. Komisioni statutar është dashtë mu themelua. Që të jetë në gjendje gatishmërie në rast se paraqitet nevoja për ndryshime statutare apo amandamentimeve të rregullores së punës. Ju e mbani në mend kur e kemi pas hartua rregulloren e punës, komisioni statutar e patëm themelua. Prandaj kërkesa për themelimin e komisionit statutar si organi i ligjshëm i komunës së Prizrenit, mund të bëhet, padyshim që po. Edhe vetëm po i dëgjojmë pra propozimet e partive politike për anëtarë të këtij Komisioni. Nëse nuk dëshironi që ky komision të përbëhet nga anëtarët e Kuvendit komunal, por të jetë nga ekspertët juridik, qofshin edhe ata të jashtëm. Mund ta bëjmë edhe një gjë të tillë. Por për ka numri unë propozoj që të gjitha subjektet politike të përfaqësohen me nga një anëtar. Qofshin këta shefat e grupeve, qofshin ndonjë anëtarë i Kuvendit, apo ndonjë propozim i



jashtëm të cilin mendoni se mund të kontribuoj, për kah përbërja. Unë po e hedh në votim themelimin e komisionit statutar të Kuvendit komunal të Prizrenit. Po i dëgjojmë atëherë qëndrimet e shefave të grupeve.

**Simir Krasniqi:** Po pra ne si PDK e mbështesim themelimin e një komisioni statutar.

**Adem Shabanaj:** Edhe LVV-je e mbështet.

**Kryesuesi:** A po na definoni emrat a po i bini me shkrim. Pra ta definojmë edhe njëherë.

**Simir Krasniqi:** Ne pasi ka qenë edhe iniciator i ndërrimit. Pra propozojmë Shukri Qunin.

**Adem Shabanaj:** LVV-je, Karanfil Haxhillarin.

**Sadije Osaj:** Edhe ne propozojmë z. Fatmir Memaj.

**AAK:** Ilir Baldedaj.

**Ganimete Babuna:** Edhe ne e mbështesim themelimin e komisionit, dhe e propozojmë Sinan Alijaj.

**Sencar Karamuço:** Çdo gjë që është në përputhe me ligjin ne do të përkrahim. Do të përkrahim komisionin, për emër do të diskutojmë pak, pastaj do të japim me shkrim.

**Samra Iljazi:** Azem Durmishi.

**Memnuna Ajdini:** Obzirom da imamo novo nastalu situaciju za koju nismo predvidali kako e se odvijati. I obzirom da smo smatrali da ovo pitanje završeno. Mi emo se konsultovati u partiji, da emo naknadno ime.

**Kryesuesi:** Atëherë të nderuar anëtarë të Kuvendit. Jemi 33 anëtarë në sallë dhe sipas debatit të bërë nga anëtarët e Kuvendit, doli propozimi për themelimin e komisionit statutar të Kuvendit komunal të Prizrenit, në përbërje: Nga PDK Shukri Quni, nga LVV Karanfil Haxhillari, nga LDK Farmir Memaj, nga AAK Ilir Baldedaj, nga Nisma Socialdemokrate Sinan Alijaj, KDTP do ta diskuton dhe sjell emrin më vonë, nga NDS Azem Durmishi dhe po ashtu koalicioni Vakati do ta diskutojë dhe do ta sjell më vonë. Nga 33 anëtarë sa jemi në sallë unë do ta hedh në votim propozimvendimin për themelimin e komisionit sanitar, kush është për?

Për? – 29.

Kundër? – S’ka.

Abstenim? – 4.

Atëherë konstatoj se me 29 vota për, asnjë kundër dhe 4 abstenime miratohet propozimvendimi për themelimin e komisionit statutar.

Pas Pauzës.

**Pika e gjashtë:**

**Shqyrtim - diskutim, për propozimvendimin për lejimin e ridestinimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore.**

**Kryesuesi:** Ftoj sponsorizuesin e këtij propozimvendimi z. Fatmir Memaj drejtor i Urbanizmit, që ta arsyetoj më mirë para Kuvendit.

**Ilir Baldedaj:** Për këto pika tu kisha lutur veç me shkua me shefat e grupeve, mos me hap debat edhe me përfundua, sepse e kemi e kemi buxhetin, që merr shumë kohë. Kështu që i kisha lutur edhe kolegët tjerë të kenë mirëkuptim në këtë rast. Se tash është ora 14:30 dhe Zoti e dinë kur përfundon buxheti. Sa kërkesat e rrugëve, lagjeve, mëhallëve hynë.

**Kryesuesi:** Faleminderit i nderuar, po mendoj njëherë në muaj po mblihdemi, është mirë që ti trajtojmë rastet kështu. Por po ia lëmë propozimin drejtorit. Eventualisht në qoftë se ka ndonjë pyetje dikush, shkojmë ashtu si po thua ti. Drejtor fjala është e juaja.

**Fatmir Memaj, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor:** Unë nga një person fizik, i cili është edhe me autorizim edhe me kontratë për qira mbajtje të një ngastre, me një person juridik. E kam në kërkesë për lëshimin e lejes ndërtimore për një stallë bujqësore. Në mes kushteve tjera, nevojitet edhe ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Bëhet fjalë për një ngastër kadastrale nr. 001 zona kadastrale Novak. E cila është në sipërfaqe prej afër 56 hektarë. Ndërkaq ridistinimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore është i nevojshëm të bëhet në një sipërfaqe prej 1000 metra katrorë përkatësisht për 10 ari. Kuvendarët e nderuar e kanë propozimin para tyre. Në qoftë se e shohin të arsyeshme ta lexoi. Po besoj se ndoshta qeto shpjegime mjaftojnë. Përndryshe është edhe pala prezentë këtu. Nëse keni nevojë për ndonjë sqarim shtesë. Veç desha me thënë që ky është objekt, i cili është objekt ndihmës, për zhvillimin e veprimtarisë bujqësore. Edhe me ju thënë sinqerisht pa dashtë me bo politikë po mendoj që është një kontribut sado i vogël në rritjen e produkteve vendore. Realisht se ne e dimë të gjithë këto produkte për rritjen e viçave, kryesisht i importojmë nga Serbia. Prandaj ndoshta është mirë me edhe në edhe një kontribut të vogël ne këtu. Unë ju falënderoj për vëmendjen edhe normalisht ju ftoj për me mundësua ndërrimin e këtij destinimi.

**Xhavit Uka:** Unë pasi që vij edhe nga ajo anë, përafërsisht edhe e di shumë mirë atë terren. Propozimin për kthimin e tokës pjellore në tokë bujqësore, kjo është po më duket e kategorisë së pestë. Kështu që unë e përkrahë këtë investitor, pasi e njoh edhe fort mirë. Ajo është për hapjen e vendeve të punës. Edhe ka të bëjë me një sipërfaqe shumë të vogël, ajo i bije diku dhjetë ari. Kur ta përkthesh në 55 hektarë, në dhjetë ari me bo pengesa nuk e shoh të arsyeshme. Për atë unë e përkrah plotësisht.

**Alush Shala:** Unë fjalën time e kam dhënë edhe në KPF. Në fakt edhe jemi marrë vesh, që këtu ta japin mendimin shefat e grupeve parlamentare. Po meqenëse ke hap debat, të gjitha subjektet politike kemi premtua, kemi thënë që do të hapim vende të punës. Shyqyr që dikush mundet me i marrë 1, 2, 5, 8 apo 10 punëtorë. Ne duhet të jemi në përkrahje të atij. Pastaj siç e tha edhe Xhavit, edhe drejtori, bëhet pyetje për 1000 metër katror me shndërrua. Shumë mirë që po kërkon leje dhe po e respekton institucionin. Andaj tu kisha lut, kërko vetëm pëlqimin e shefave të grupeve parlamentare ose drejtpërdrejtë edhe në votë. Unë personalisht do të jap pro votën time.

**Shukri Quni:** Edhe unë nuk jam kundër. Po a do të kemi tani e mbrapa kësi kërkesa dhe a do të jem në gjendje mi plotësua edhe tjerat kërkesa, në rast se na ofrohen neve këtu në Kuvend. Se askush nuk është kundër, për investime që behën në Kosovë. Po duhet të jemi për të gjithë të barabartë. Më sa e di kemi pas edhe kërkesa edhe më herët, po nuk ju kanë dhënë lejet. Kështu që ta diskutojmë mirë, që të merret vendim. Që kur ta bijën kërkesën edhe X biznesmeni tjetër, të jetë e lejuar edhe për atë. Për atë e kam që a vetëm për këtë person do të jetë, apo tjerët kur kanë kërkesa. Apo ne do të marrim vendime të tilla sa herë kur kemi kërkesë kësisoj. Nuk jam kundër për këtë, por kërkoj që të jetë një vendim për të gjithë. E keni pru shumë vonë këtë. Ka qenë dashtë ne këtë material me pas më herët, sepse këtë material e keni sjellë pas komitetit.

**Adem Shabanaj:** Secila kërkesë që vjen në Kuvend shqyrtohet. Edhe secila kërkesë duhet të ketë bazë për lejimin e ndërrimit të destinacionit apo ridestinimin. Kjo sot unë po e shoh që ka bazë. Është tokë bujqësore edhe objekti i cili po kërkon me ndërtua në dhjetë ari, do të ndërtohet përsëri bujqësi. Secili kërkesë prej qytetarëve që vjen ne duhet ta shqyrtojmë dhe ta diskutojmë dhe e marrim vendim. Nuk mund të marrim vendim unanim për çdo kërkesë që vjen në Kuvend dhe të votohet pro. Secili anëtarë i Kuvendit e ka në dorën e vetë për me votua pro ose kundër. Po kërkesa që vjen prej qytetarëve duhet të ketë bazë siç është kjo sot. Të gjithë jemi të vetëdijsëm që të kjo kërkesë ekziston, sepse po kërkohet prej tokës bujqësore të lejohet ridestini prej dhjet në objekt, të cilën përsëri do ta shfrytëzoj për bujqësi.

**Sulltan Badallaj (PDK):** Ridestnimi i tokës ka qenë edhe më herët, s' di a jeni të njoftuar, përmes Drejtorisë së Bujqësisë është kryer kjo. Edhe nuk do të thotë që është bërë vetëm për fermë, apo për stallë apo për diçka tjetër, por edhe për objekte industriale është bo. Edhe ka qenë me ligj e rregulluar, po nuk e di a ka qenë e afatizuar apo jo. Përndryshe gjithnjë është bërë ridestnimi i tokës kohë pas kohe.

**Kryesuesi:** Veç sa për njoftim. Kjo pikë e rendit të ditës ka ardh në Kuvend pasi është miratua në KPF-ca. Kështu që qëndron ajo që tha z. Quni që është me vonesë. Por se po ashtu po bashkëngjitëm plotësisht lidhur me këtë se çka do të ndodh me rastet e ardhshme, si Kuvend kur vinë raste individuale. Duke iu bashkuar edhe asaj që e tha edhe Ademi, pavarësisht kësaj ne duhet ti trajtojmë të gjitha kërkesat si institucion që vinë. Unë vetëm kam një pyetje, padyshim besoj të gjithë jemi të mendimit që duhet ta mbështesim sektorin dhe gjithë investuesit, sidomos sektorin e bujqësisë. Unë nuk jam shumë ekspert i këtyre kategorizimeve, por thjesht vetëm prej kureshtjes po dua me ditë. Tani kjo zonë, është zonë e mbrojtur bujqësore dhe kërkon që ti ndërrohet destinimi më qëllim që të mundësohet realizimi i një stalle e cila është e madhe. Dhe investitori kërkon të përfitoj grandin që jam dakord. Por në Prizren dhe në komunat tjera, sa e di kur vjen puna të destinimi i tokave, nëse nuk gaboj. Kushdo që mundet me më informua për këtë. Tokë e mbrojtur bujqësore, ka tokë industriale nëse nuk gaboj apo, tokë ndërtimore. Edhe a ka tokë për zhvillim të bujqësisë. Po a, këtë po e kërkoj se në fillim kur u informova, kërkesë ka qenë që në vend të zonë e mbrojtur bujqësore, të bëhet zonë për zhvillimin e bujqësisë.

**Haziz Hodaj:** Toka është e kategorizuar në kategori, i klasës të parë, dytë, tretë, katër, pestë. Dhe tash lejohet po e zëmë mbi kategorinë e klasës së pestë nuk ke nevojë me marrë vendim se ke të drejtë për ndërtim. Ajo nuk është e kategorisë mbi pesë, po është nën pesë dhe kërkohet ridestnim me marrë vendim Kuvendi. Kjo është arsyeja e kërkesës. Përndryshe nëse është mbi kategorinë pesë ai nuk ka nevojë me kërkua ridestnim. E ndërton edhe e ka të drejtën.

**Fatmir Memaj:** Fillimisht dëshiroj të theksoj se kanë të drejtë kuvendarët që ankohen për vonesa. Po them shumë sinqerisht, ndoshta në këtë rast edhe aspak nuk kemi faj, për shkak se ishte në pyetje përkthimi në procesverbal edhe ishte pamundësia e kohës së ekipit të zyrës ligjore për ta përkthyer. Prandaj do të ishte kontestuese ta qojmë materialin me kohë pa përkthim. Prandaj jemi detyruar me shti në KPF-ca si pikë shtesë. Kategorizimi i tokës është çështje kadastrale e mëhershme që është krye. Edhe si kategori

ekzistojnë me udhëzim administrativ prej klasës së parë deri në klasën e tetë. Po flas në kuadër të Udhëzimit Administrativ e që është nga Ministria e Bujqësisë, e fundit që është në fuqi. Është e 2006 po është ende në fuqi. Ndërrimi i kategorisë të parë deri në të katër bëhet me vendimin e Kuvendi, po pas pëlqimit nga Ministria. Në qoftë se është zonë urbane, atëherë s'ka nevojë me marrë vendim Kuvendi po mundet drejtorja siç e ceku z. Badallaj. Do më thënë mundet Drejtorja e Bujqësisë me marrë vendim për ndërrimin e destinimit. Por në rastet kur gjendet në zonat bujqësore, apo për zhvillimin e bujqësisë, atëherë sigurisht nevojitet vendimi i Kuvendit. Do më thënë prej klasës së parë deri në të katërtën nevojitet pëlqimi i Ministrisë. Ndërkaq për klasën e pestë dhe gjashtë bëhet me vendim të Kuvendit. Dhe për klasën e shtatë dhe tetë bëhet me pëlqim urbanistik, që nënkupton involvimin e drejtorisë drejtpërdrejtë. Sepse tash nuk ka pëlqim urbanistik, po jep pëlqim Drejtorja e Bujqësisë për këtë kategori. Kjo është e paraparë me udhëzim administrativ. Unë nuk e di në të kaluarën. Po them sinqerisht gjatë kohës sa unë kam qenë në një afat katërvjeçar këtu anëtar i Kuvendit, nuk kemi pas raste. Nëse s'gaboje dikush e ceku, Simir që në Kuvendin e kaluar e keni pas një rast apo dy. Po është e paraparë me Udhëzim Administrativ. Kështu që, aq më tepër këtu në këtë rast e kemi një kontratë ndërmjet investitorit dhe të Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për financimin e projekteve investuese për zhvillimin rural. Prandaj përsëri po them është në dorën tuaj se si do të vendosni.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor për sqarimin. Meqë si pikë e rendit të ditës erdhi shpejt edhe nuk pata mundësi edhe me analizua. Prandaj i bëra edhe ato pyetje. Besoj që kryesisht ishte e qartë. Nëse nuk ka diskutim, atëherë 36 janë prezentë në sallë, e hedh në votim propozimvendimin, kush është për?

Për? – 35.

Kundër? – 1.

Abstenime? – S'ka.

Atëherë konstatoj se me 35 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim miratohet propozimvendimi për lejimin e ridestinimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore.

### **Pika e shtatë:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për shpronësimin e pronave të paluajtshme, për ndërtimin e rrugës në lagjen “Gurishtë” në Prizren.**

**Kryesuesi:** Edhe kjo pikë është futur në rend dite në KPF-ca. Është fjala për një çështje mjaft të ndjeshme. Besoj që shumë prej anëtarëve të Kuvendit e dinë se për çka është fjala. Për një rrugë tashëm për shkak të mungesës së rrugës ose kushteve për qarkullim të lirë është bo zonë problematike për vetë banorët e asaj lagjeje. Dhe mendoj se definitivisht si Kuvend ne duhet të ndërmarrim diçka në këtë drejtim, me qëllim të realizimit edhe të kërkesave të banorëve. Po ta zhbllokojmë atë pjesë që sa kohë edhe është problem. Por para se të vazhdojmë me rendin e ditës në KPF-ca, për shkaqe procedurale. Kuvendit kjo pikë i është drejtuar si kërkesë për shpronësim. Proceduralisht duhet të jetë shpallje e interesit publike. Pra, Kuvendi nuk miraton kërkesa për shpronësim, por shpall interes publik. Prandaj nuk e di a janë gati këto përmirësimet. Sepse megjithatë këto lëshime juridike mund të jenë sepse që edhe njëherë mu kthye kjo punë. E kam frikë që nuk ka kohë për me u trajtua kjo kaq gjatë. Atëherë lus Shërbimin e Kuvendit, që tu shpërndaj anëtarëve të Kuvendit këtë formë të përmirësuar për shkak të lëshimeve teknike.D.m.th vetëm titulli i është ndërrua. Kërkesë për shpalljen e interesit publik dhe i nënshkruar nga kryetari i komunës.

**Ilir Baldedaj:** Unë më sa jam në dijeni, Ligji për shfrytëzim të pronës komunale ka kalua në Parlamentin e Kosovës. Dhe shpallja e interesit të përgjithshëm më sa e di unë është vendim që asambljetë më nuk kanë të drejtë shpalljen e interesit të përgjithshëm. Sepse me ligjin e ri ka drejtë kryetari të negocioj, mi zgjidhë të gjitha problemet tjera. Pastaj të ia dërgon asamblesë komunale. Kështu që është njëfarë vakumi ligjor kryesues, që ndoshta ka me na qit në lajthitje në vendimin që e ka Ministria e Administratës Publike që e bënë monitorimin. Edhe besoj që ata online e përcjellin seancën. Mund të jetë që vendimi të rikthehet prapë. Sepse unë më sa kam informacione ligji i ri ka kalua në Kuvend.

**Kryesuesi:** Më sa jam i informuar unë, në raste kur miratohet një ligj i ri në Kuvendin e Kosovës, komunat dhe të gjitha subjektet që i nënshtrohen apo punojnë mbi bazën e atij ligji, njoftohen zyrtarisht. Deri më tani si komunë nuk kemi pranua ndonjë njoftim zyrtarë për hyrje në fuqi të ligjit. Ndonëse është miratua. Pa u publikua në gazetën zyrtare dhe pa u bo njoftimi zyrtarë. Sipas praktikës ne duhet të punojmë mbi bazën e ligjit në fuqi. Do më thënë mbi bazën e ligjit aktual. Por sigurisht ne do ta bëjmë në pajtim në koordinim me Ministrinë Pushtetit Lokal. Unë uroj që çdo gjë do të jetë në rregull. Por nëse ka dilema të tilla, ne e rishqyrtojmë edhe njëherë këtë s'ka problem.

**Ilir Baldedaj:** Kryesues ka pas edhe kërkesa tjera që është dashtë të hynë në rend të ditës. Sepse Drejtoria e Arsimit e ka një kërkesë rrafsh që tre muaj në

një zonë në pjesën e Shkozës. Pastaj e ka një kërkesë nga Arbana për një stadium për shpallje të interesit publik. Dhe është dashtë që të hynë të gjitha. Sepse u është thënë atyre që kanë bo kërkesë, nga drejtorët përkatës, që është vendim që nuk ka të drejtë asambleja me shpallë interes të përgjithshëm. Për shkak se është ligji i ri në procedim. Tash mos luaj me dy kute. Ose është një kërkesë që ka qenë e komunitetit dhe tash kërkesa tjetër për një komunitet ndryshe.

**Kryesuesi:** Fjala është për shfaqje të interesit publik mbi pronat të menaxhuara nga AKP dhe Ekonomia e Pyjeve. Do të thotë kërkesa ka qenë shumë specifike. E vërtetë është kjo që po thua. Por ka të bëjë vetëm me pronat e Ekonomisë së Pyjeve dhe pronat e menaxhuara nga AKP. Ku Ministria e Pushtetit Lokal na ka njoftua se nuk do ti në miratimin e ligjit të ri. Por siç tha edhe vetë, pasi është miratua ligji i ri, ky kufizim më nuk vlen. Ne ta procedojmë për shkak se tamam e zëmë edhe afatin ligjor kur tërhiqet kjo ndalesë. Përndryshe po ashtu ka qenë. Bile jo ato që i tha ka qenë rasti edhe i shkollës në Shkozë. Edhe rastet të tjera për të cilët ne nuk kemi mund. Por sidoqoftë tash e pas besoj që do ti trajtojmë.

**Haziz Hodaj:** Nuk bëhet fjalë për prona publike apo për prona shoqërore, që Iliri po thotë. Është fjala edhe për prona private. Ku do duhej ti epej sinjal komisionit që të punoj për shpronësim. Kjo është kërkesa që Kuvendi duhet ta votoj, që të fillojnë proceduat për shpronësim. Dhe sigurisht që ky komision mandej, apo kryetari i komunës do të filloj negociatat me pronarët aty, kushdo çofshin ata, që të gjejë rrugën e shpronësimit. Sepse bëhet fjalë për një lagje të bllokuar. Dhe kjo është urgjenca që kërkon që Kuvendi të marrë vendim që ti jap sinjal kryetarit të komunës, që të filloj negociatat për shpronësim. Kjo është, andaj nuk di unë çka kemi nevojë me zgjatë. Unë po kërkoj që të votohet dhe ti jepet rruga për gjetjen e mënyrës për me shpronësua. Sepse bëhet fjalë për një lagje të bllokuar atje.

**Alush Shala:** Po edhe në KPF-ca e kemi diskutua këtë problem. Dhe ky problem vërtetë është i ndjeshëm për një numër diku rreth 140 familje më dukët. Por duhet ta marrim edhe ne si problem tonin si organe që jemi kompetente. Unë kam biseduar edhe me drejtorin e Shërbimeve Publike, veç ka dy muaj për këtë çështje. Dhe drejtori më ka premtuar që do të ec në këtë drejtim, dhe do ta gjejmë një zgjidhje. Për ti zgjidhë problemin e shumë familjeve. Nëse është në dorën tonë dhe nëse vota jonë do ta zgjidh këtë problem. Unë personalisht po se po, po ju ftoj të gjithëve që ta votojmë këtë vendim. Andaj zhagitja e këtij vendimi mendoj që do të sjell probleme katastrofale. Sepse, në atë rrugë shpesh herë kemi edhe përplasje fizike, ndërhyrje të policisë. Andaj kolegë të nderuar

edhe juve kryesues, ju kërkoj që urgjentisht dhe në mënyrën më të shpejt të mundshme, duke i respektuar ligjet në fuqi. Dhe duke u marrë me proces, njerëzit kompetent ta zgjidhin këtë problem të kamotshëm.

**Karanfil Haxhillari:** Vetëm dua t'ju informoj se qysh nga shkurti i këtij viti, së bashku me kryetarin kemi trokitur në gjitha dyert e KOST-it për ta zgjidhur këtë problem të kësaj lagje. Pra që nga shkurti jemi injoruar disa herë nga KOST-i. Kemi kërkuar të takohemi disa herë. Dhe atëherë kur u takuam për arsye banale, më të vërtetë banale. Sepse kemi pasur një zgjidhje, e që në qoftë se na kishte lejuar KOST-i në fillim të rrugës tri metra ta largoj murin dhe në fund një metër, që ishte në pyetje diku 120 metër katror. Kjo problematikë as që do të diskutohej këtu. Mirëpo, unë shpresoj insha Allah nuk vjen KOST-i ndonjë herë të bëjmë ndonjë kërkesë që komuna e Prizrenit ti jep vend. Sepse kategorikisht duhet të kundërshtohet. E dimë ne se çka kemi hekur. Dhe tash ne duhet ta shpallim zonë të interesit publik, pastaj ta shpronësojmë. Që më të vërtetë kjo procedurë do të zgjatë. A kemi mund me zgjidhë për disa ditë. Në qoftë se KOST-i të na kishte lejuar atë hapësirë. Vetëm desha të ju informoj që është punua për këtë që nga ditët e para të qeverisjes edhe nga kryetari. Dhe ju sugjeroj që ta votojmë këtë dhe të shpallet zonë e interesit publik.

**Sadije Osaj Jakupi (LDK):** Kryesues më qenë se u tha shumë. Unë vetëm desha të them se është një kohë e gjatë më se dy vite që kjo lagje është e mbyllur. Dhe ti tregojmë pak Ilirit se nuk është e njëjta sikur me atë rastin që e murr për shembull. Sepse këtu ka mbi 200 familje, ka pleq, fëmijë të cilët kalojnë rrugën për të shkua në shkollë. Problemet, rreziku është për çdo minutë. Atëherë pa bërë debate, ta bëjmë ne punën tonë të votojmë, sepse ata janë banorë të komunës tonë.

**Kryesuesi:** Atëherë po shkojmë me deklaratat e shefave të grupeve, në lidhje me këtë kërkesë të shpalljes të interesit publik.

**Simir Krasniqi:** Grupi parlamentar i PDK-së e mbështet këtë kërkesë për shpallje të interesit publik.

**Adem Shabanaj:** Edhe LVV-je e mbështet.

**Haziz Hodaj:** Edhe LDK e mbështet.

**Ilir Baldedaj:** Kryesues, respekto rregulloren, se mu përmend emri, e qova dorën për replikë. Kështu që ja po e respektojmë krejt, ja po i mëshojmë qysh dojmë. Po e akuzojnë opozitën, po kush ju ka ndal deri më sot me pru në rend dite. A ju ka ndal opozita që se keni pru, jo. Ne natyrisht që do ta mbështesim sepse është interes i qytetarëve. Se vërtetë ata edhe ne kur kemi qenë në pushtet, ka qenë ajo problematik. E duhet të bëhemi të singertë. Në



fund të mandatit është bllokuar ajo rrugë dhe nuk jemi marrë me atë çështje, sepse ka qenë fushatë e zgjedhjeve. Dhe është një zgjidhje e mirë kushdo që e ka bo. Është në interes të përgjithshëm të qytetarëve. Sepse secili qytetar ka të drejtë të ketë rrugë dhe qasje në shtëpinë e vetë. Dhe ne si AAK do ta mbështesim dhe do të votojmë për.

**Ganimete Hoxha Babuna:** Edhe Nisma Socialdemokrate e mbështet këtë kërkesë.

**Cengiz Çesko (KDTP):** E mbështesim.

**Azem Durmişi:** Podrža emo.

**Memnuna Ajdini:** Tako e podržavamo ako se ne kosi sa zakonom.

Kryesuesi: Mirë, aktualisht 35 anëtarë jemi në sallë, dhe e hedhim në votim kërkesën për shpallje të interesit publik, me qëllim të shpronësimit dhe ndërtimit të rrugës në lagjen “Gurishta”, kush është për

Atëherë konstatoj se unanimisht me 35 vota për miratohet kërkesa për shpronësimin e pronave të paluajtshme, për ndërtimin e rrugës në lagjen “Gurishtë” në Prizren.

**Pika e tetë:**

**Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2019.**

Siç e dini ju në fillim të këtij mandati, e patëm bërë një grup punues i cili e ka hartua një plan, i cili na ka shërbye si udhërrëfyes për pikat të cilat, kryesisht ose kanë qenë kategori ligjore. Ose kanë qenë kërkesa të drejtorive. Ose kanë qenë pjesët e grupeve parlamentare. Dhe rrjedhimisht pasi po hymë në fundin e vitit. Jemi në periudhën ku duhet ta themelojmë këtë grup që të vazhdoj punën dhe ta hartoj planin e punës për vitin e ardhshëm. Para se me qit në diskutim, ne në KPF, pak shumë u pajtuam dhe rekomandimi i bërë ndaj Kuvendit është që këtë grup ta përbëjnë shefat e grupeve parlamentare dhe anëtarët e KPF-së. Apo vetëm anëtarët e KPF-së. Me cilën formë po shkojmë. Kjo është ideja. Pra nëse jeni të pajtimit po i meshojmë shkurtë kësaj pune. A jeni që ky grup punues të përbëhet nga shefat e grupeve parlamentare dhe anëtarët e KPF-ca. Anëtarët e KPF-së, a!. Atëherë po e hedhim në votim që mandati për këtë grup punues ti kaloj KPF-së. Dhe partitë që s’janë të

përfaqësuar aty ta dërgojnë një përfaqësues. Atëherë e hedh në votim, kush është për?

Për? – 35.

Kundër? – 1.

Abstenim? – S'ka.

Atëherë konstatoj se me 35 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim, themelohet grupi punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit.

**Pika e nëntë:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-buxhetit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2019 dhe parashikimi për vitin 2020 dhe për vitin 2021.**

**Ertan Simitçi, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa:** Në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Financa Lokale dhe Ligji mbi menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë dhe duke u bazuar në qarkoren gjegjëse për Ministrinë e Financave dhe Korniza afatmesme e buxhetit për vitin 2019-2021. Është hartua propozimi përfundimtarë i buxhetit komunal për vitin 2019-2021. Të cilin kryetari pas shqyrtimi i propozon KPF-së dhe asamblesë komunale për miratimin final në afatin e paraparë me ligj. Buxheti komunal përbëhet prej tre grandeve: Grandi i përgjithshëm për Administratë. Grandi specifik për Arsim. Dhe grandit specifik për Shëndetësi. Nga buxheti qendrorë i Kosovës për vitin 2019 parashikohet një grand prej 38.713.066 € Nga grandit i buxhetit të Kosovës në total buxheti komunal merr pjesë rreth 82%. Burimi i dytë kryesor i buxhetit komunal, janë të hyrat vetjake që mblidhen nga tatimi në pronë. Taksat dhe ngarkesat e ndryshme. Gjobat në trafik dhe të hyrat që realizohet nga shëndetësia primare dhe në arsim. Për vitin fiskal 2019, parashikohet që këto të hyra të arrijnë shumë prej 8.700.000 € që është 7% në krahasim me vitin 2018. Të hyrat vetjake komunale marrin pjesë me 18% në buxhetin komunal. Totali i buxhetit komunal për vitin fiskal 2019 është 47.330.460 € Ka një rritje prej 7% në krahasim me buxhetin e planifikuar të vitit 2018. Planifikimi i buxhetit komunal sipas kornizës afatmesme do të jetë për vitin 2020, 49.100.000 € Për vitin 2021 është 51.000.000 € Planifikimi i shpenzimeve për buxhetin komunal të komunës së Prizrenit, në kategorinë e pagave është rreth 20.251.729 € Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 6.723.217 € Në shërbime komunale 1.091.199 € Në kategorinë e subvencioneve 600.000 € Në shpenzimet kapitale 18.674.315 €. Ne si qeveri lokale i kemi mbajtur disa takime edhe para miratimit të kornizës afatmesme.

Por edhe pas qarkores kur e kemi pranuar nga Ministria e Financave. Dhe e kemi hartuar një buxhet i cili do të jetë në interesin e komunës, dhe në interesin e qytetareve. Drejtoria e Financave i ka marrë parasysh të gjitha kriteret e qarkores së dytë dhe të parë. Rekomandimet e auditorit të përgjithshëm, që veçanërisht në këtë fazë e kemi marrë parasysh procesin e keq klasifikimeve. Si shembull në Drejtorinë e Bujqësisë, në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Drejtorinë së Kulturës dhe të tjerë. Që i kemi pasur disa projekte apo disa probleme që kanë qenë. Me këtë projektbuxhet e kemi rregulluar këtë çështje. Normal që komuna e Prizrenit ka një buxhet të kufizuar. Dhe të gjitha kërkesat apo problemet ne nuk kemi mundur në këtë afat ti rregullojmë. Por sipas planit të veprimit, e kemi implementimin e rekomandimeve të auditorit. Sipas kornizës afatmesme do të planifikojmë që brenda këtyre tri viteve të rregullojmë këtë problemin. Në anën tjetër që i kemi mbajtur disa takime edhe me kryetarin por edhe me drejtorë të ndryshëm. Cilat janë projektet e reja i kemi marrë parasysh që planifikimi të jetë i saktë. Të analizuar nga drejtoritë përkatëse dhe të fillojmë prej sivjet të hartojmë projekte apo ato programe që janë. Që vitin e ardhshëm komuna e Prizrenit, apo drejtoria përkatëse mos me humb kohë. Edhe të zhvillimi i procedurave të tenderimit. Por të hartimit të projekteve. Një ndryshim tjetër lidhur me hartimin e projekteve është planifikuar në Drejtorinë e Urbanizimit, që kjo drejtori ti shërbejë të gjithë drejtorëve lidhur me hartimet e projekteve. Dhe po besojmë që komuna e Prizrenit me këtë proces do të eliminoj shumë probleme burokratike dhe procedurat e prokurimit do të eliminohet. Drejtoria e Shërbimeve Publike i ka marrë hapat konkrete që të centralizoj projektet të cilat janë: Rregullimi i rrugëve, asfaltime, kanalizime në qytet. Të gjitha këto projektet do të centralizohen me një kod, i cili do të ketë një sukses në realizim, në zbatim të projekteve. Për shkak se e dimë të gjithë se ne kemi pasur shumë projekte brenda qytetit që janë për emërtime të rrugëve apo të lagjeve. Tani në vijim kemi pasur probleme edhe në procedurat e prokurimit. Por edhe të pagesa e thesarit. Edhe kemi pasur probleme të procedurat e tenderimit. Për shkak se e dini edhe ju është ai procesi i ankesave. Edhe kur po vjen puna Drejtoria e Shërbimeve Publike për me realizua një projekt, po ballafaqohet me probleme të ndryshme. Këtu ka qenë qëllimi që të eliminohen ngarkesat procedurale dhe shërbimi do të kryhet sa më shpejtë edhe nën kontrollin apo nënë mbikëqyrjen e drejtorisë. Komuna e Prizrenit në këtë proces ka mbajtur nëntë dëgjime publike. Disa drejtori kanë mbajtur me target grupet, apo me grupet editues. Kryetari ka mbajtur takime në rajon edhe një takim këtu me qytetarët këtu të përgjithshëm. Dhe të gjitha kërkesat që kanë të realizuara dhe primare, janë futur në këtë propozimbuxhet. E dini edhe ju që vitin e kaluar kemi pasur shumë kërkesa në kategorinë e subvencioneve. Ne si komunë e Prizrenit me kornizën afatmesme

kemi kërkuar rreth 970.000 € nga Ministria e Financave që të rritet kategoria e subvencioneve. Por me qarkoren e dytë nuk është bo njëfarë përmirësim. Por në krahasim me vitin 2018 në vitin 2019 do të kemi 600.000 € kategorinë e subvencioneve. Sipas propozimbuxhetit Drejtoria e Kulturës, do të ketë 180.000 € Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale 120.000 € Drejtoria e Shëndetësisë 70.000 € Drejtoria e Bujqësisë 62.000 € Drejtoria e Arsimit 40.000 € Zyra e kryetarit 40.000 € Drejtoria e Shërbimeve Publike 28.000 € Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit 20.000 € Zyra e komuniteteve 20.000 € Administrata lokale apo komunale 11.000 € Dhe Drejtoria e Emergjencës 10.000 € Në kategorinë e investimeve kapitale Drejtoria e Shërbimeve Publike 8.900.000 € Drejtoria e Arsimit 1.800.000 € Drejtoria e Bujqësisë 1.200.000 € Drejtoria e Shëndetësisë 1.100.000 € Drejtoria e Turizmit 1.100.000 € Drejtoria e Planifikimit dhe Urbanizmit 765.000 € Drejtoria e Administratës 600.000 € Emergjencia 36.865 € Drejtoria Për Buxhet dhe Financa 328.376 € Zyra e komuniteteve 90.000 € Drejtoria e Inspektoratit 85.000 € Dhe Drejtoria e Kadastrit 68.000 € Sipas një analizës të Drejtorisë për Financa, investimi në vitin 2019 do të ketë më së shumti në programe apo në projekte të ujit të pijes. Rreth 845.000 € do të kemi investim në vitin e ardhshëm. Projektet e infrastrukturës rrugore 4.453.072 € Mirëmbajtja e investimeve kapitale 1.290.000 € Ndriçim publik 410.000 € Projektet zhvillimore në sektorin e bujqësisë 450.000 € Projektet në vazhdim të cilat janë për ndërtimin e shkollave 580.995 € Në shërbimet administrative 580.000 € Ndërtimi i banesave sociale 765.000 € Hartimi i projekteve për nevojat e komunës 240.000 € Dhe në projektet për zhvillim ekonomik 7.550 € Komuna e Prizrenit faktikisht edhe Drejtoria e Financave në bazë ligjeve në fuqi që janë i kemi përgatitur të gjitha proceset. Dhe sipas ligjit me 30 shtator të miratohet nga Kuvendi i komunës. Komuna e Prizrenit ka pasur shumë kërkesa nga qytetarët. Por prioritetet, nevojat dhe programi i qeverisjes lokale do të ketë primare dhe në kornizën afatmesme do të mundohemi të realizojmë në punë të mirë, në interesin e të gjithë qytetarëve. Prandaj si drejtor i Drejtorisë së Financave i propozoj Kuvendit dhe të gjithë anëtarët e Kuvendit të votojnë dhe të aprovojnë këtë propozimbuxhet.

**Mytaher Haskuka, kryetar i Komunës:** Kërkoj falje që sot nuk isha më herët, po kisha një delegacion nga BE-ja në komunën e Prizrenit, së bashku me deputetet e Kuvendit të Kosovës. Të cilët i pritëm bashkërisht dhe besoj që ka qenë një pritje e mirë në prezantimin e Prizrenit dhe Kosovës në përgjithësi. 30 deputet nga Parlamenti Evropian kanë përshtypje të mira për Kosovë, që ndoshta do të ndikoj pozitivisht edhe në realizimin e vizave. Unë publikisht dua ti falënderoj të gjithë deputet të cilët kanë qenë në takim. E kemi pas një

konsensus të përgjithshëm në aspektin e prezantimit të Prizrenit dhe të Kosovës. Përndryshe uroj edhe festën e boshnjakëve të Kosovës, të gjithë komunitetit boshnjak në Prizren. Në aspektin e buxhetit, vetëm desha të ju informoj që kemi pas diku rreth dhjet dëgjime publike. Po edhe pas orarit të punës kemi pas takime me qytetarë. Shumica e drejtorëve kanë pasur takime me grupe të interesit në të gjitha drejtoritë për të përcaktuar projektet prioritere për vitin e ardhshëm. Si tha drejtori ne kemi pasur për qëllim që subvencione ti rrisim. Kemi bo kërkesën në Ministrinë e Financave nga se Prizreni si qytet i dytë në Kosovës edhe me numrin e popullatës i përket që të ketë së paku 1.000.000 € në kategorinë e subvencioneve. E cila është një kategori që na duhet shumë për shkak prezencës së madhe të shoqërisë civile në Prizren. Dhe punës që bëjnë ata në sektorët e ndryshëm nga sindrom dawn, autizmi, me nevoja të veçanta, sport e kulturë. Buxheti i aprovuar për subvencione është 600.000 € dhe këto është dashtë me i nda në drejtoritë përkatëse sipas nevojave. Në aspektin e përgjithshëm unë mundem me thënë se buxheti, ne jemi munduar pos vërejtjeve, kërkesave të grupeve të interesit dhe qytetarëve nëpër dëgjime të ndryshme të komunës së Prizrenit. Jemi munduar ti marrim parasysh edhe rekomandimet dhe vërejtjet e auditorit, në buxhetet e kaluara. Sidomos për keq klasifikimet e caktuara. Por janë do raste se s'kemi mund mi aprovua të gjitha për shkak të mungesës së subvencioneve. Nëse shikojmë drejt, unë e bëra një krahasim në Prishtinë diku janë subvencionet rreth 1.600.000 € Kurse Prizreni i ka rreth 20.000 banor më pak. Po jemi vetëm 30% e subvencioneve që e ka Prishtina. Po besoj që na mbetet të gjithëve neve që të llojmë në të ardhmen që kategoria e subvencioneve të rritet. Dhe se është në të mirën e qytetarëve të komunës. Po ashtu edhe në aspektin e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Unë mendoj që duhet më shumë. Nga se faza kur janë bërë investimet kapitale normal ka kaluar. Tani duhet që ti mirëmbajmë këto investime, si në shkollë, si në shtëpi të kulturës, ose ambulanca të cilat janë prezentë në komunën e Prizrenit. Edhe në atë aspekt për këtë kategori duhet të rriten të ardhurat. Po me atë qysh i kemi pas paramasat jemi munduar ta ndajmë sa më mirë buxhetin. Edhe në atë aspekt një dallim ndoshta më përpara. Jemi munduar që të mos ketë projekte të vogla. Që pastaj nuk po munden me u realizua për shkak se paraprakisht nuk po dihet vlera e tyre totale. Ku faktikisht në do projekte po na mbesin fonde. Kurse në disa projekte tjera po na mungojnë fondet. Hartimi i projekteve është koncentruar në një vijë buxhetore dhe do të bëhet hartimi i projekteve për të gjitha kërkesat e komunës për një vijë buxhetore, e cila do të jetë në Drejtorinë e Urbanizmit. Në antenën tjetër shpronësimet po ashtu janë kategorizua me një vend dhe janë. Sipas rekomandimeve të auditorit janë caktuar në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financa për shpronësimet që i ka komuna. Po ashtu në bazë të rekomandimit të auditorit jemi munduar që

projektet të cilat kanë të bëjnë me ujësjellësin me kanalizimet me shtrimin e kupëzave ose asfaltit, të koncentrohen. Pos me rastet ku pas projekte të përbashkëta. Edhe pastaj në bazë të kërkesave, tanimë janë faktikisht kërkesat e marra. Do të bëhet analiza dhe pastaj gjatë vitit do të punohen të gjitha fshatrat dhe lagjet e qytetit. Në këtë aspekt e kemi pas një debat shumë të gjatë edhe nëpër dëgjimet publike por edhe në takime të veçanta. Edhe në atë aspekt shpresoj që buxheti do të kalohet. Edhe në të njëjtën kohë dua të theksoj që po ashtu një nga qëllimet ka qenë, që të mundohemi të gjejmë fusha ku investimet do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Do më thënë edhe në atë aspekt nga turizmi, bujqësia dhe ndërtimi i zonës së re ekonomike. Edhe fushat tjera. Ku besoj që çdo investim i cili do të bëhet nga komuna e Prizrenit do të kthehet me të ardhura më të mëdha edhe me një prosperitet për qytetarët e komunës së Prizrenit. Prandaj i falënderoj të gjithë ata që kanë marrë pjesë në hartimin e projektbuxhetit. Edhe drejtorinë, të gjithë drejtorët po edhe asamblistët dhe qytetarët të cilët kanë marrë pjesë në debatet publike. Shpresoj që të kemi një debat të mirë edhe votim të buxhetit.

**Ilir Baldedaj:** Së pari buxheti i këtij ekzekutivi lënë për të dëshiruar. Sepse vërtetë nuk ka ndonjë ndryshim esencial nga ata buxhetet të cilët edhe Artani me një debat edhe z. Hodaj bajagi kanë pas bërë zhurmë. Që nuk do të ketë projekte të vazhdueshme të cilat do të shkojnë në pafundësi. Nëse se ke lexua z. Hodaj, deri sa të kryej mundesh me e lexua dhe i sheh, edhe Artan Abrashi. Sepse janë pothuajse gati të gjitha të njëjta. Për shembull po e shoh një rrugë Dobrusht-Has 10.000 € Më tregoni ju të dy çka mundeni me bo me 10.000 € me një rrugë Dobrush-Has. Pyetje për Drejtorin e Administratës. Një kod të ri drejtor të ri drejtor e ke, po nuk ceket ku gjendjet. Thotë ndërtimi i gjendjes civile dhe nuk ceket lokacioni. Ndërsa një tjetër e ke ndërtimi i gjendjes civile në Mushnikovë. Apo ndoshta janë përsëritë. Unë po flas me këtë material që e kam marrë drejtor, në email zyrtar është që ky material. Dhe thotë ndërtimi i një gjendjes civile dhe nuk ceket. Pastaj te ndërtimi i gjendjes civile në Mushnikovë është projekt tjetër. Pastaj shkojmë me rend. Unë propozoj te zhvillimi i projekteve kapitale MPP-në të rritet, se është edhe në dobi të komunës të ketë rritje. Mirëmbajtja dhe renovimi i rrugëve, shtrirje zhavorr, kërkoj sqarim se vërtetë shuma është 900.000 €, çka nënkupton te kjo mirëmbajtja. Sepse ne e dimë që më herët ka qenë veç rrugë kryesore, ndërsa fshatrat nuk kanë qenë. A është paraparë edhe për fshatrat, pastrimi dimrit edhe mirëmbajtja e tyre. Nëse jo është mirë mu paraparë sepse janë 900.000 € vlerë. Kodi ndërtimi i infrastrukturës rruga “Jeronim Derada” Tabakhane. Është mirë që aty të planifikohet edhe ndërtimi i kolektorit për ujërat e zeza. Sepse në këtë pjesën këndeje është krye. Dhe është mirë pjesa e Shatërvanit që e përfshinë deri

atje. Edhe aty të jetë një projekt sepse vërtetë ka nevojë për atë çështje. Sepse kanalizimi kalon edhe sot në pjesën e Lumëbardhit. Pyetje për drejtorin e Bujqësisë. Tregu lëvizës, çka nënkuptojmë me këtë treg lëvizës drejtor ku 70.000 € janë të parapara. Ndërtimi i urës në fshatin Krushë e Vogël-Breg Dri 20.000 € drejtor, as hartim projekti nuk dalin se lëre më një ndërtim të një ure siç është ajo e paraparë, që është bajagi urë e gjatë. Por unë po e shoh që është tendencë të këtij pushteti, që fshatrat e Hasit mos të kenë shumë mjete të parapara nga ky buxhet. Sepse ne e dimë që kanë kaluar keq me vota. E tash me këtë formë. Po më befasojnë kuvendarët e Hasit që qëndrojnë në pjesën e pushtetit. Për shembull e kemi Kujtesën ku në fshatin që është pjesë e Kushninit, lagjja e Murselajve është heq kanalizimi. Dhe kjo vërtetë është shqetësuese sepse nuk bëhet politikë duke seleksionuar qytetarin pse nuk të ka votua. Keni akuzua vazhdimisht kur keni qenë në pushtet se është buxhet i asfaltit i kupëzave. Veç sa i keni rritë, asnjë element të zvogëlimit apo ndarjes të buxhetit nuk e keni bo, po veç sa është rrit. Përkundrazi veç jeni mundua me shtua kode të reja, për mi përmbush apetitet e koalicionit që ndoshta edhe e kuptoj që ju kanë kushtëzua edhe me votë. Ndërtimi i ndriçimit publik, shuma është 400.000 € Unë besoj që shumica edhe e fshatrave edhe e qytetit e kanë ndriçimin publik. Vërtetë është një shumë bajagi e lartë. Shtimi i kapacitetit të ujit të pijes, i ke katër pozicione drejtor. Me Radoniçin 130.000 € Pastaj i ke 200.000 € Është mirë ky shtim i ujit të pijshëm. Sepse e kemi provua me Hidroregjionin disa herë. Unë atëherë kur kam qenë e kam pas nisur iniciativën për Lubizhdën e Hasit, mu lidh me Radoniçin. Dhe shumë prej tyre kanë pas thënë se nuk ndodh ajo. Po sot ata qytetarë kanë uji nga Radoniçi. Me fabrikën e re Radoniçi është i gatshëm me furnizua me ujë Suharekën Prizrenin dhe Malishevën. Unë kisha kërkuar që të gjitha ato mjete që i keni paraparë për ujë, ti qitni me një kod buxhetor dhe të kontaktoni me Radoniçin. Sepse vërtetë është turp hala të flitet për mungesë të ujit të pijshëm. Për shembull në atë projekt është i paraparë edhe Gjonaj mu furnizua me Radoniçin. Vazhdimisht Hazizi veshët na ka qit në tok katër vjet pa ujë. Dhe sot prapë e ke në të njëjtin pozicion. Është mirë ti kanalizoni, sepse të njëjtët projekte ka dy tri linja buxhetor. Kur flitet për ujë. Ai ujë është ujë. Si i Radoniçit, si i Hidroregjionit është i njëjti. E përmenda rrugën 10.000 € në Dobrusht. Bashkëfinancimi me Ministrinë dhe donatorët e tjerë është mirë të rritën, sepse është 50.000 € është mirë të rritën sepse ka mundësi më shumë të merren fonde. Po tash drejtor ose ju jeni të pa qartë ose ekonomia e financave, ose sektori i shërbimit të administratës. Unë këtë dokument nuk e kam marrë në shtëpinë time. Më ka ardhur në email zyrtarë dhe unë po flas në bazë të dokumentit që na keni servua ju. Besoj atë dallim një nxënësi i shkollës fillore mundem me bo. Ndërtimi i tregut mobil e ceka pak më herët drejtorit të bujqësisë. Ndërtimi i strehimores

për qentë endacak drejtor. Ne e dimë dhe na tregoni si do ta menaxhoni atë, apo ndoshta është gabim. Sepse ndërtimi strehimores për qentë endacak besoj që jo vetëm 70.000 € Besoj që ajo 70.000 € ju shkon veç për tender njëvjeçar për mirëmbajtjen se lëre më për ndërtimin e asaj qendre strehimore. Ndërtimi i qendrës së re në shëndetësi, nuk ceket emri drejtor. Një është në Romaj, po në këtë tjetrën nuk ka emër. Na tregoni ku është.

**Haziz Hodaj:** Nuk po di më thënë a është keq a është mirë që më ra menjëherë pas Ilirit me fol. Singerisht jam i motivuar me fol por edhe po mi pret do sende. Kur flitet për infrastrukturën në Has. Pak përpara e mora një mesazh, më tha a dini ti najë herë me fol për Has, më shkroi një Hasjan. Në anën tjetër ti po thua ti, na i ke qit veshët duke fol për Has. Kështu që unë nuk po e mohoj as që jam Hasjan, as që jam anëtar i Kuvendit. Por unë nuk jam aq lokalist që të përqendrohem vetëm në Has. Sepse jam anëtar i Kuvendit edhe përfaqësoj edhe interesa edhe të qytetarëve të tjerë të Prizrenit. Sigurisht që vijë nga Hasi edhe barrën kryesore e barti atje. Mirëpo pasi je ti në opozitë edhe je në mes të Hasit, në Dedaj aty ku është midisi i Hasit. Ti reflekton në të gjitha anët edhe nuk e kam problem se ka me pas shumë investime. Singerisht po ju them unë jam votues i shumë projekteve, se jam anëtarë i Kuvendit prej fillim. Edhe ka pas rast kur kemi votua buxhet edhe nuk është realizua as për së afërmi ajo votë që e kemi pas dhënë. Na mashtraj njëherë Nijazi Kryeziu, kryesuesi jarani jem, se do të thoshte Shukri Quni daja jem, e ke pas jaran Nijazin, është e vërtetë. Të gjitha kërkesat që i patëm opozita i futi në projektbuxhet në pozicione buxhetore, të gjitha. Që të gjitha kërkesat. Dhe na qiti para aktit të kryer, u deshtë me votua buxhetin, e votuam. E tash më thoni a është realizua. As 90% e atyre projekteve nuk janë realizua. Mirëpo ai e përdori mjeshtërinë e vetë dhe na qiti para aktit të kryer për me votua buxhetin. Kështu që z. Kryetar jeni para një sprove. Sepse deri më tani keni punua me një buxhet, që unë kam quajt puro elektoral të vitit të kaluar. Sepse jeni detyruar të punoni, sepse e keni pas votën e këtij Kuvendi edhe jeni detyrua të punoni. Sigurisht që ka pas probleme për me realizua këtë projektbuxhet. Sepse ka pas pozicione buxhetore që kanë kushtua po e zëmë me mijëra euro e janë caktua një shumë e vogël, që ka qenë e porealizueshme, faktikisht që në start. Po tani po e shoh se edhe gjatë debateve publik. Po edhe në shikim të saj, është bërë një prerje po jo klasike e prerjes. Se nuk mund të shkëputesh nga ajo formë e hartimit të buxhetit. Sepse janë projektet në vazhdim dhe nuk mund të bëjmë shkëputje klasike, për hartua një buxhet tjetër çfarë do të dëshironim. Mirëpo ka kode buxhetore, ku do ta gjej secili nga ne vetën për investime të gjitha kërkesave të qytetarëve, qoftë infrastrukturë, qoftë kulturë, qoftë rini, qoftë sport etj. etj. Andaj unë po ju lus, pozita me sy qel, po opozita le ti mshel sytë edhe le ta votoj këtë buxhet. Dhe ta



ruajmë për fjale kryetarin e komunës edhe ekzekutivin që për me hartua këtë buxhet. Dhe ti rrimë hazër a po realizohet ky buxhet. Për mua është shumë e rëndësishme a do të realizohet ky buxhet. Sepse kjo është ajo do të shihet nesër në terren. Përndryshe nëse e votojmë një buxhet edhe nëse i plotësojmë të gjitha kërkesat e qytetarëve që kemi pas në debate publike. Po edhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit këtu. Secili nga ne i ka nga dhjetë projekte edhe do tu bëheshin 400 projekte. Edhe mundemi mi qitë në letër edhe me ja plotësuar të gjithëve dëshirën. Mirëpo i porealizueshëm paraprakisht është. Kështu që mendoj që duhet me u reduktua ajo formë. Kështu që vitin e ardhshëm do të jetë edhe më konkret edhe më i realizueshëm edhe më i zbatueshëm. Prandaj po kërkojmë që të kaloj ky buxhet. Dhe mandej edhe unë si pjesë e koalicionit qeveritarë, po e mbaj për fjale kryetarin për realizimin e këtij buxheti. Andaj kërkoj nga grupi im që ta votoj këtë projektbuxhet, po kërkoj edhe prej jush.

**Ilir Baldedaj:** Z. Hodaj secili jep llogari për vetveten. Por sinqerisht nuk kisha dashtë me qenë në lëkuren tënde sot. Sepse të mos e kesh asnjë projekt nga regjioni nga i cili vjen dhe i ke marrë votën. Dhe për katër vjet krejt zhurmën e ke bo për atë Gjonaj, Gjonaj, Gjonaj. Atëherë s'paske qenë kuvendarë i gjithë kuvendar i gjithë qytetarëve, paske qenë veç i Gjonajve. Edhe sot tash po mundohesh me na shit moral politik, ne të gjithë e dimë kuvendarë të qytetit të Prizrenit jemi. Po natyrisht që kemi obligim më shumë ndaj atyre që e kemi marrë votën. Po ky diskriminim sidomos regjionit të Hasit që i është bo me këtë buxhet. Ndoshta nuk është më e rendë, që ai sistemi i kaluar që ka shkua për Beograd, e ka lënë pa asfalt pa kurrëgjë. Dhe ju, ky pushtet e ka lënë më zi se ai.

**Haziz Hodaj:** Jo, jo veç po i them se, që lëkura ime nuk i bjen tamam Ilirit, kaç.

**Dafina Bllaca:** Atëherë në kërkesën e juaj që Hodaj, për ta mbështet këtë buxhet. Ndoshta kryesuesi kishte me na mbush mendjen edhe neve si Nijazia dikur juve. Ndoshta me na i fut ato kërkesat tona me një projekt, ndoshta kishim me votua. Dua të fokusohem te Drejtorja e Bujqësisë. Ku duke u bazuar se pjesa dërmuese e qytetarëve të komunës së Prizrenit merret me bujqësi. Shuma e planifikuar, nuk është e mjaftueshme për këtë sektor. Madje kjo shumë nuk mund ti del në ndihmë dhe të mjaftueshëm këtë sektor, karshi kërkesave dhe nevojave të tyre rreth punës që bëjnë këta individ. Përveç kësaj kërkoj nga Kuvendi komunal të hap një zyrë për hartimin e plan projekteve në sektorin e bujqësisë. Kërkesa ime rreth kësaj çështje, nuk është e rastësishme. Sepse kjo vjen si rezultat i shumë bisedave me bujqit. Të cilët kanë shprehur shqetësimin e tyre që nuk po arrijnë të përfitojnë benificonet apo garantët nga Kuvendi

komunal, apo Ministria e Bujqësisë. Për shkak të mungesës së projekteve që u kërkohet atyre. Duke e ditur ndoshta që të gjithë bujqit kanë mundësi profesionale të hartojnë një plan, një projekt të tillë. Mendoj që ne si Kuvend komunal duhet të analizojmë mundësinë e funksionalizimit të një zyre për hartimin e plan projekteve të sektorit të bujqësisë, duke punësuar njerëz profesionist të kësaj lëmaje. Për kërkesë kërkoj nga drejtori i Bujqësisë të na informoj në seancën e ardhshme apo edhe me shkrim rreth mundësisë së kësaj, e cila vërtetë kjo zyre do të ishte në dobi të bujqve të cilët për një plan projekt paguajnë nga 300 deri në 500 € Kjo zyrë do të mund të ofronte shërbime më shuma më simbolike. Ndërsa së i përket investimeve kapitale në infrastrukturë, unë shumë herë e kam ngritë zërin. Edhe sinqerisht nuk do të pushoj në këtë Kuvend. Sepse më të vërtetë lagja Arbanë në gjendje të mjerueshme. E cila është lënë ndoshta edhe nga qeveritë e kaluar po shihet që do të vazhdoj ajo traditë. Ku shuma e planifikuar nuk mund të mbuloj as 10% të nevojave të qytetarëve të kësaj lagje. Pasi se dihet se kjo lagje numëron diku arë 20.000 banor. Ku brenda vetë lagjes janë duke u formuar edhe lagje të reja. Siç është Beteja e Pashtrikut dhe Jeta e re. Kur për shkak të ardhjes së banorëve të ri, kemi çdo herë e më shumë shtëpi që ndërtohen aty dhe rrugët janë të mjerueshme. Unë që nga fillimi i mandatit tim si kuvendare e kam shprehur shqetësimet e këtyre banorëve. Pasi se çdo ditë i shoh edhe vetë nga afër mungesën e kushteve elementare për jetesë të mirëfilltë. Të cilëve u mungojnë burimi kryesor për jetesë. Siç është uji i pijes, rrugët e paasfaltuara, rrugët pa ndriçim dhe pa kanalizim. Kërkoj që shuma e dedikuar prej 100.000 € të rritet të paktën të dyfishohet. Që sado pak të kemi një jetë më të mirë për qytetarët e lagjes Arbanë. Qoftë nevoja nëse nuk bëhet kjo, atëherë po dalim në protesta po e bllokojmë rrugën për Gjakovë. Edhe ndoshta dikur realizohet këto kërkesa të lagjes Arbanë. Nuk ka mbete zgjidhje tjetër sinqerisht.

**Kryesuesi:** Meqë zonja Bllaca u përmendën protestat, nesër është një dhe je e mirëseardhur.

**Sadije Osaj Jakupi:** Meqenëse i takoj fushës së arsimit, unë do të ndalesha njëherë tek Drejtorja e Arsimit. Ne si LDK vazhdimisht kemi kritikuar zhvillimin e projekteve në faza dhe bëjnë të njëjtin gabim. Ku shkollat që janë nisur që katër apo pesë vite, ndajnë vetëm pak buxhet dhe atë kryesisht prej grandeve. Kurse komuna nuk participin në asnjë mjet të sajë, për të finalizua këto projekte, siç është rasti me shkollën “Dy Dëshmorët” në Piranë. E kemi këtu në faqen, ku është cekur Drejtorja e Arsimit, projektet. Pastaj “Bajram Curri” Lukinë Has. “Dëshmorët e Kabashit” Korishë. “Ekrem Rexha” Gënçar, DKA etj. Ndërsa do të ishte më e rrugës që këto projekte të përfundoheshin dhe tek atëherë të investohej në projekte të reja, siç i kemi në këto tabelat të dhëna.

Rasti është në shkollën “Dëshmorët e Vrrinit” Billushë. Në mënyrë që projektet që janë të nisura të kryhen. Ato janë të ndara në fshatin Billushë 206.184 € Për shkak të numri të madh të nxënësve, nxënësit presin hapësirat e tyre shkollore. Ndërsa investimet bëhen më shumti ku ka numër më të vogël të nxënësve. Janë në tabela, po i kam bërë edhe krahasimet në qoftë se ka nevojë të thuhet. E thash edhe në fillim shkolla “Dëshmorët e Vrrnit” Billushë, me këtë buxhet 206.000 € Ku ka mundësi të destinohen dhe të përfundohen objekte të tjera të cilat janë të nisura ndër vite. Përpara nesh është sjellë këtu plani zhvillimor i arsimit i komunës së Prizrenit, që ky plan është miratuar në asamblenë e kaluar nga vetë ju, si dhe jeni hartues. Më sa shoh unë kemi planin përpara është i vitit 2017-2021. Mendoj që projektbuxheti i vitit 2019-2021 duhet të jetë në harmoni me këtë plan zhvillimor. Dhe që i njëjti obligon që shpërndarja e buxhetit për investime kapitale të jetë në harmoni më të. Në planin zhvillimor të arsimit 2017-2021, ka edhe pozicione që janë menduar në ngritjen e cilësisë. Ndërsa në projektbuxhetin e vitit 2019, nuk e shoh as të vetmin cent të dhënë për ngritjen e cilësisë, e që është objektiv kryesor i MASHT-të. Nga e cila parti vjen edhe vetë drejtori i DKA-së. Prandaj para nesh është dilema, si e ka menduar DKA e komunës së Prizrenit, të realizoj këtë objektiv pa asnjë planifikim buxhetor, sipas planit zhvillimor, ku janë planifikuar buxhet në pesë fusha të cilësisë. Që buron nga kurrikula për zhvillimin e arsimit në Kosovë, me buxhet prej 960.000 € për ngritje të cilësisë. Këtu e kemi edhe tabelën, nëse kam mendim të gabuar. Atëherë apeloj që të shfuqizohet plani zhvillimor. Ku vetë e keni miratuar në Asamble dhe vetë jeni hartues të këtij plani. Edhe një pikë sa e shfletova buxhetin. Në asnjë drejtori nuk pash sidomos në Drejtorinë e Administratës, ku graviton zyra për barazi gjinore. Nuk gjeta asnjë projekt për barazi gjinore. Ngritjen e kapaciteteve të grave në institucione publike. Ose thjesht projekte përkrahëse me tematika të ngjashme. Pavarësisht kërkesave të mija të vazhdueshme që i kemi bërë deri më tani dhe grupit joformal grave këshilltare, për këto projekte avancuese të grave. Andaj lë pah në dyshim se buxheti duhet votuar. Po besoj me këto ndryshime. Ne kemi rregullore me prioritetet tona. Andaj kërkojmë nga ju përkrahje, sikur grupi joformal i grave.

**Simir Krasniqi:** Unë personalisht vërejtjet e mija që i kam do ti paraqes, për me pas një buxhet sa më transparent dhe më funksional. Ky është qëllimi im me ato vërejtje që do ti jap. Mirëpo i kam edhe disa qëllime konkrete. Mirëpo përkundër këtij qëllimi të mirë dhe grupit tim. Vërejtjet dhe sugjerimet tona gati se nuk janë përfshi në këtë projektbuxhet, ku ende ka mundësi që të rregulloret. Kështu që nuk do ta votojmë këtë buxhet. Pse nuk do ta votojmë! Ky projektbuxhet nuk i përmbush aspak kërkesat tona si kuvendarë. Ka zona dhe territore që nuk janë prek fare për investime. Qoftë të infrastrukturës, qoftë në investime tjera. Unë mendoj që buxheti nuk është gjithëpërfshirës dhe

profesional. Projektet nga Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit dhe komunës së Prizrenit me bashkëfinancim nga komuna, ku janë ndarë mjete shumë pak në këto projekte, siç janë: Pishina Olimprike në Prizren. Stadiumi i Qytetit “Përparim Thaçi”. Ndërtimi i stadiumit në Zhur, ku keni ndarë një shumë, shumë të vogël. Komplekset sportive “11 Marsi”. Qendra kulturore Ebreike në Prizren. Kompleksi sportiv në Nashec. Qendra rinore për asamble të qytetit. Stadiumi në Gjonaj. Haziz s’qenka këtu që mi tregua. Ku ka mundësi që këto investime të humbin nga mos ndarja e buxhetit nga komuna e Prizrenit. Ku Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka ndarë mjete të nevojshme për këto projekte. Shumë pozicione të grupuara në një vend, p.sh pozicioni i parë që është publikuar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Ndërtimi i projekteve infrastrukturore, rrugë, kanalizim, mure mbrojtëse, ura, ujësjellës 400.000 € Duhet mu precizua për çka, ku, në cilën lagje në cilën rrugë. Këtu është fut krejt në një vend. Pozicionet që janë përmend në ndërtimin e infrastrukturës, ndërtimin e rrugës së vjetër Tusus-Hoçë e Qytetit. Dhe ndërtimi i dy urave në fshatin Hoçë e Qytetit, me mjete të ndara 20.000 € Nuk e di se si e kanë menduar që përveç rrugës Tusus- Hoçë e Qytetit dhe dy ura të ndërtohen me këtë kosto 20.000 € Ndoshta edhe projekti më shumë do të ishte bo. Se jo ndërtimi i këtyre dhe rregullimi i këtyre rrugëve. Përveç këtyre, p.sh. kemi edhe projekte tjera. Në ndarjen shumë të vogël për kabinetet shkollore 100.000 € Cilat kabinete, dhe sa kabinete mund të ndërtohen me këtë shumë kaq të vogël të mjeteve. Ku ju kryetar në premtimin elektorale, keni thënë që do ti pajisim të gjitha shkollat e komunës së Prizrenit me kabinete. Përveç mësimit teorik të zhvillohet edhe mesmi praktik. Si mund të pajisen kabinetet me 100.000 € Që tri, katër shkolla nuk mund të pajisen me këtë shumë që keni ndarë. Përveç këtyre kemi edhe furnizimin e gjitha shkollave dhe ndërrimin e kaldajave 100.000 € ku kjo shumë, mund të jetë shumë e vogël. Kur dihet se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka marrë vendim që në të gjitha institucionet shkollore të gjitha kaldajat me thëngjill të zëvendësohen me dru, pelet dhe naftë, për zvogëlimin e ndotjes. Rregullimin e shtratit të Lumëbardhit. Edhe këtu pra nuk e di pse nuk ka filluar ky projekt. Në qoftë se nuk ka filluar kemi një shumë të vogël të ndarë të mjeteve për vitin 2019. Ju kryetar në premtimet e juaja keni thënë se qendra historike do të ketë një trajtim të veçantë nga unë. Këtu shihet një buxhet shumë i vogël i ndarë për këtë qendrën historike të komunës së Prizrenit. Trajtimi i objekteve me vlera historike kulturore, restaurimi, konservimi, rivitalizimi 35.000 € Nuk e di si kanë menduar këtu që ti kryejnë të gjitha. Fasadimi, restaurimi, konservimi dhe revitalizimi i shtëpive të vjetra 115.000 € Ku edhe kjo është një kosto shumë e vogël. Dhe një numër i madh i projekteve që janë larguar, apo hequr që kanë qenë të planifikuara për vitin 2019. Pra, grupi parlamentar i PDK-së, nuk do ta mbështesë këtë buxhet dhe nuk do ta votoj.

**Shukri Quni:** Unë më sa po shoh nga ajo pjesë, sidomos prej pjesës kah Nasheci, që keni premtuar ju shumë projekte. Asnjë projekt nuk është në buxhetin e vitit 2019. As në 2018 nuk është punuar asgjë, që kanë qenë të votuara në shtator 2017. Ju vetëm keni shkua kopje e keni bo. Po ashtu e keni kopje edhe këtë të tanishmen, të cilat vetëm keni shkua duke i reduktuar projektet. Ndërsa nuk keni shtuar asgjë. Te Drejtoria e Administratës, keni pas përmendoren në fshatin Gjonaj në projekt buxhet, nuk është paraparë fare në këto tri vitet e ardhshme. Shtatorja e Heroit Salajdin Berisha 50.000 € kanë qenë të ndara. Prapë nuk është në këto katër vitet e ardhshme. Busti i Heroit Xhevat Berisha 20.000 € kanë qenë të ndara, prapë nuk janë këtu. Rinovimi i monumentit në Jeshkovë 70.000 €, edhe kjo është larguar prej projektit. Edhe Drejtoria për Kulturë dhe Sport e ka largua, në Nashec një projekt që ka qenë madhor. Kompleks sportiv, që e përmendi edhe kolegu pak më herët. Do më thënë diku 100.000 € i ka kthyer mbrapsht në Ministrinë e Kulturës. Ku ka kërkuar Ministria e Kulturës me siguria vendin. Ne vendin e kemi sigurua, do më thënë janë të gjitha të gatshme dokumentet. Ministri premtoj që për këtë projekt janë ndarë 250.000 €. Nëse ju këto të holla i ktheni në Prishtinë, që tash kanë nevojë, se kanë me ua marrë të gjitha sepse ju nevojiten tani Ministrisë, se ka fillua ajo punime shumë. Edhe kështu që ky projekt po dështon, për shkak të neglizhencës që e ka Drejtoria e Kulturës, tash kryetari a është i njoftuar nuk e di. Po këtu po shkruan që kjo kërkesë i është drejtuar edhe kryetarit. Do më thënë, kjo veç po bie poshtë. Ndoshta ka kode kryetar që këto të holla mos ti humbim. Sepse sigurimi ti të hollave është prej Ministrisë. Pastaj çdo projekt që ka qenë për fshatin Nashec asnjë cent nuk është nda. Keni premtuar që do ta bëjmë fshat turistik, do ti largojmë ujërat e zeza, do të investojmë në turizëm. Edhe këtu po e shoh që asnjë cent nuk është i paraparë. Vetëm Drejtoria e Arsimit, në vitin 2021 një sallë të sportit dhe ajo nuk realizohet. Po nuk ka faj aj se po mendon që është lehtë mi nxjerrë ato projektet edhe po mendon që ato punime që janë bërë në kohën e kryetarit Ramadan Muja. Po kujton që i kemi nxjerr duke qesh e duke kënduar. Asnjë projekt zotëri nuk është nxjerrë me dëshirën e drejtorive. Unë kam qenë te kryesuesi me një delegacion të Mazrrekut. Po e shoh i keni paraparë 50.000 € për Mazrrek për 2019. Ata kanë kërkuar në vitin 2018 mu rregullua rrugë. Edhe kjo është prej grandeve, tash a janë të sigurt apo jo nuk po e di. Po ashtu edhe Drejtori i Bujqësisë nuk e ka paraparë rehabilitimin e sistemit të ujitjes për në Nashec. Qendra për kulturë, thamë veç nuk i kemi bo kësaj pune hyzmet dhe kjo është largua. Pastaj ndërtimi i parkut turistik në Nashec, kanë qenë 50.000 €, plus edhe 30.000 €, edhe këto janë largua. Ndërtimin e trotuarit në fshatin Nashec, ka qenë një kërkesë e një kuvendari nga VV-ja, edhe kjo do të thotë nuk është fare. Po ashtu edhe impianti, apo derdhja e kanalizimit të qytetit në Nashec, edhe kjo nuk

është paraparë fare. E këtë e kemi zotëri bakshish kur ke qenë në pushtet LDK-ja na ka pru atë, qaj që foli parës. Po ashtu ndërtimi rrugës Planej-Trunsh deri të rënia e 41 dëshmorëve në Pashtrik. Edhe kjo ka qenë e planifikuar. Largimi i projekteve është ajo që mua për herë të parë po më bënë që sa jam këtu në asamble, mos me votua këtë projektbuxhet. Sikur që këto që i cekëm edhe unë edhe kolegët e mi, këto duhet me hy në projektbuxhet. Ndoshta PDK-ja nuk paska punuar pale sa, po kësi farë ndarje nuk ka bërë. Në 76 fshatra që janë , nuk ka fshat, që nuk është investua sa ka qenë kryetar Ramadan Muja. Tamam e keni ndarë me vijë të kuqe. E përmendi më herët kolegu fshatin Romajë, një ambulancë. Tjetër projekt fare nuk ka. Hazizi foli edhe shkoj. Asnjë projekt në Gjonaj nuk është. Ndoshta po gaboj unë po këtu nuk pash. Po ashtu janë disa projekte të vogla. P.sh. në Grazhdanik 20.000 € s’di çka bëhet me atë projekt. Edhe plus një trotuar që është kërkuar prej qytetit rruga “Besim Shala” për në Nashec. Edhe aty ajo lagje ka nevojë për një trotuar por edhe për kanalizim.

**Sherife Balaj:** Veç u shteren ato që pata mi thënë. Duke ia nisur prej Ilirit, Shukriut dhe kuvendarëve tjerë për Hasin. Ky projektbuxhet, më të vërtetë nuk e di secili që ta kishte marrë, po flas për regjionin e Hasit që është me 18 fshatra mos gabofsha. Nuk ka diçka për lakmi dhe nuk ka kurrgjë hiç. Edhe ato që kanë qenë i keni heq. Nuk e di qysh jua merr mendja, se bajagi vota ka atje, që s’keni marrë njëherë, ndoshta ua mbushni mendjen pas katër viteve me marrë vota. Një gjë që e kam kërkuar për të tretën herë, për të dhjetën herë . Kam me kërkuar edhe njëqind nëse bëhen. Rruga prej Gjonajve ose prej Mazarrekut, që e lidhë deri në Bistrashin, që është rruga kryesore prej 38 km. Rruga që e mbanë gjallë Hasin. E që e përmendën më herët bashkëfolësit. Që pushteti i kaluar e ka lënë dështim e kam fjalën prej para 2000 e 1999 që kemi qenë në atë gjendjen, ndoshta duke jetua në atë pjesën e pazhvilluar, që nuk kemi dit as çka është asfalti, këto dhjet vjet të kaluara, s’ka lënë çdo rrugicë pa investua. Mirë e keq, ato çka janë, janë falënderuar për ato që janë bërë. Mirëpo, rruga kryesore prej 38 kilometrave ka nevojë jashtëzakonisht të madhe që të investohet edhe të riparohet ajo rrugë që ka qenë me bashkëfinancim atëherë të qytetarëve të hasjanëve edhe të bashkëpunimit me institucionet tjera. E di që ka pas marrëveshje bashkëpunimi prej Ministrisë së Infrastrukturës. Edhe këtu cekët me kod ekonomik, asfaltimi i rrugës Mazrrek-Gjonaj-Bistrashin-Prizren. Do më thënë fshatrat të cilat hynë në komunën e Prizrenit. Po edhe fshatrat në komunën e Gjakovës, sepse jemi një, jemi Has. Kodi me numrin 15368 në vlerën 50.000 €ka qenë për 2017 dhe pastaj për 2018, janë hy mos gabofsha 350.000 € I bëj pyetje drejtorit këtu në Shërbime Publike, dhe më kthen një përgjigje ku thotë që nuk kam ide qysh u bo ajo marrëveshje edhe ku gjendet ajo marrëveshje. A është tash e udhës ne me shkua me hulumtua nëpër sirtarë ose me marrë

telefonin mi thirr ata të Ministrisë, nuk bohet kiameti. Edhe mu bo diçka për qatë kod sepse ka nevojë. Madje edhe kohet fundit kishin nis banorët me mbjellë dru nëpër ato gropat gjigante të cilat janë bo. Që unë vetë personalisht më nuk jam duke i ra asaj rruge. Po gjej alternative edhe po shkoj kah Rugova ka Xërxa, se është tmerr nga ajo anë. Kështu që për tjera gjëra nuk po hy në detaje. Veç edhe një gjë e kisha Drejtorit të Financave. E kemi diskutua edhe në vitet e kaluara për çështjen e subvencioneve. Do më thënë nuk ka mund me realizua kurrjë. E pash të Mirëqenia Sociale e të disa drejtori të tjera që u zvogëlua buxheti. Kishe për shkak të keq klasifikimit. Mirëpo me ato 200.000 € subvencion ose me 150.000 €sa kenë te Drejtoria e Mirëqenies. As kërkesat për shpenzimet e varrezave nuk kanë me mund mi dal. Atëherë qysh kanë me mund mi realizua projekte të tilla material ndërtime. Shpenzime të varrimeve, shpërndarje të paketave, druve e ku ta di unë. Projekte të tjera, ku janë edhe nëpër drejtori të tjera që duhet me shkua nëpërmes subvencioneve. E që na paskemi pas bo shkelje të auditorit që kemi e bo realizimin e atyre projekteve përmes grandëve. Më rëndësi për qytetarit është me u realizua projekti. Qysh e gjënë ti rrugën edhe qysh e gjënë ti mënyrën, ata thonë boni çka të doni. Thjesht projektin me ia realizua. Mi shkua qytetarit shërbimi. Kuzhina popullore, i donë më shumë se 100.000 € ku ke mi marrë ti 200.000 € mi realizua tanë ato projekte. Kjo është hajgare hesapi që për mua nuk vlen aspak. Edhe unë jam kundër, sidomos atë pikën që e ceka për rrugën e Hasin me 38 kilometra.

**Kastriot Krasniqi:** Unë tri çështje dua mi ngrit. Një është në vitin e kaluar, në fakte ka qenë për këtë vit 2018, rruga “Ibrahim Rugova” “Nora Kelmendi”. Aty qytetarët ujin e pijes e kanë me gypa të asbestit. Këtu nuk po e shoh. Tjetra është vazhdimi i rrugës Tusus-Bajram Curr 130.000 € Drejtor kisha pas dëshirë me ditë, a e keni paraparë shpronësimin e pronave aty, apo vazhdimin e projektit. Diçka tjetër nuk po shoh këtu, se me 130.000 €mundeni me i shpronësua edhe pronat në atë lagje. E kam edhe një te Drejtoria e Arsimit. Drejtor e pash një kod se i kishe nda 80.000 €, për ndërrimin e ngrohjeve nëpër shkolla. A mundesh me 80.000 €në të gjitha shkollat me i ndërrua ngrohjet.

**Kryesuesi:** I kisha lut anëtarët e Kuvendit, e di që kanë shumë propozime, sugjerim, vërejtje e kritike. Që të jemi pak më të shkurt me kohën. Sepse menjëherë pas kësaj mbledhjeje salla do t'i jepet në shfrytëzim një organizimi që i kushtohet ditës kombëtare të boshnjakëve. Për të cilën i urojmë gjithë komunitetit boshnjak edhe të Prizrenit.

**Azem Durmişi:** Iz navedenih podataka o budžetu 2017 i 2018 godine. Spavom mogu da potvrdim i ovde za govornicom. Bi u veoma kratak upravo zato ste napomenuli da nam je sala potrebna za proslavu dana bošnjaka. I mi

ovde odbornici ispred NDS. Slažemo se za budžet za 2019. Ali kao ovaj budžet koji je predhodne dve godine. Da u ruralnim mestima gde je najviše bošnja ke stanovništvo koncentrisano. U toku predhodnih dve godine, zna i najmanje je uloženo. Pa zato da bude 2019 godine, koje je predvi eno oko 47 miliona i nešto. I mi emo biti skromni. I ja u da navedem samo sumu u vezi ure ivanja neurednih ulica, kanalizacija. A i zbog situacije koja ve nekoliko godina nas prati. Da omladina nam neprestano odlazi. Da i fokus smo dali na sportske entere, kako tipa otvorenog i zatvorenog. Da za 2019 godinu, ako se ne uvrste naših zahtevi negde u celi u da pro itam sumu oko 940.000 € Mislim ja ne bi trebali ni da se na emo, a ne da glasamo budžet.

**Alush Shala:** Megjithëse u tha shumica e atyre që doja ti thosha, edhe për shkak të kohës që po kërkoni që duhet të lirohet salla. Realisht unë e kam lexuar këtë material dhe e kam caktuar edhe numrin rendor edhe i kam kodet me numra me shifra. Po do të mundohem me qenë pak më racional dhe më i shkurt. Fillimisht nuk do të pajtohem me planifikimin dhe buxhetin e planifikuar për drejtoritë që do ti përmendi. Drejtoria e Emergjencës e ka një shumë, shumë të vogël. Që mendoj është njëra nga drejtoritë shumë interesante, dhe komuna e Prizrenit dhe banorët e qytetit kanë nevojë për këtë Drejtori të jetë më e fortë. Përpos buxhetit duhet të shtohet edhe ne numër, se 26 punëtor me 200.000 banor, më duket është diçka shumë absurde. Pastaj në buxhetin e planifikuar për bujqësinë, është shumë pak. E përmendën kolegët edhe arsyet i dhanë. Sepse komuna e Prizrenit realisht ka një tokë bujqësore dhe mundësi për zhvillimin e bujqësisë më të madhe. Po ashtu edhe në Drejtorinë e Inspektoratit është buxheti i vogël që ata të bëjnë punë të mëdha dhe ti plotësojnë nevojat çka i ka komuna e Prizrenit. Me Administratë, edhe aty më duket buxheti jo i mjaftueshëm. Përbashkëta atë 400.000 € nëse është ekstra diçka, dhe mund me i plotësua nevojat që ka komuna. Po unë kisha kërkuar që ky buxhet të jetë më i madh. Të nderuar të pranishëm i nderuar drejtor Fatmir Memaj. Juve keni planifikuar 280.000 € për tri vite për shpronësime. Unë mendoj që kjo është vetëm hajgarellëk dhe s'mundeni me pas sukses. Për shpronësime unë mendoj që për çdo vit, edhe kur kemi qenë ne në pushtet. Kam kërkuar së paku të ndahet një fond diku rreth 3.000.000 € Sepse ne vërtetet ju kemi borxh shumë qytetarëve të komunës sonë. Edhe nëse fillojmë me këto 2-300.000 € mendoj se asnjëherë, jo për mandatin e juaj, po edhe ne deri sa të vdesim, s'kemi me pas mundësi me ua kthye. Prandaj është obligim i juaj kryetar që këtë fond ta rritni. Ta rritni sidomos për shpronësim. E kam pa një shumë nëse s'jam gabim për tri vitet e ardhshme 350.000 € më duket për drunjë dekorativ. Askush nuk është kundër drunjëve dekorativ. Por realisht Prizreni dhe qytetarët tanë kanë nevojë për investime jetësore. Për të përkrahur këtë buxhet, mendoj që edhe disa



projekte ti planifikoni. Për lagjen “11 Mars”, “2 Korrik” dhe “Dardani”, thuaja gati s’kam pa as aspak. I keni përcaktua do rrugica. Po unë po mendoj që nuk është përfshi. Unë nëse s’ju vjen mërzi do ti kisha përmendur disa më të nevojshme. Sikur ju drejtor të jeni më të zotë dhe nëse ka vullnet edhe kryetari, po ju them që do ta gjeni përkrahjen edhe në Qeveri. Sepse të gjithë kanë nevojë për banorët edhe për votat e Prizrenit. Dhe nëse komuna e Prizrenit ua jep parat qytetarëve të vetë, jo për katër vjet, po unë po ju garantoj që edhe për katërdhjetë vjet munden me ndejtë në pushtet cili i paguan borxhet. Se qytetarët kanë nevojë me ia kthye pjesën e vetë. Gati këto projektet i përfshinë dy lagjet “11 Mars” dhe “2 Korrik”. Ndërtimi i një zyre të vendit, në “11 Mars” dhe “Korrik”. Ndërtimi i shkollës së re që është premtim drejtor. Po thoni e kemi gjet vendin, po nëse nuk bëhet rreth TA-së, atëherë s’kemi bo kurrjë. Të njëjtin kilometër kanë me bo fëmijët tanë. Hapjen e rrugës “Faherdin Hoti” në transitin e ri. E di që ka prona private. Sikur që po mundohemi me ia zgjidhë problemin kësaj lagjes Gurishta edhe këtu duhet të mendojmë. Dhe kjo jo vetëm që do ti ndihmon ata banorët. Po do ta çliron edhe qytetin. Për lagjen “11 Mars”, thuaja nuk kam një projekt për shtrimin dhe rregullimin e rrugëve. Por unë po ju tregoj se në “11 Mars” janë rreth 1500 metra rrugë të pashtuara fare. Plus kemi një pjesë pa kanalizim dhe që është mjerisht tmerr. Të mundoheni me çdo kusht me shti hapjen e trotuareve. Ndriçimin, hapjen e rrugës apo asfaltimin e rrugës. S’po them autostradë mu po, po së paku mu asfaltua rruga nga TA për autostradë të Baruthanja. S’po i përmendi edhe disa tjera, se edhe këta kolegët po më kritikojnë. Po realisht nëse ju i plotësoni këto kërkesa më kishit detyrua ta përkrah edhe ta votoj buxhetin.

**Rreze Hoxha (PDK):** Do të fokusohem te Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit. Ka planifikua një buxhet të madh në përmbajtje, dhe jo funksional për implementimin. Këtë e bazojmë në pozicionet në tabelën buxhetore që na është dërguar nga Shërbimi Profesional i Kuvendit të komunës. Siç tha edhe më herët Alush Shala, ishte pozicioni i shpronësimit të pronave. Po ashtu edhe pozicioni tjetër buxhetor është hartimi i planeve rregulluese të hollësishëm. Ku janë planifikuar vlera prej 30.000 € Konsiderojmë se ky pozicion është shumë i vogël në krahasim me premtimet elektorale që i ka dhënë kryetari Haskuka. Duke u lidhur në një ri rregullim urban. Por kjo pikë ka qenë veç një mashtrim elektorale e jo ajo që po shohim në pozicionet buxhetore.

**Edil Aljilji (Vakat):** Na po etku bi da estitam svim bošnjacima sretan praznik, to jest dan bošnjaka. U svojstvu predsedavaju eg skupštinskog odbora za zajednice. A na predlog i podršku odtora za zajednice, tražim da se u sklopu budžeta za narednu godinu, uvrsti i finansiska podrška za dve manifestacije. Dan zastave neve inske zajednice aškalija i dan roma. Poštovani 15 Februar se

na Kosovu, zvani no prosljavlja neve insek zajednice aškalija. Kao i sve manjinske zajednice, tako i zajednica aškalija ima svoji zvani ni praznik na Kosovu. U sklopu proslave ovog praznika se organizuje veliki broj aktivnosti. Me utim Vlada Kosova svake godine izdvaja veoma mali iznos finansiske podrške za ove aktivnosti. Zato zahtev plus podršku odbora za zajednice da se u sklopu budžeta Direktorijata za Kulturu, Omladine i Sport. Da izdvoji finansiska podrška za dan zastave aškalija. Tako e 8 april je zvani ni dan roma na Kosovu. Tako e se u sklopu navedenog praznika organizuje veliki broj aktivnosti u gradu Prizrenu. I opet bez podrške opštine Prizren. Zato zahtevam da se u sklopu budžeta za narednu godinu uvrsti i linija za podršku aktivnosti za zvani ni dan roma. I još jedna primedba, gde tražim odgovor oduzete od kancelarije za zajednice 20.000 € od robe i usluga. Tako e i 2.000 € od subvencija.

**Shkodran Kryeziu (PDK):** Kërkoj në vijën buxhetore të vitit 2019 të futet edhe rruga “Salajdin Berisha”. Ku kanë bërë kërkesë edhe më herët dhe kanë dal zyrtarët komunal në vendngjarje. Kanë vërtetua që aty ka problem me kanalizim dhe duhet të rehabilitohet e gjithë rruga. Kërkohet që rruga të bëhet e njëjtë sikur se rruga “Xhevat Berisha”, që të futet kanalizimi, ujësjellës, ndriçimi dhe asfaltimi rrugës. Pastaj në buxhetin e vitit 2017-2018 ka qenë edhe shtëpia historike në fshatin Arbëri – Leskovec. Ku tash po e shoh e kanë hequr prej buxhetit të këtij viti. Njashtu edhe shtimi i kapacitetit për ujë të pijes për lagjen Tusus 80.000 € janë ndarë. Janë të pamjaftueshme për krejt lagjen. Ndoshta ka edhe ndonjë projekt është mirë me ditë. Po ashtu kërkoj pak sqarime edhe për Drejtorinë e Turizmit. Po e shoh që janë disa projekte këtu kode të reja. Zhvillimi i turizmit malor rural, janë të ndara 80.000 € Zhvillimi i turizmit urban 50.000 € Si dhe zhvillimi i turizmit kulturor 60.000 € Të gjitha bëjnë diku rreth 210.000 € A ka të planifikuara apo a ka ndonjë projekt për këto investime që do të bëhen.

**Antigona Bytyqi (PDK):** Sa e kemi pa, në këtë buxhet, për disa projekte janë ndarë aq vlera të vogla, sa që është e pamundur të realizohen ato projekte. Për shembull investimet që i përmendi edhe shefi i grupit prej 20.000 € që i keni parapa për Hoçë të Qytetit. Ndërtimi i rrugës së vjetër dhe ndërtimi i dy urave. Nuk e di si e keni përcaktuar atë vlerë, sepse ju as që i keni vizitua këto vende ku do të punoni. Është e pamundur, se të urat janë disa punë të domosdoshme të cilat do ta kenë koston shumë më të lartë. Se për ndryshe do të ishim shumë të kënaqur edhe ju edhe ne banorët që me këtë vlerë të vogël të përfundojnë këto projekte. Ndërsa kërkesat tjera që i kemi nga ky komunitet. Prej se e kemi këtë qeverisje të re, asnjë projekt nuk është përfshi në këtë

buxhet. Madje injorohet aq shumë, sa që as përgjigje gojore, as me shkrim që sa muaj nuk marrim nga Drejtori i Shërbimeve Publike.

**Behar Begaj:** Unë vetëm desha t'ju them se nëse ju bashkërisht i realizoni gjithë këto premtimet, më siguri se do të jeni shembulli më i mirë këtij pushteti. Dhe shpresoj se qytetarët ta shohin ndryshimin e këtij pushteti, suksese.

**Pranverim Berisha:** Shoh që këtu në bazë të këtyre kodeve, besoj shumë fuqishëm që pushteti do t'i prek gjithë nevojat dhe gjithë kërkesat e qytetarëve. Mirëpo, shoh këtu se për dallim prej pushteteve të kaluara, shpresoj që uji i pijes për fshatin Billushë do të përfundon. Do më thënë problemi i ujit të pijes, zgjidhja në bazë të nevojave në bazë të shtrimit të fshatit. Tashmë janë rrit edhe nevojat dhe kërkesat. Dhe problemi që Billusha ka problem thelbësor për ujin e pijes. Mandej ndërtimi i kanalizimit në fshatin Jeshkovë. Ndriçimi publik në fshatin Vlashnje. Ndërtimi i rrugës që lidh dy vendbanime shumë të rëndësishme po besoj Kobaj dhe lagjia Bajram Curr. Jam i bindur se këto do të realizohen.

**Sultan Badallaj:** Kur kemi të bëjmë me planifikimin e buxhetit, duhet të theksohet se ky projektim i projeksioneve buxhetore, është më tepër i planifikuar pa një analizë të duhur. Nga ajo se pse bëhet ndarja dhe planifikimeve të zërave buxhetor. Buxheti, ndarja e tij dhe orientimi behën për një strategji dhe zhvillim të qëndrueshëm. Prej këtij buxheti varët kah do të shkoj komuna. Vetëm po ti japim një vështrim këtij buxheti, i shohim kodet ekonomike, jo vetëm që nuk janë zvogëluar mjetet. Por e kundërta kemi rritje. Për shembull nga 300.000 € sa ka qenë e kemi 400.000 € Pra kemi të bëjmë me kodin 43343. Ndërtimi i projekteve infrastrukturore. Do të thotë rrugë, kanalizim, ujësjellës, mure mbrojtëse etj. Nga të gjitha këto që janë në këtë kod buxhetor, rrugë, kanalizim, ujësjellës, dhe mure mbrojtëse. Ekzistojnë për të gjitha projektet veç e veç për të gjitha nga këto që u ceken. Po ashtu të gjitha kontratat kornizë kemi rritje të planifikimit buxhetor. Pse e keni rrit ju i dini më mirë ato. Gjithashtu vlen të theksohet se planifikimi i rrugës Dobrusht-Has, ekemi një ndarje të mjeteve 10.000 € Kjo është vërtetë e pakuptueshme 10.000 € për një rrugë kur nuk dihet se ku do të ndërtohet. Ju duhet të jepni një sqarim të pozitës gjeografike edhe shtrirjen e këtij fshati. Pastaj kemi ndërtimin e rrugës Billushë-Dragash-Zhur, me vetëm 15.000 € Po ashtu ku mund të ndërtohet një rrugë e tillë me 15.000 € Po ashtu duke e ditur edhe pozitën e fshatit Billushë. Kemi kodin e projektit 43353. Ndërtimi i urës që lidh fshatrat Krushë e vogël-Breg Dri, me vlerë të projektit 20.000 € Më 20.000 € nuk mund të ndërtohet një këmbë e urës. Kur dihet që vendi që mendoni që të ndërtohet

kjo urë, duhet të kushtoj me qindra mijëra euro. Ose mundesh me thënë edhe milion euro. Po ashtu ndarë mjete edhe për Lumëbardhin, kur dihet se ende nuk e kanë filluar atë projekt. Këtu dihen arsyet pse s'kanë filluar punimet, kur dihet se çdo afat ligjor ka kaluar. Tjetra, kemi kodin ekonomik 87669 mirëmbajtja e komplekseve memorialë. Është futur nën menaxhim të Drejtorisë të Shërbimeve Publike. Që në fakt gjithnjë është menaxhua nga Drejtoria e Administratës. Nuk i di arsyet, po të jep me kuptua që shihet që është një tregues i mospajtimeve brenda ekzekutivit. Kemi kodin 46940 ndërtimi i miniparqeve, ulëseve, ndriçimi publik. Për çfarë ndriçimi publik është fjala, nuk ka sqarim. Kur dihet se ekziston kontrata e ndriçimit publik për tërë komunën e Prizrenit. Një pjesë e madhe e buxhetit është keq klasifikuar si kategori ekonomike. Drejtori i Financave na tha se janë bërë ndryshimet e janë rregullua këto. Po nuk është e vërtetë. Për shembull janë futur në investime kapitale projektet të cilat duhet të futën në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe subvencioneve. P.sh. projektet e bujqësisë lirisht mund të themi 70% është dashtë të planifikohen nga subvencionet. Po ashtu kemi edhe te kultura e te turizmi. Gjithashtu vlen të theksohet se shtrirja e planifikimit buxhetor është në bazë të kërkesave dhe nevojave. Ku kemi fshatrat Zhur, Shkozë, Dobrusht, Vërmicë. Përveç disa punimeve të mbetura vitet e kaluar. Në Zhur ende s'kemi marrë përgjigje se çka u bo me shtëpinë e Kulturës. Po le që s'është përfshi por dita ditës, veç është duke u degradua. Dhe dihet për faje të kujt është bo dhe ka mbet deri tash. Gjithashtu kemi sallën e edukatës fizike, e cila është dashtë që në shtator të merr fund, po nuk është krye. Pastaj rruga që lidh Zhurin me fshatin Shkozë, rruga e boçishtës që i themi ne, duhet të hy në këtë planifikim. Pra të nderuar kuvendar, të nderuar ekzekutiv, kemi të bëjmë me një buxhet të pa studiuar, të pa analizuar dhe të pa klasifikuar.

**Petrit Hoxha:** Nuk kam vërejt asgjë për fshatin Kobajë. Kanalizimi duhet të jetë si prioritet. Pasi që një pjesë derdhet në fshatin Vlashnje dhe pjesa tjetër në Grazhdanik. Më të vërtetë është në gjendje të mjerueshme. Ndërsa sa i përket projekteve tjera. Unë po flas për fshatin Vlashnje. Janë të parapara dhe shpresoj që do të realizohen të gjitha.

**Kryesuesi:** I falënderoj të gjithë anëtarët e Kuvendit që morën pjesë në diskutim. Me gjitha vërejtjet, sugjerimet e tyre si dhe kërkesat, të cilat padyshim se qëndrojnë shumica. Sado që është buxheti i komunës së Prizrenit, fatkeqësisht nuk mund ti plotësoj të gjitha kërkesat e qytetarëve. Tani kërkesat e lagjeve dhe të fshatrave. Mirëpo unë nuk do t'ia bëjë si kryesuesi i kaluar. Ky është një draft një projekt i cili po i prezantohet Kuvendit. Kjo është forma e planifikuar, ne si Kuvend duhet të marrim vendim për këtë projektbuxhet.

Atëherë nëse jeni të gjithë të pajtimit shkojmë në votim. Atëherë 34 anëtarë janë prezentë në sallë, dhe e hedhim në votim, kush është për?

Për? – 24.

Kundër? – 10.

Kundër? - S'ka.

Atëherë konstatoj se me 24 vota për, 10 kundër, asnjë abstenim miratohet buxheti i komunës së Prizrenit për vitin 2019.

Në fund kryetari kërkoi një fjalim, për ju që keni durim me dëgjua, po e di që zgjati seanca. Po ju që s'keni, kuptohet.

**Kryetari i komunës, Mytaher Haskuka:** Së pari i falënderoj të gjithë ata që e kanë votuar buxhetin. Vetëm desha disa gjëra mi shpjegua. Kanalizimet janë koncentrua, ndriçimi është koncentrua. Jo për shkak me pas vetëm projekt. Po kanë qenë 20 projekte kanalizime. Shumica prej tyre nuk janë implementua për shkak se kanë qenë shumë të vogla. Edhe në aspektin e Zhupës. Ju e dini sivjet për muret mbrojtëse. Ka pasur 20 vende ku ka pasur rrëshqitje të dheut dhe në shumicën e tyre menjëherë kemi intervenua dhe i kemi bo muret mbrojtëse. Do të ketë hala më shumë për shkak të ndryshimeve klimatike. Është e vërtet që disa projekte ka qenë dashtë me pas kodin me një shifër shumë të vogël, si ura në Krajk. Edhe disa vërejtje që kanë qenë për buxhetet tjera. Po këto kanë qenë se jemi në negociate dhe kemi një para marrëveshje me disa ministri për këto rrugë. Do më thënë duhet me pas kodin që me fillua kjo. Disa raste ku faktikisht ne e kemi bo pjesën tonë të investimit edhe ministria vazhdon aty janë ndal. Në përgjithësi qëllimi është që deri në dhjetor të bëhen gjitha projektet, të shqyrtohen të gjitha kërkesat nëpër të gjitha fshatrat edhe lagjet e qytetit. Pastaj do të fillojmë implementimin sa më herët në shkurt apo në mars. Edhe kështu do të jetë edhe nuk besoj që do të ketë ndonjë diskriminim në këtë aspekt. Sivjet ne i kemi dhënë 150.000 € ekstra Radoniçit për kyçje edhe shpenzimet shtesë që i kanë pas rajoni i Hasit. Plus për vitin e ardhshëm kemi nda prapë për rajonin e Hasit për Radoniçin. Po edhe bashkëfinancimin e kemi shtua sivjet me fondet që i kemi pas për investime ekstra për furnizim me ujë edhe për qytet po edhe për pjesën e Vrrnit. Edhe në atë aspekt besoj që kur i kemi koncentruar këto edhe bëjmë planifikimin e mirëfilltë. Nuk ka me pas nevojë njëherë me shtruar asfaltin, pastaj me prish asfaltin, prapë atë kanalizim. Së pari caktohen kriteret, nëse nuk ka kanalizim, së pari bëhet kanalizimi, pastaj vjen uji, pastaj vijnë kupëzat, asfalti. Besoj që është një rregull edhe kjo është sipas rekomandimeve të auditorit. Se përndryshe të gjitha projektet i kemi pas ndaras. Edhe për Nashec edhe për investimet që thamë me Ministrinë e

Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Po vazhdojmë me shumicën e tyre. Edhe nuk ka kurrfarë problemi. Vetëm disa raste ku s'ka pronë komuna dhe ku s'kemi pas se si me fillua investimet, ka qenë problem. Edhe projekti i stadiumit të Zhurit, edhe çështjet tjera, këtu i kemi bo kërkesat. Edhe pse vendimi është marrë. Ende ne nuk kemi marrë atë vendim. Po kompania e cila duhet me bo punimet në Zhur ka fillua nëse i keni pa lajmet, që është dhënë nga agjencioni i pyjeve. Njëjtë edhe për projektet tjera. Po edhe shumë projekte tjera ku ne s'kemi as projekti, a vendin, ka qenë i pamundur investimi. Se pa pas vendin e caktuar edhe pa e pas projektin e gatshëm, është problem. Ka edhe çështje tjera që janë ngrit. Ne i kemi edhe dy vija buxhetore. Kemi bashkëfinancim me ministrinë, tjetra është bashkëfinancim me donatorët. Sivjet bashkëfinancim me donatorët kemi pas diku 80.000 € Po nëse shikojmë sa është financua në komunën e Prizrenit. Mundem me thënë se ka arritur shifrën diku rreth 800.000 € Ose mundem me thënë se deri në fund të vitit ka me qenë deri në 800.000 € Nga Drejtoria e Mirëqenies, ku faktikisht ne së bashku me një organizatë joqeveritare jemi duke ndërtuar jo vetëm me dhënë material, po edhe me çelësa në dorë me të gjitha pajisjet familjeve të cilat kanë nevojë. Deri te financimi me UNDP e cila do të krijoj një zyre që u tha edhe këtu me të drejtë. Si p.sh. për projektet në bujqësi, për projektet tjera të cilët duhet të ndihmohen edhe bizneset edhe bujqit tjerë. Në aplikim edhe për fonde ndërkombëtare por edhe për fondet nga Ministrinë e ndryshme. Edhe këtë zyre besoj që do ta kemi deri kah fundi i nëntorit. Edhe brenda zyrës do të kemi ndihmë bujqve, ndihmë bizneseve. Në aspektin e industrive të gjlëbërta. Po në të njëjtën kohë edhe për diasporën për investimet në Kosovë, ose në Prizren se ku mund të investojnë me projekte të gatshme. Ndërmarrësit e rinjtë të cilët nuk kanë kapital. Së bashku me këtë zyre i prezantojnë ato edhe diasporës edhe në Prizren, po edhe jashtë. Po edhe këtë e kemi bo me bashkëfinancim. Komuna do të jep vetëm 10% të mjeteve. Ndërsa UNDP do të jep 300.000 € Dhe besoj me këtë mënyrë do të bëjmë shumë më shumë investime në Prizren, me këto kodet e bashkëfinancimit. Edhe nëse dikush nga një ministri mundet me e nxjerr ndonjë projekt edhe sjellin në komunë. Edhe komuna me e dhënë një pjesë të mjeteve. I kemi këto dy kode të cilët janë të gatshme aty për me ndihmua. Në momentin që e kemi një deputet boshnjak në Parlamentin e Kosovës, e nxjerr projekt për Zhupën. Ne e kemi të gatshëm bashkëfinancimin me ministri edhe mundemi me aplikua drejtpërdrejt. Përndryshe edhe sivjet me Ministrinë e Zhvillimit Rural, në momentin që ata kanë kërkuar që ne mi rialokua disa mjete, i kemi dhënë 50.000 € për rajonin e Zhupës. Tash projektet janë në vazhdim. Edhe Ministria na ka dhënë 350.000 € tjera, për ti bërë edhe rrugët dhe pjesë tjera. Nuk mundet me qenë buxhet i cili diskriminon ndonjë rajon, ngase kemi pas dëgjime publike në të gjitha rajonet. Edhe i kemi mendimet edhe kritikën e çdo qytetari në çdo

rajon të komunës së Prizrenit. Prandaj edhe njëherë i falënderoj të gjithë ata që kanë votua. Edhe për kritikát konstruktive dhe për kritikát e ndryshme që kanë pas. Shpresoj që do të jenë një buxhet zhvillimor për komunën e Prizrenit dhe do të kemi zhvillim të qëndrueshëm në komunën tonë.

**Kryesuesi:** Ju faleminderit për pjesëmarrje në këtë sallë. Dhe mirupafshim në mbledhjen e ardhshme. Pa dyshim ne do të jemi gardian të zbatimit të këtij buxheti. Dhe do ta përcjellim punën e ekzekutivit. Mirupafshim në mbledhjen e radhës.

Përfundoi në orën 16:35.

Procesmbajtës;  
Sehat Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit  
Artan Abrashi